

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI I EDUKIMIT**

**PROGRAMI MASTER: MËSIMDHËNIA DHE KURRIKULA**



**TEZA MASTER**

**Ndikimi i teknikave të vlerësimit formativ në arritjen e rezultateve të të nxënit në lëndën e gjuhës shqipe**

**Mentore:**

Prof. Asoc. Hatixhe Ismajli

**Kandidatja:**

Flutura Ibrahimimi

*Prishtinë, 2022*

## **Deklaratë e autorit mbi origjinalitetin e punimit**

Duke ditur përkufizimin dhe format e plagjiaturës në botën akademike, deklaroj se punimi im nuk cenon të drejtën e autorit të askujt.

Unë deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë, se punimi është origjinal i kryer personalisht nga unë. Ky punim, apo pjesë të tij, nuk janë prezantuar dhe botuar më parë nga ndonjë institucion tjetër.

Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara sipas standardeve të praktikave referuese.

## **Author's statement on the originality of the çork**

Knoçing the definition and forms of plagiarism in academia, I declare that my çork does not infringe anyone's copyright.

I declare under my full responsibility, that the çork is original done personally by me. This paper, or parts of it, have not been previously presented and published by any other institution.

The paper does not contain material çritten by any other person, except in cases cited and referred to according to the standards of reference practices.

**Emri/Name**

Flutura Ibrahim

**Nënshkrimi/Signature:**

\_\_\_\_\_

**Data/Date:**

\_\_\_\_\_

*Bashkëshortit dhe djalit tim...*

*Për gjithë dashurinë, besimin dhe mbështetjen e tyre të vazhdueshme për të më ngritur kur unë  
pothuajse isha rrëzuar.*

## **FALËNDERIM**

Të punosh tezën e masterit duhet përpjekje, përkushtim dhe angazhim e që nuk do të ishte aspak e lehtë pa mbështetjen dhe përkrahjen e të gjithë atyre që më rrethojnë e që kontribuan në mënyra të ndryshme në realizim e këtij projekti.

Falënderime të veçanta i dedikohen mentores sime Prof.asoc. Hatixhe Ismajli për udhëzimet profesionale, sugjerimet dhe këshillat shumë të rëndësishme për mua, për durimin, gatishmërinë e bashkëpunimit dhe mbikqyrjen gjatë çdo faze të këtij procesi hulumtues, të cilën e konsideroj kyçe në cilësinë e këtij punimi.

Falënderime dhe mirënjohje të sinqertë për të gjithë pjesëmarrësit, që ndanë kohën, u angazhuan, reflektuan dhe ndanë përvojat e tyre duke më dhënë mundësinë e realizimit të këtij punimi shkencor.

Falënderime të pafundme e të përzemërta familjes sime, e cila është një dhuratë që unë gjithmonë do ta çmoj, më e madhe se gjithçka që mund ta iamgjinoj, për besimin, mbështetjen, përkrahjen dhe inkurajimin e pakursyer që më motivuan gjatë kësaj sfide studimore, të cilëve u detyrohem përjetësisht.

## **PËRMBAJTJA**

<b>ABSTRAKTI.....</b>	<b>7</b>
Lista e tabelave .....	9
Lista e figurave .....	10
Lista e shkurtesave.....	<b>10</b>
<b>I. HYRJJE .....</b>	<b>11</b>
1.1.Problemi i hulumtimit .....	12
1.2. Qëllimi i hulumtimit.....	12
1.2.1.Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat .....	13
<b>II. SHQYRTIMI I LITERATURËS .....</b>	<b>13</b>
2.1. Sqarimi i nocioneve themelore.....	15
2.1.1. Vlerësimi i nxënësve .....	17
2.1.2. Llojet e vlerësimit.....	19
2.1.3. Vlerësimi formativ .....	22
2.1.4. Lënda e gjuhës shqipe, kompetencat dhe rezultatet e të nxënit.....	23
2.2. Qëllimet e vlerësimit .....	26
2.3. Rëndësia e vlerësimit të nxënësve.....	28
2.4. Parimet themelore të vlerësimit.....	29
2.5. Ndryshimet në vlerësimin e nxënësve.....	31
<b>III. VLERËSIMI FORMATIV DHE TEKNIKAT E VpN NË LËNDËN E GJUHËS SHQIPE.....</b>	<b>34</b>
3.1. Karakteristikat e VpN dhe strategjitë për arritjen e kompetencave.....	40
3.2.Roli i mësimdhënësve gjatë vlerësimit formativ .....	42
<b>IV. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT .....</b>	<b>44</b>
4.1.Pjesëmarrësit dhe mostra.....	44
4.2.Instrumentet për mbledhjen e të dhënave.....	45

4.3.Procedurat e hulumtimit .....	45
4.4.Analiza e të dhënave.....	46
<b>V. REZULTATET E HULUMTIMIT .....</b>	<b>47</b>
5.1.Të dhënat demografike .....	47
5.2.Të dhënat sasiore .....	49
5.2.1.Analiza përshkruese.....	49
5.2.2. Variablat e grupuara .....	61
5.3.Testimi i marrëdhënieve në mes variablave.....	64
5.3.1.Analiza e korrelacionit.....	64
5.3.2. Analiza ANOVA .....	67
5.4. Analiza e të dhënave cilësore.....	72
<b>VI. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET .....</b>	<b>76</b>
6.1.Rekomandimet.....	78
6.2. Limitet .....	79
6.3.Implikimet praktike .....	79
<b>VII. REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE .....</b>	<b>81</b>
SHTOJCA A Pyetësor për mësimdhënës.....	83
SHTOJCA B Pyetësor për nxënës .....	85
SHTOJCA C Protokoli i intervistës me ekspertë të fushës së vlerësimit – trajnerë/fasilitues..	87
SHTOJCA D Tabela e analizës së të dhënave cilësore.....	88

## ABSTRAKTI

Në këtë punim të masterit u shqyrtuan teknikat e vlerësimit formativ dhe ndikimi i tyre në arritjen e rezultateve të të nxëniet në lëndën e gjuhës shqipe, të cilat ndihmojnë në sigurimin e informatave kthyesë për të lehtësuar të nxëniet dhe për të përmirësuar nxënien. Duke ditur se mësimdhënësit e shohin vlerësimin si pjesë të pandashme të mësimin duhet të përshtatin mësimdhënien me nevojat e nxënësve, dhe nxënësit i përshtatin strategjitë e tyre të të nxëniet për qëllime të caktuara, përdorimi i teknikave të vlerësimit formativ siguron mbledhjen e informacioneve për t'i ndihmuar nxënësit që ta përmirësojnë punën e tyre derisa ata janë duke marr njohuri të reja apo duke i zbatuar shkathtësitë e tyre, dhe gjykimin në lidhje me të dhënat e më pas edhe shfrytëzimin e informatave për qëllime të caktuara.

Metodologjia e përdorur gjatë këtij hulumtimi ishte metoda e përzier, sasiore dhe cilësore e cila mundësoi përgjigjet në pyetjet e hulumtimit që lidhen me teknikat e VpN-ës në lëndën e gjuhës shqipe. Të dhënat sasiore u analizuan me metodën statistikore përmes programit SPSS, ndërsa ato cilësore u analizuan me metodën induktive.

Qëllimi i hulumtimit është analiza e teknikave të vlerësimit formativ si dhe ndikimi i tyre në arritjen e rezultateve të të nxëniet në lëndën e gjuhës shqipe. Pyetja hulumtuese është: Çfarë ndikimi ka përdorimi i teknikave të vlerësimit formativ në arritjen e rezultateve të të nxëniet në lëndën e gjuhës shqipe?. Hulumtimi u zhvillua në tri shkolla fillore në Prishtinë përkatësisht shfmu “Faik Konica”, shfmu “Xhemajl Mustafa” dhe shfmu “Naim Frashëri” të zgjedhura si mostër e këtij punimi. Ky hulumtim u realizua në klasët II-V në të cilin u përfshinë 90 nxënës dhe 40 mësimdhënës, për të cilët u përgatitën pyetësorë dhe 5 ekspertë të fushës të cilët u intervistuan.

Në këtë hulumtim u nxorrën përfundime se përdorimi i teknikave të VpN lehtësojnë mësimdhënien dhe nxënien, nxisin dëshirën, përkushtimin, pjesëmarrjen aktive, të menduarit e nivelit të lartë si dhe orientojnë nxënësit për arritjen e rezultateve të të nxëniet. Gjithashtu u vunë në pah teknikat informatave kthyesë, vlerësimi i ndërsjellë, vetëvlerësimi dhe parashtrimi i pyetjeve si më të përshtatshmet për zbatimin e vlerësimit.

**Fjalët kyçe:** Vlerësimi formativ (VpN), teknikat e vlerësimit formativ, vetëvlerësimi, vlerësimi i ndërsjellë, informatave kthyesë.

## **ABSTRACT**

This master thesis examined formative assessment techniques and their impact on the achievement of learning outcomes in the Albanian language, which help provide feedback to facilitate and improve learning. Knowing that teachers see assessment as an integral part of learning they should adapt teaching to the needs of students, and students tailor their learning strategies to specific purposes, the use of formative assessment techniques ensures the collection of information to helping students improve their work while they are gaining new knowledge or applying their skills, and judging about data to then use the information for specific purposes.

The methodology used during this research was the mixed, quantitative and qualitative method which enabled the answers to the research questions related to VpN techniques in the subject of Albanian language. Quantitative data were analyzed by statistical method through SPSS program, while qualitative data were analyzed by inductive method.

The purpose of the research is the analysis of formative assessment techniques and their impact on the achievement of learning outcomes in the subject of Albanian language. The research question is: What impact does the use of formative assessment techniques have on the achievement of learning outcomes in the Albanian language? The research was conducted in three primary schools in Prishtina, respectively "Faik Konica", "Xhemajl Mustafa" and "Naim Frashëri" selected as samples for this paper. This research was conducted in grades II-V in which included 90 students and 40 teachers, for whom questionnaires were prepared and 5 experts in the field who were interviewed.

In this research it was concluded that the use of VpN techniques facilitate teaching and learning, promote desire, commitment, active participation, high level thinking and orient students to achieve learning outcomes. In addition, feedback, mutual evaluation, self-evaluation and questions were highlighted as the most appropriate for the implementation of the evaluation.

**Keywords:** Formative assessment (VpN), formative assessment techniques, self-assessment, peer review, feedback.



## LISTA E TABELAVE

<b>Tabela 1.</b> Nivelet formale të Arsimit parauniversitar në Kosovë.....	19
<b>Tabela 2.</b> Periudhat e realizimit të secilit lloj të vlerësimit, bartësit / përgjegjësit e vlerësimit, qëllimet kryesore dhe mënyrat e dokumentimit/evidentimit të arritjeve të nxënësve.....	20
<b>Tabela 3.</b> Qëllimet dhe dokumentimi për çdo vlerësim shtetëror.....	21
<b>Tabela 4.</b> Rezultatet e të nxënësve të fushës gjuhët dhe komunikimi për shkallën 2.....	25
<b>Tabela 5.</b> Vlerësimi tradicional dhe vlerësimi i bazuar në rezultate.....	32
<b>Tabela 6.</b> Karakteristikat e VpN dhe përshtatja me strategjitë e mësimdhënies .....	41
<b>Tabela 7.</b> Shpërndarja e mostrës së nxënësve sipas të dhënave demografike të pyetësorit.....	47
<b>Tabela 8.</b> Shpërndarja e mostrës së mësimdhënësve sipas të dhënave demografike të pyet.....	49
<b>Tabela 9.</b> Analiza përshkruese (frekuenca, përqindja, mesatarja aritmetike, moda dhe devijimi standard) e të dhënave për vlerësimin e nxënësve të mbledhura nga nxënësit.....	53
<b>Tabela 10.</b> Analiza përshkruese (frekuenca, përqindja, mesatarja aritmetike, moda dhe devijimi standard) e të dhënave për vlerësimin e nxënësve të mbledhura nga mësimdhënësit.....	60
<b>Tabela 11.</b> Analiza përshkruese (mesatarja aritmetike, mediani, moda dhe devijimi standard) e grup variablave për vlerësimin e nxënësve të mbledhura nga nxënësit.....	62
<b>Tabela 12.</b> Analiza përshkruese (mesatarja aritmetike, mediani, moda dhe devijimi standard) e grup variablave për vlerësimin e nxënësve të mbledhura nga mësimdhënësit.....	63
<b>Tabela 13.</b> Korrelacioni në mes të grup variablave nga të dhënat e mbledhura nga nxënësit për vlerësimin e nxënësve.....	64
<b>Tabela 14.</b> Korrelacioni në mes të grup variablave nga të dhënat e mbledhura nga mësimdhënësit për vlerësimin e nxënësve.....	66
<b>Tabela 15.</b> Dallimet në mesataret aritmetike sipas gjinisë në mesin e nxënësve.....	67
<b>Tabela 16.</b> Dallimet në mesataret aritmetike sipas vijueshmërisë së klasës në mesin e nxënësve.....	67
<b>Tabela 17.</b> Dallimet në mesataret aritmetike sipas gjinisë në mesin e mësimdhënësve.....	69
<b>Tabela 18.</b> Dallimet në mesataret aritmetike sipas grupmoshës në mesin e mësimdhënësve.....	69
<b>Tabela 19.</b> Dallimet në mesataret aritmetike sipas nivelit të përvojës së punës në mesin e mësimdhënësve.....	70
<b>Tabela 20.</b> Dallimet në mesataret aritmetike sipas nivelit të shkollimit në mesin e mësimdhënësve.....	71

<b>Tabela 21.</b> Dallimet në mesataret aritmetike sipas ndjekjes së trajnimeve në mesin e mësimdhënësve.....	72
<b>Tabela 22.</b> Karakteristikat përshkruese të pjesëmarrësve në intervistë.....	73

## **LISTA E FIGUARAVE**

<b>Grafiku 1.</b> Rëndësia e vlerësimit të nxënësve.....	29
<b>Grafiku 2.</b> Parimet themelore të vlerësimit.....	30
<b>Grafiku 3.</b> Çfarë duhet të jetë informata kthyesë?.....	35
<b>Grafiku 4.</b> Qëllimet e përdorimit të informatës kthyesë.....	35
<b>Grafiku 5.</b> Rregullat që duhet ndjekur gjatë vlerësimit të ndërsjellë.....	36
<b>Grafiku 6.</b> Rregullat që duhet ndjekur gjatë vetëvlerësimit.....	37
<b>Grafiku 7.</b> Rëndësia e shfrytëzimit të dosjes.....	38
<b>Grafiku 8.</b> Llojet e pyetjeve sipas funksionit.....	39
<b>Grafiku 9.</b> Strategjitë kryesore të VpN.....	42

## **LISTA E SHKURTESAVE**

<b>MASH</b>	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale e Arsimit
<b>KKK</b>	Korniza Kurrikulare e Kosovës
<b>KB</b>	Kurrikula Bërthamë
<b>UA</b>	Udhëzimi Administrativ
<b>VB</b>	Vlerësimi i Brendshëm
<b>VpN</b>	Vlerësimi për të Nxënë / Vlerësimi formativ
<b>ViN</b>	Vlerësimi i të Nxënit / Vlerësimi përmbledhës
<b>ISCED</b>	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit i miratuar nga UNESCO në Konferencën e Përgjithshme në sesionin e saj të 29-të në Nëntor 1997 e ndryshuar me kalimin e kohës
<b>RN</b>	Rezultatet e të Nxënit

## I. HYRJE

Gjatë dekadave të shekullit të fundit kanë ndodhur ndryshime politike, sociale, ekonomike dhe ato mjedisore që kanë sjellë edhe ndryshime të mëdha në sistemin arsimor në Kosovë. Këto ndryshime kanë sjellë detyra dhe sfida të reja në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies duke përfshirë këtu edhe vlerësimin si proces të rëndësishëm. Sistemi i vlerësimit të nxënësve është një nga reformat më të mëdha që ka projektuar Korniza e Kurrikulës (KK). Vlerësimi sipas kurrikulës, planifikon ndryshime në anën strukturore duke adresuar aspektet e dallimit midis vlerësimit të vazhdueshëm (vlerësimi formativ dhe vlerësimi përmbledhës) gjatë gjithë vitit mësimor, vlerësimi përfundimtar (në fund të vitit shkollor) dhe vlerësimit përmbyllës (në fund të shkollës). Në këtë hulumtim u shqyrtua vlerësimi formativ (VpN) i cili është proces i vëzhgimit sistematik që siguron një kuptim më të mirë të asaj se çfarë kanë mësuar nxënësit dhe si do të angazhohen ata thellësisht në procesin e të nxënësve. VpN drejton nxënësit në procesin e të nxënësve dhe u mundëson atyre të fitojnë aftësi të nevojshme që do të jenë të dobishme për arritjen e rezultateve më të mira. Për ta realizuar vlerësimin formativ (VpN) i cili mbikqyrë përparimin gjatë procesit të të nxënësve, siguron informatat kthyesë për ta lehtësuar të nxënësve dhe për ta përmirësuar mësimdhënien, ekzistojnë disa teknika që ndihmojnë këtë proces. Këto teknika mundësojnë vlerësimin e punës së bërë dhe diskutimin e rezultateve me qëllim të përmirësimit të punës ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësve që do të thotë se VpN krijon mundësinë e gjetjes së mënyrave më të përshtatshme të përmirësimit të të nxënësve. Sigurimi i marrëdhënieve të mira në mes të nxënësve dhe mësimdhënësve u jep mundësi nxënësve të zhvillojnë të kuptuarit e vetes dhe të tjerëve, krijon një klimë të karakterizuar nga mbështetja pozitive, ngrohtësia, respekti personal dhe përgjegjësitë. Mësuesi si një lehtësues i bashkëveprimit të fëmijëve me njëri tjetrin, u jep mundësi nxënësve për zhvillimin e vetëvlerësimit, kompetencave sociale dhe rritjes intelektuale. Gjithashtu teknikat mundësojnë vlerësimin në çdo fazë të orës së mësimin (në fillim, gjatë dhe në fund të orës). Pra, vetëvlerësimi si një nga teknikat e vlerësimit formativ krijon kushtet që mësimdhënësia t'i përshtatet diversitetit të nevojave të nxënësve.

Praktikat më të mira rajonale dhe ndërkombëtare kanë dëshmuar se kur nxënësit marrin pjesë në procesin e të nxënësve dhe vlerësimin e tij, rriten standardet e arritshmërisë dhe nxënësit inkurajohen të ndërmarin veprime për përmirësimin e të nxënësve të tyre. Andaj besoj që studimi do t'i kontribuojë mësimdhënësve dhe nxënësve drejt përmirësimit të qëllimeve.

## **1.1.Problemi i hulumtimit**

Ndryshimet në shoqëri bëjnë që edhe mësimitdhënësit të përballen me detyra të reja në klasat e tyre. Ata ballafaqohen me mënyra të ndryshme të mësimitdhënies dhe detyra të cilat duhet t'u përshtaten nxënësve dhe mënyrës se si mësojnë ata, edhe pse nuk janë të sigurtë se cilat ndryshime tjera i presin në të ardhmen. Gjatë dekadave të fundit, ndryshimet politike, sociale, ekonomike dhe ato mjedisore, e po ashtu edhe zhvillimi i shkencës dhe teknologjisë kanë bërë që çdo aspekt i lidhur me shkollën të shqyrtohet dhe të rishikohet, duke përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve. Deri vonë, vlerësimi në klasë është konsideruar si një mekanizëm për sigurimin e një indeksi të nxënies, i cili ka marrë për bazë një model të parashikuar: mësimitdhënësit japin mësim, i testojnë njohuritë e nxënësve për përmbajtje të caktuara, gjykojnë për arritjet e tyre bazuar në ato 'testime' dhe më pas vazhdojnë me njësi të reja. Kjo mënyrë e vlerësimit sot është vënë në pikëpyetje sepse pritjet shoqërore për arsimin sot kanë ndryshuar, shkencat kognitive kanë dhënë rezultate të reja për natyrën e të nxënies, dhe roli tradicional i vlerësimit për motivimin e të nxënies tashmë është sfiduar. Me qëllim të përgatitjes së nxënësve për shkathtësitë e shekullit 21 është e nevojshme që të përdoret edhe vlerësimi i shekullit 21 apo Vlerësimi Formativ.

Ndryshimet në pritjet shoqërore, njohuritë për të nxënies dhe për motivimin ndikojnë në punën e mësimitdhënësve, në atë se si japin mësim, çka u mësojnë nxënësve dhe në veçanti, si i zbatojnë praktikatat e vlerësimit në klasë.

## **1.2.Qëllimi i hulumtimit**

Bazuar në zbatimin e Kurrikulës së Re dhe vështirësitë në aplikimin e saj, objekti i studimit tonë është hulumtimi i teknikave të vlerësimit formativ.

Qëllimi i hulumtimit është analiza e teknikave të vlerësimit formativ si dhe ndikimi i tyre në arritjen e rezultateve të të nxënies në lëndën e gjuhës shqipe. Që të kemi një pasqyrë të këtyre rezultateve hulumtimi në fjalë, konstaton efektet që sjellin teknikatat e vlerësimit formativ gjatë procesit të vazhdueshëm në mësimitnxënies, analizon përceptimet e mësimitdhënësve për teknikatat e vlerësimit formativ, nxjerr përfundimet dhe jep rekomandimet rreth kësaj çështje bazuar në rezultate.

## **1.2.1.Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat**

### **Pyetja themelore e këtij hulumtimi është:**

- Çfarë ndikimi ka përdorimi i teknikave të vlerësimit formativ në arritjen e rezultateve të të nxëniet në lëndën e gjuhës shqipe?

### **Nënpyetjet:**

- Cilat janë teknikat më të përshtatshme vlerësuese për aplikim në lëndën e gjuhës shqipe?
- Sa i përdorin mësuesit vetëvlerësimin, vlerësimin e ndërsjellë dhe informatën kthyesë si teknika të vlerësimit formativ?
- Cilat vështirësi paraqiten me rastin e implementimit dhe zbatimit të këtyre teknikave vlerësuese?

### **Hipotezat e hulumtimit**

#### **Hipoteza themelore e hulumtimit është:**

Në procesin e mësimit, përdorimi i teknikave të vlerësimit formativ ndikon ndjeshëm në arritjen e rezultateve të të nxëniet në lëndën e gjuhës shqipe.

#### **Nëhipotezat e hulumtimit janë:**

- Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i ndërsjellë ndihmojnë dhe nxisin pjesëmarrjen aktive të nxënësve në diskutime dhe në aktivitete që realizohen brenda shkollës në lëndën e gjuhës shqipe.
- Informatat kthyesë bëjnë më të qarta përparimet dhe vështirësitë e nxënësve në procesin mësimor.

## **II. SHQYRTIMI I LITERATURËS**

Një nga pyetjet më të shpeshta që bëjnë mësuesit gjatë përvojës së tyre është “Po me vlerësimin, si t’ia bëjmë?”. Vlerësimi nuk është çështje e lehtë. Mësuesit vlerësojnë proceset e të nxëniet të nxënësve, ata vëzhgojnë me shumë kujdes për të parë nëse nxënësit mund të kryejnë apo jo veprimtaritë e të nxëniet që u janë mësuar dhe të gjejnë mënyra të përmirësojnë të nxëniet e tyre, gjithashtu vlerësojnë edhe cilësinë e të menduarit të nxënësve. Është shumë e dobishme që mësuesi të reflektojë rreth zhvillimit të punës së tij, për aspekte të veçanta të kësaj veprimtarie, siç është vetëvlerësimi. Vitet e fundit, kjo cilësi e mendimit kritik të vetë mësuesit për punën e tij, në vendet me arsim të zhvilluar, ka marrë emërtimin “mësimdhënie reflektive” dhe i shërben

përveç të tjerave, kualifikimit të tyre (Kraja, 2006). Për të zbutur sado pak dilemat e tyre dhe për të arritur rezultate sa më të mira në mësimdhënie sidomos gjatë proceseve të ndryshimit mësuesit duhet të marrin pjesë në seminare për trajnimin e aftësive .....që të mësojnë se si t'i përdorin risitë, si të gjykojnë për dobitë e tyre në bazë të informacionit që kanë; Ata do të jenë në gjendje më të mirë të kuptojnë, nëse duhet të pranojnë, ndryshojnë ose përshtasin ndryshimin (Fullan, 2010). Vlerësimi është një proces shumë delikat dhe mjaft i ndërlikuar gjatë të cilit duhet të sigurohen informata të sakta për atë që dëshirojmë ta vlerësojmë, është proces i vrojtimit sistematik dhe i shqyrtimit të hollësishëm të informatave me qëllim të zbulimit të veçorive dhe shenjave dalluese të asaj që jemi duke e vlerësuar. Vlerësimi është proces i mbledhjes sistematike, analizimit dhe interpretimit të informatave me qëllim të determinimit se në çfarë shkalle nxënësi i ka zotëruar objektivat (Zeneli, 2003). Sido që të përkufizohet vlerësimi, pak mësimdhënës do ta vinin në dyshim rëndësinë e tij. Vlerësimi është një grup i nevojshëm veprimtarish, në të cilat zhvilluesit dhe zbatuesit e mësimdhënies mbledhin të dhëna, për të arritur në gjykime lidhur me mënyrën se si e realizojnë atë. Krahas përkufizimeve të shumta të vlerësimit, interpretime të shumta janë bërë edhe për llojet e vlerësimit. Çdo herë janë bërë përpjekje për të përmirësuar praktikën e vlerësimit të nxënësve. Në sistemin tonë arsimor ekzistojnë një numër vlerësimesh, ku ndër më të rëndësishmet konsiderohen vlerësimi për nxënie (VpN) dhe vlerësimi i të nxënësve (ViN).

Vlerësimi për nxënie (VpN) ...është proces i vëzhgimit sistematik që siguron një kuptim më të mirë të asaj se çfarë kanë mësuar nxënësit dhe si do të angazhohen ata thellësisht në procesin e të nxënësve. Ai i drejton nxënësit dhe u mundëson atyre të fitojnë aftësi të nevojshme që do të jenë të dobishme për arritjen e rezultateve më të mira (Assessment Reform Group, 2002). Vlerësimi i vazhdueshëm është pjesë përbërëse edhe në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës. Ajo promovon shfrytëzimin e vlerësimit formativ vazhdimisht që të sjellë rezultate sa më të mira në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Vlerësimi formativ ka të bëjë me të gjitha aktivitetet e mësimdhënësve dhe/ose të nxënësve që sigurojnë informatë se çka do të shfrytëzohet për tu përmirësuar mësimdhënia dhe mësimnxënia (Black, Paul & Wiliam, Dylan, 1998). Që të përmirësohet mësimnxënia, vlerësimi duhet të jetë formativ. Aktivitetet e mësimdhënësve dhe të nxënësve gjatë procesit mësimor nëpërmjet vlerësimit formativ vazhdimisht gërshetohen. Qëllimin e kanë të njëjtë, si të gjejnë dhe të shfrytëzojnë strategji dhe teknika përkatëse për mësimdhënie dhe mësimnxënie që do të ndihmojnë që nga niveli ekzistues i tyre të arrijnë në

nivelin më të lartë të planifikuar. Teknikat kyçe të vlerësimit formativ janë: informatat kthyese, vetëvlerësimi, vlerësimi i ndërsjellë dhe parashtrimi i pyetjeve. Informatat kthyese janë një pjesë shumë e rëndësishme e të nxënësit. Ato janë mekanizma që i lejojnë nxënësit ta dinë nëse ata janë në rrugën e duhur. Informatat kthyese janë reagime për rezultatet e një procesi apo aktiviteti. Vetëvlerësimi është mjet i rëndësishëm për vlerësimin për nxënie – VpN. Kur nxënësi vlerëson njohuritë e tij momentale, lëshimet dhe gabimet gjatë të nxënësit, ai fiton ide më të qarta se si t'i ndihmojë vetes për t'u përmirësuar. Vetëvlerësimi u ndihmon nxënësve që të reflektojnë në mënyrë kritike për arritjet dhe sjelljet e veta, duke identifikuar aspektet në të cilat duhet të punojnë më shumë dhe aspektet ku kanë përparuar më shumë (Watson, 1994). Ndërsa, gjatë vlerësimit të ndërsjellë derisa nxënësit vlerësojnë punën e bashkëmoshatarëve të tyre gjithnjë duke u bazuar në kriteret e dhëna nga mësuesi, ata mund t'i qartësojnë edhe idetë e tyre për qëllimet e të nxënësit dhe kriteret e suksesit. Vlerësimi i ndërsjellë ndihmon në krijimin e një komuniteti të të nxënësit brenda klasës (Mueller, 2012). E sa i përket parashtrimit të pyetjeve hulumtimit tregojnë se parashtrimi i pyetjeve paraqet faktorin më të rëndësishëm individual që nxënësit të arrijnë standarde të larta, kur pyetjet përdoren që të vlerësohen njohuritë e nxënësve dhe të sfidohet të menduarit e tyre (Ofsted, 1996). Këto teknika të VpN-ës dhe shumë të tjera që sigurojnë rezultate në arritjen e rezultateve të të nxënësit u shqyrtaun më në hollësi gjatë këtij hulumtimi meqë vlerësimi është një rrugë drejt një fundi, por jo fund në vetvete.

## **2.1. Sqarimi i nocioneve themelore**

### ***Vlerësimi formativ***

Vlerësimi formativ është vlerësim për mësimin. Ky lloj vlerësimi shpesh është i pa klasifikuar dhe joformal. Qëllimi i tij është t'u sigurojë nxënësve dhe mësuesve një matës se ku është niveli i tyre i të kuptuarit në momentin aktual, dhe t'i mundësojë mësuesit të përshtatet në përputhje me rrethanat për të përmbushur nevojat e reja të klasës.

Vlerësimi formativ është veçanërisht i rëndësishëm sepse lejon të bëhen ndryshime që prekin nxënësit aktualisht, ndërsa format e vlerësimit përfundimtar ndikojnë vetëm në klasat e ardhshme. Për më tepër, vlerësimi formativ sinjalizon nxënësit se mësuesit janë vërtet të interesuar për atë që mësojnë ata dhe si po përgjigjen ndaj mësimin të mësuesit.

### ***Rezultatet e të nxënit***

Rezultatet e të nxënit janë deklarata që përshkruajnë njohuritë ose aftësitë që nxënësit duhet të marrin deri në fund të një detyre, ore, lënde ose klase dhe i ndihmojnë atyre të kuptojnë se pse ato njohuri dhe ato aftësi do të jenë të dobishme për ta. Ato fokusohen në kontekstin dhe aplikimet e mundshme të njohurive dhe aftësive, ndihmojnë nxënësit të lidhin mësimin në kontekste të ndryshme dhe ndihmojnë në udhëzimin e vlerësimit.

Rezultatet e mira të të nxënit theksojnë zbatimin dhe integrimin e njohurive. Në vend që të përqendroheni në mbulimin e materialit, rezultatet e të nxënit artikulojnë sesi nxënësit do të jenë në gjendje të përdorin materialin, si në kontekstin e klasës ashtu edhe më gjerë.

Dallimi midis rezultateve të të nxënit dhe objektivave të të mësuarit nuk njihet në mënyrë universale dhe shumë mësimdhënës mund të zbulojnë se termi "rezultate të të nxënit" përshkruan atë që ata tashmë e kanë kuptuar me termin "objektivat e të mësuarit". Disa studiues nuk bëjnë dallim midis dy termave, ata zakonisht sugjerojnë që rezultatet e të nxënit janë një nëngrup ose lloj i objektivit të të nxënit. Objektivat e mësimit, për shembull, mund të përshkruajnë materialin që mësuesi ka ndërmend të mbulojë ose pyetjet disiplinore që lënda do të trajtojë. Në të kundërt, rezultatet e të nxënit duhet të përqendrohen në atë që nxënësi duhet të dijë dhe realisht të jetë në gjendje të bëjë deri në fund të një detyre, aktiviteti, ore ose klase. Qëllimet e njëjta të adresuara nga objektivat e të mësuarit mund të adresohen në mënyrë të barabartë nga rezultatet e të nxënit, por duke u përqëndruar në aplikimin dhe integrimin e përmbajtjes së lëndës nga perspektiva e nxënësit, rezultatet e të nxënit mund të adresojnë më qartë dhe drejtpërdrejt pritjet për arritjet e nxënësve.

Shumë mësimdhënës mund të zbulojnë se procesi reflektues i zhvillimit të rezultateve të të nxënit është diçka që ata e kanë përfshirë tashmë në proceset e tyre të planifikimit të lëndëve. Frazja 'rezultatet e të nxënit' thjesht ofron një term më të saktë për të diskutuar krijimin e qëllimeve dhe pritjeve të të nxënit që përqendrohen në aplikimin dhe integrimin e përmbajtjes së lëndës.

Rezultatet e të nxënit janë të vlefshme për nxënësit, dhe mësimdhënësit. Rezultatet e të nxënit janë më shumë se thjesht disa fjali që i bashkëngjiten planeve mësimore ose kurrikulave ekzistuese; në vend të kësaj, zhvillimi i rezultateve të të nxënit dhe përdorimi i tyre brenda një



njësie formëson aktivitetet e të mësuarit dhe vlerësimit dhe mund të rrisë angazhimin dhe të nxëniet e nxënësve (Battersby, 1999).

Zhvillimi i rezultateve të të nxëniet është bërë një përparësi në rritje për mësimdhënësit dhe institucionet gjatë dekadës së fundit. Vendosja e një fokusi në aftësitë e integruara, të përgjithësueshme dhe të transferueshme plotëson kërkesat bashkëkohore për nxënësit dhe ndërton një bazë për të mësuar gjatë gjithë jetës.

### **2.1.1. Vlerësimi i nxënësve**

Lidhur me vlerësimin e nxënësve është e nevojshme të përcaktohet se si duhet të realizohet ky proces, pra të bëhet një plan veprimi. Vlerësuesit përpiqen të jenë sa më objektiv në përshkrimet e tyre dhe gjykimet e vlerësimet e tyre t'i mbështesin në fakte. Por, jo rrallë ata përdorin përshkrimet dhe analizat logjike të dukurive të vëzhguara dhe mbështeten në teknikat statistikore.

Në manualin e tyre për rishikimin dhe vlerësimin e bazuar në lëndë, përcaktojnë vlerësimin si mbledhja dhe analiza sistematike e informacionit për të përmirësuar të mësuarit e studentëve (Stassen, 2001). Ky përkufizim kap detyrën thelbësore të vlerësimit të nxënësve në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Vlerësimi i nxënësve u mundëson mësimdhënësve të matin efektivitetin e mësimdhënies së tyre duke lidhur performancën e nxënësit me objektivat specifike të të nxëniet. Si rezultat, mësimdhënësit janë në gjendje të institucionalizojnë zgjedhje efektive të mësimdhënies dhe të rishikojnë ato joefektive në pedagogjinë e tyre.

Matja e të mësuarit të nxënësit përmes vlerësimit është e rëndësishme sepse ofron reagime të dobishme si për mësimdhënësit ashtu edhe për nxënësit për shkallën në të cilën nxënësit po përmbushin me sukses rezultatet e të nxëniet të lëndës. Në librin e tyre Kuptimi nga Dizajni, Grant Wiggins dhe Jay McTighe ofrojnë një kornizë për udhëzimet në klasë - atë që ata e quajnë "Dizajn i prapambetur" - që thekson rolin kritik të vlerësimit. Për Wiggins dhe McTighe, vlerësimi u mundëson mësimdhënësve të përcaktojnë metrikat e matjes për të kuptuar nxënësit dhe aftësinë e tyre në rezultatet e të nxëniet të lëndës. Ata argumentojnë se vlerësimi ofron provat e nevojshme për të dokumentuar dhe vërtetuar që të mësuarit kuptimplotë ka ndodhur në klasë.

Vlerësimi është kaq jetësor në modelin e tyre pedagogjik saqë qasja e tyre inkurajon mësuesit dhe planifikuesit e kurrikulës që së pari të mendojnë si vlerësues para se të hartojnë njësi dhe orë mësimore specifike, dhe kështu të marrin në konsideratë përpara se si do të përcaktojnë nëse nxënësit kanë arritur rezultatet e dëshiruara (Wiggins, G. & Mctighe, J., 2005).

Vlerësimi i nxënësve mbështet gjithashtu mësimdhënien kritike reflektuese. Stephen Brookfield, në Bërja e një Mësuesi Kritikisht Reflektues, pretendon se reflektimi kritik mbi mësimdhënien e një personi është një pjesë thelbësore e zhvillimit si një edukator dhe rritjes së përvojës së të nxënësve. Reflektimi kritik mbi mësimin e dikujt ka një mori përfitimesh për mësimdhënësit, përfshirë zhvillimin e arsyeshmërisë për praktikën e mësimdhënies. Sipas Brookfield, një mësuese reflektuese në mënyrë kritike është në gjendje shumë më të mirë për të komunikuar me kolegët dhe nxënësit (si dhe me veten) arsyetimin prapa praktikës së saj. Ajo punon nga një pozicion i angazhimit të informuar (Brookfield, 1995). Vlerësimi i nxënësve, jo vetëm që u mundëson mësuesve të matin efektivitetin e mësimdhënies së tyre, por është gjithashtu i dobishëm në zhvillimin e arsyeshmërisë për zgjedhjet pedagogjike në klasë.

Sistemi i vlerësimit të nxënësve në Kosovë rregullohet me legjislacionin e bazuar në dokumentet e mëposhtme relevante, si:

- a)** Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës,
- b)** Kurrikulat Bërthamë për Tre (3) Nivele të Arsimit Parauniversitar, dhe
- c)** Udhëzimi Administrativ për Vlerësimin e Nxënësve, sipas Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës.

Ky legjislacion vlen për vlerësimin e të gjithë nxënësve, të të gjitha shkollave publike dhe private, si dhe për të gjitha institucionet e niveleve të tjera të arsimit në Kosovë dhe mbështetet në rezultate specifike të të nxënësve të përcaktuara në Kornizën e kurrikulës, Kurrikulat bërthamë, Programet mësimore dhe Planet mësimore.

Sistemi i vlerësimit të nxënësve i përshkruar në Kornizën e Kurrikulës, përcakton rezultatet e të nxënësve që duhet të vlerësohen, kohën kur duhet të bëhet vlerësimi, procedurat e përgjithshme dhe kush kryen vlerësimin për secilin lloj të vlerësimit dhe për secilin nivel të arsimit. Vlerësimi i nxënësve është i bazuar në rezultatet e përcaktuara të të nxënësve sa i përket kompetencave kryesore, programeve mësimore, planeve mësimore, si dhe lëndëve e fushave lëndore në shkollët kryesore të kurrikulës dhe të niveleve të arsimit në Arsimin parauniversitar në Kosovë (MASHT,

2011).

**Tabela 1. Nivelet formale të Arsimit parauniversitar në Kosovë**

Nivelet sipas ISCED		Nivelet formale të Arsimit parauniversitar në Kosovë	Mosha
		Arsimi i të rriturve / Mësimi gjatë gjithë jetës në shkallë të gjerë (Formal dhe Joformal)	23/24+
<b>ISCED 6</b>		Arsimi pasuniversitar	23/24+
<b>ISCED 5</b>		Arsimi universitar	
<b>ISCED 4</b>	Niveli 5 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve	Arsimi pas shkollës së mesme (jo-universitar)	18+
<b>ISCED 3</b>	Niveli 4 Korniza Kombëtare e Kualifikimeve	Arsimi i mesëm i lartë Gjimnazi (Klasa X-XII) Shkolla profesionale (Klasa X-XII)	15-17
	Niveli 3 Korniza Kombëtare e Kualifikimeve	Arsimi i mesëm i lartë Shkolla profesionale (Klasa X-XI)	15-16 Shkollat profesionale
<b>ISCED 2</b>		Arsimi i mesëm i ulët (Klasa VI-IX) Klasa përgatitore	11-14
<b>ISCED 1</b>		Arsimi fillor (Klasa I-V)	6-10
<b>ISCED 0</b>		Klasa përgatitore	5-6
		Arsimi parashkollor	lindja- 5

### 2.1.2. Llojet e vlerësimit

Duke ditur që vlerësimi i referohet një procesi sitematik të mbledhjes, kuptimit dhe veprimit të të dhënave në lidhje me një nxënës, këto të dhëna ndihmojnë në të kuptuarit e nxënësve që mësojnë për atë që dinë dhe çfarë nuk dinë. Gjithashtu, performanca e një nxënësi bëhet në bazë të përvojës së tyre arsimore. Pra, gjatë arsimimit vlerësohet progresi i vazhdueshëm dhe niveli i arritjeve të rezultatetve të të nxënës. Mënyra dhe llojet e vlerësimit përcaktohen edhe me KKK, KB për shkallët kryesore të kurrikulës, programet dhe planet mësimore të lëndës. Ky proces është i orientuar në dy lloje të vlerësimit, siç janë vlerësimi i brendshëm dhe vlerësimi i jashtëm.

- **Vlerësimi i brendshëm** – synon të mbështesë dhe forcojë të nxënës dhe raportimin e rregullt të përparimit individual të nxënësve në zotërimin e kompetencave. Ky vlerësim

bëhet në nivel shkolle apo klase nga mësuesi përkatës sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara në UA. Bazuar në KKK vlerësimi i brendshëm ndahet në tri lloje e që janë:

- **Vlerësimi i vazhdueshëm (Formativ dhe Përmbledhës)**, i cili bëhet në funksion të nxënies dhe mësuesit e që ka të bëjë me tërësinë e mjeteve, të teknikave dhe të praktikave të përdorura nga mësuesi për të testuar, kontrolluar, analizuar dhe matur nivelin e njohurive, aftësive dhe performancës së nxënësve. Ky vlerësim realizohet në tri periudha mësimore në bazë të rezultateve të të nxënësve që arrihen në çdo periudhë me instrumente të ndryshme të hartuara sipas kritereve të caktuara të vlerësimit, gjatë një viti shkollor.
- **Vlerësimi përfundimtar**, i cili realizohet në fund të çdo klase për çdo lëndë e që tregon nivelin e performancës së nxënësve në bazë të rezultateve specifike të përcaktuara Brenda planeve dhe programeve mësimore, në fund të një viti shkollor.
- **Vlerësimi i shkallës kryesore**, i cili realizohet për të verifikuar arritjet e rezultateve të nxënësve në nivel të shkallës kurrikulare me qëllim të organizimit të mësimit. Ky vlerësim bëhet në nivel shkolle nga ekipi profesional, pra këshillat e mësuesve për fushë apo lëndë dhe përfshin vlerësimin e përfundimit të shkallës përkatëse të kurrikulës. Këto rezultate përdoren nga shkolla dhe DKA për përmirësimin dhe avancimin e praktikave të punës dhe raportohen në MASH.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur periudhat e realizimit të secilit lloj të vlerësimit, bartësit / përgjegjësit e vlerësimit, qëllimet kryesore dhe mënyrat e dokumentimit/evidentimit të arritjeve të nxënësve (MASHT, 2016).

**Tabela 2. Periudhat e realizimit të secilit lloj të vlerësimit, bartësit / përgjegjësit e vlerësimit, qëllimet kryesore dhe mënyrat e dokumentimit/evidentimit të arritjeve të nxënësve.**

<b>Llojet e vlerësimit dhe periudha e realizimit</b>	<b>Bartësit</b>	<b>Qëllimet kryesore sipas llojeve të vlerësimit</b>	<b>Dokumentimi/ evidencimi i arritjeve në vlerësim</b>
<b>Vlerësim i vazhdueshëm</b> - Bëhet gjatë procesit të të nxënësve (vlerësimi formativ), dhe - Në fund të çdo teme mësimore, njësie tematike apo periudhe të mësimit (vlerësimi përmbledhës)	Edukatori/ja, mësuesi/ja e klasës	Mbështetja e vazhdueshme e të nxënësve. Informimi dhe raportimi. Vendosja e notës në fund të periudhave të caktuara mësimore.	Evidencimi në notesin e punës së mësuesit Evidencimi në libër të klasës i notave për periudhat e caktuara të vitit mësimor/ dhe apo ditarin elektronik Portfolio e nxënësit

<b>Vlerësim përfundimtar Bëhet në fund të vitit mësimor/ vitit shkollor për secilën lëndë mësimore.</b>	Edukatori/ja, mësimdhënësi/j a e klasës	Vendosja e notës përfundimtare në fund të vitit mësimor/ shkollor. Informimi dhe raportimi Planifikimi për mbështetjen e të nxënit të nxënësve në vitin vijues.	Notat përfundimtare evidencohen në librin e klasës dhe në librin amë/ dhe/apo në ditarin elektronik. Në arsimin bazik (klasat përgatitore, I deri V), notat përfundimtare evidencohen në librezën e nxënësit.
<b>Vlerësim për shkallë Në fund të shkallës 1 dhe 2, përkatësisht në fund të klasëve II dhe V</b>	Ekipi/këshilli i mësimdhënëse (edukatorëve) të cilët kanë realizuar programin mësimor brenda një shkalle kurrikulare	Verifikimi i nivelit të arritjes së rezultateve të të nxënit dhe zotërimi i kompetencave kryesore në nivel të një shkalle dhe fushe kurrikulare. Planifikimi për mbështetjen e të nxënit të nxënësve në vitin vijues Informim dhe raportim për prindërit dhe për institucionet (MASHT-in etj.)	Evidencimi përshkruar në librin e klasës – në faqet e veçanta për vlerësimin për shkallë në fund të çdo shkalle të kurrikulës. Në raportet përmbledhëse të aktiveve profesionale dhe këshillave të klasës

- **Vlerësimi i jashtëm** – synon të mat nivelin e arritjeve të rezultateve të të nxënit dhe zotërimin e kompetencave kryesore të parapara në kurrikulë për fushat kurrikulare apo lëndët mësimore në fund të niveleve. Ky vlerësim në Kosovë organizohet nga MASH në mbarim të klasës së V, IX dhe XII. Të gjitha vlerësimet e jashtme kanë si instrument vlerësimi Testin e standardizuar, të cilat realizohen për *qëllime hulumtimi, orientimi dhe çertifikimi* (Tabela 3). Vlerësimi i cili realizohet në mbarim të klasës së V-të është me karakter hulumtues dhe përdoret nga autoritetet komunale dhe qendrore të arsimit për hulumtime të ndryshme dhe për identifikimin e nevojave për mbështetje të nxënësve.

**Tabela 3. Qëllimet dhe dokumentimi për çdo vlerësim shtetëror**

<b>Vlerësimet e standardizuara shtetërore</b>	<b>Qëllimet e vlerësimit</b>	<b>Dokumentimi/evidentimi</b>
<b>Vlerësimi shtetëror në fund të klasës V</b>	Hulumtimi për aspekte të ndryshme të arsimit dhe identifikimi i nevojave për mbështetje të nxënësve në shkollën e mesme të ulët dhe përmirësimin e nivelit fillor. Realizohet me mostër gjithëpërfshirëse 10/15 % të nxënësve.	Evidentohen nga autoritetet qendrore/komunale për hulumtime dhe identifikim të nevojave për mbështetje të nxënësve në këtë nivel.

<b>Vlerësimi shtetëror në fund të klasës IX</b>	Matja e nivelit të arritjes së Kompetencave dhe orientimi për regjistrim në shkollën e mesme të lartë. Vlerësimi u shërben autoriteteve qendrore/komunale për zhvillimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies.	Çertifikata në fund të klasës IX
<b>Vlerësimi shtetëror në fund të klasës XII - Provimi i Maturës shtetërore</b>	Matja e nivelit të arritjes së kompetencave dhe çertifikimi për mundësi vazhdimi në studime të larta universitare. Nxënësi me arritje të pikëve të caktuara për kalueshmëri në Provimin e Maturës merr Çertifikatë të Provimit të Maturës.	Çertifikata e Maturës Shtetërore

### 2.1.3. Vlerësimi formativ

Vlerësimi formativ, përfshin vlerësimin e të nxënësve gjatë gjithë kohës. Qëllimi i tij themelor është të vlerësojë nivelin e arritjeve të nxënësve në mënyrë që të përmirësojë mësimin e nxënësve gjatë procesit të të nxënësve. Duke interpretuar performancën e nxënësve përmes vlerësimit formativ dhe duke ndarë rezultatet me ta, mësimdhënësit i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë pikat e forta dhe të dobëta të tyre dhe të reflektojnë sesi ata duhet të përmirësohen gjatë mësimëve të tyre të mbetura (Maki, 2002). Pat Hutchings i referohet kësaj forme vlerësimi si vlerësim pas rezultateve. Ajo shprehet se premtimi i vlerësimit - i mandatuar ose ndryshe - është përmirësimi i të mësuarit të nxënësve dhe përmirësimi kërkon vëmendje jo vetëm për rezultatet përfundimtare, por edhe për mënyrën se si ndodhin rezultatet. Vlerësimi pas rezultateve do të thotë të shikojmë me më shumë kujdes procesin dhe kushtet që çojnë në të mësuarit për të cilin na intereson... (Hutchings, 1992). Vlerësimi formativ përfshin zhvillimin e lëndës - ku nxënësit marrin reagime që identifikojnë pikat e forta, të dobëta dhe gjëra të tjera që duhet të mbajnë mend për detyrat e ardhshme - diskutime midis mësimdhënësve dhe nxënësve për temat e njëjësive, u japin një mundësi nxënësve për të identifikuar fusha të rëndësishme për rritjen dhe zhvillimin e nevojshëm për veten e tyre (Brown, S. & Knight, P., 1994).

Është e rëndësishme të pranohet që vlerësimi formativ tregon qëllimin e vlerësimit, jo metodën. Metoda të ndryshme të vlerësimit mund të jenë formuese në orientim, varësisht nga mënyra se si

mësimdhënësi i zbaton ato. Sally Brown dhe Peter Knight në librin e tyre, Vlerësimi i Nxënësve në Arsimin Fillor, paralajmërojnë një konflikt kundër qëllimeve të vlerësimit dhe metodës së tij. Shpesh gabimi bëhet duke supozuar se është metoda që është formuese, dhe jo qëllimi. Ky, sipas tyre, është një gabim serioz sepse largon vëmendjen e vlerësuesit nga çështja thelbësore e reagimeve. Nëse një mësimdhënësi beson se një metodë është e veçantë dhe se është formuese, ai ose ajo mund të bien në grackën e përdorimit të metodës pa marrë kohën e duhur për të rishikuar implikimet e reagimeve me nxënësit. Në raste të tilla, metoda në fjalë funksionon në mënyrë efektive si një formë e vlerësimit përmbledhës, pavarësisht synimeve të mësimdhënësit. Në të vërtetë, reagimet dhe diskutimet janë faktori kritik që bën dallimin midis vlerësimit formativ dhe përmbledhës.

#### **2.1.4. Lënda e gjuhës shqipe, kompetencat dhe rezultatet e të nxënit**

Kurrikula e arsimit parauniversitar është e organizuar në shtatë fusha të kurrikulës. Ato janë bazë e organizimit të procesit mësimor-edukativ në shkollë, për çdo nivel arsimor dhe shkallët përkatëse të kurrikulës.

Një fushë kurrikulare përfshin një ose më shumë lëndë mësimore apo module. Edhe lënda e gjuhës shqipe bën pjesë në fushën gjuhët dhe komunikimi.

KB për arsimin fillor, në lëndën e gjuhës shqipe nxënësve u mundëson zhvillimin e aftësive themelore të komunikimit si përdorimin e gjuhës, shkrim-leximin, pasurimin e fjalorit, zhvillimin e shkathtësive themelore gjuhësore, të kuptuarit përmes dëgjimit, të folurit në funksion të dhënies dhe marrjes së informacionit, lexim-kuptimin, të shkruarit sipas modeleve të thjeshta, dallimin e teksteve letrare, njohjen e formave bazike të sistemit gjuhësor (fonetikë, morfologji, sintaksë), zhvillimin e shkathtësive të të shprehurit nëpërmjet mjeteve të ndryshme audio-vizuale; përdorimin e TIK-ut, formimin e përgjithshëm gjuhësor, letrar, kulturor dhe jetësor.

Nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe nxënësve u mundësohet t'i zhvillojnë shkathtësitë kryesore të gjuhës: të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit dhe të lexuarit, me qëllim të zhvillimit të kompetencave, të cilat i përdorin në jetën e përditshme.

KK përcakton si qëllim kryesor zotërimin e kompetencave kryesore nga nxënësit. Kompetencat kryesore janë:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- Kompetenca e të menduarit
- Kompetenca e të mësuarit
- Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
- Kompetenca personale
- Kompetenca qytetare

Ndërtimi dhe zhvillimi i këtyre kompetencave kryesore janë të domosdoshëm për një individ, me qëllim që të përmbushë me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale. Realizimi i kompetencave kryesore të KK gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kryesore me kompetencat e fushës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënit. Kompetenca përcaktohet si harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit. Kur nxënësi realizon kompetencat gjuhësore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kryesore. Çdo fushë e të nxëni dhe lëndë synon që ta pajisë nxënësin me këto kompetenca. Këtë “mision”, lënda e realizon nëpërmjet ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave të saj. Bazuar në synimet dhe specifikat e lëndës së gjuhës shqipe, pesë kompetencat e saj janë:

- Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.
- Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar.
- Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.
- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.
- Përdorimi i drejtë i gjuhës.

Kompetencat zhvillohen përmes disa tematikave. Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkuptojnë që realizimi i tyre përgjatë vitit shkollor ose shkallës të zhvillohet e ndarë në këtë renditje. Kombinimi dhe ndarja e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në orë mësimi, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (më kryesorët janë mësuesit dhe autorët e teksteve).



Lëndët dhe modulet bazohen në rezultatet e të nxënësve, të përcaktuara për çdo fushë, të cilat e orientojnë procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve në zhvillimin e kompetencave kryesore. Rezultatet e të nxënësve përkufizohen si: Deklarata që përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë një nxënës/se në fund të një shkalle apo niveli. Ato shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Rezultatet e të nxënësve janë hartuar mbi bazë të koncepteve themelore të fushës. RN për fushën *Gjuhët dhe komunikimi* përmbajnë në vete kërkesat që nxënësi duhet t'i arrijë pas përfundimit të çdo shkalle. RN-të përmbajnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat të cilat zhvillohen dhe thellohen gradualisht nëpër shkallë, duke pasur parasysh zhvillimin fizik dhe psikomotorik të nxënësve. Këto rezultate mundësojnë arritjen e gjashtë kompetencave të përcaktuara në kornizën e kurrikulës. Rezultatet e të nxënësve mundësojnë demonstrimin e shkathtësive të komunikimit, zgjidhjen e një problemi, zbatimin e ideve abstrakte për situata konkrete, shfrytëzimin e teknologjisë së përshtatshme, aplikimin e parimeve etike për vendimmarrje, punën si një anëtar i ekipit për të arritur qëllimet e përbashkëta, bisedën për tema personale dhe kulturore.

**Tabela 4. Rezultatet e të nxënësve të fushës gjuhët dhe komunikimi për shkallën 2**

<b>REZULTATET E TË NXËNËSVE TË FUSHËS GJUHËT DHE KOMUNIKIMI PËR SHKALLËN 2</b>	
<b>Shkalla 2</b>	
<b>Klasa III,IV,V (mosha 8-11)</b>	
<b>NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja përmes: të dëgjuarit dhe të folurit; të lexuarit; dhe të shkruarit.</b>	
<b>Të dëgjuarit dhe të folurit</b>	<p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përdor format më komplekse të gjuhës për të komunikuar me të tjerët për përmbajtjen dhe qëllimin e teksteve.</li> <li>2. Identifikon pikat kryesore të bisedave të thjeshta dhe tregimeve që janë lexuar me zë, duke përdorur fraza apo fjali të thjeshta, dëshmon prirjet e veta në lojërat skenike.</li> <li>3. Interpretin tekste letrare, duke u nisur nga komentimi i ngjarjes, ideve, personazheve, rrëfimit, figurave.</li> <li>4. Dallon tekstin letrar nga ai joletrar;</li> <li>5. Paraqet qëndrimin e tij nëpërmjet gjuhës dhe formave të thjeshta të komunikimit për çështje shoqërore që lidhen me interesat, me shqetësimet dhe me besimin e mjedisit ku jeton.</li> <li>6. Ndjek rregullat e paraqitjes në organizimin e shfaqjeve të caktuara dhe përzgjedh punimet për to.</li> <li>7. Interpretin idenë kryesore të një teksti duke e dalluar nga detajet.</li> <li>8. Identifikon dhe përdor kategoritë gramatiko re;</li> <li>9. Përdor informacione nga mjete audio-vizuale (TV, kompjuter etj.)</li> <li>10. Bën pyetje që lidhen me tekste të caktuara dhe të jep përgjigje përkatëse;</li> </ol>
	<p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përdor strategji për të kuptuar materialet e lexuara letrare apo joletrare: poezi, prozë, letër, biografi, lutje, raport, reklamë etj.) duke identifikuar nivele të lexim-kuptimit dhe duke bërë dallimin e gjuhës figurative nga ajo jo figurative;</li> <li>2. Identifikon pjesën themelore të ngjarjeve të tregimeve të lexuara me zë, duke</li> </ol>

<b>Të lexuarit</b>	<p>përdorur fjalë të rëndësishme ose objekte vizuale (fotografi, vizatime etj.) si dhe identifikon kategoritë gramatikore;</p> <p><b>3.</b> Dallon tekstet letrare nga ato joletrare;</p> <p><b>4.</b> Interpreton vepra letrare, duke nisur nga komentimi i ngjarjes, ideve, personazheve, rrëfimit, figurave, si: hiperbola, litota, metafora, dhe nxjerr një përfundim për tekstin letrar apo joletrar (për poezinë, tregimin, pjesën dramatike, raportin, reklamën, biografinë etj.).</p> <p><b>5.</b> Përdor strategjinë e lexim-kuptimit duke interpretuar idenë kryesore të një teksti dhe duke e dalluar atë nga detajet;</p> <p><b>6.</b> Zhvillon aftësitë imagjinative dhe kreative;</p> <p><b>7.</b> Identifikon kategoritë gramatikore në tekste të ndryshme letrare dhe joletrare.</p>
<b>Të shkruarit</b>	<p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <p><b>1.</b> Praktikon formën e caktuar të një teksti letrar apo joletrar;</p> <p><b>2.</b> Zhvillon aftësinë e korrigjimit të gjuhës së teksteve;</p> <p><b>3.</b> Shkruan një tekst të thjeshtë (ese, tekst të ndryshëm);</p> <p><b>4.</b> Shkruan lloje të ndryshme të teksteve letrare dhe joletrare, për tema të caktuara;</p> <p><b>5.</b> Shkruan për një situatë imagjinare;</p> <p><b>6.</b> Shkruan, sipas dëshirës apo me detyrë, tekste që promovojnë vlera të individit e të shoqërisë, lojës, ambientit, familjes, shkollës etj.</p> <p><b>7.</b> Përdor rregulla të drejtshkrimit;</p> <p><b>8.</b> Përdor drejt shenjat e pikësimit;</p> <p><b>9.</b> Përdor teknologjinë informative (kompjuterin, printerin) për të shkruar e vlerësuar një tekst, ngjarje, personazh e ide.</p>

## 2.2. Qëllimet e vlerësimit

Një nga gjërat e para që duhet marrë parasysh kur planifikojmë për vlerësim është qëllimi i tij. Kush do t'i përdorë rezultatet? Për çfarë do t'i përdorim ato?

Vlerësimi përdoret që të:

- ***informojmë dhe drejtojmë mësimdhënien dhe të nxënësit***

Një plan i mirë për vlerësim mbledh prova të të nxënësit të nxënësve që informon vendimet udhëzuese të mësuesve. Ai u siguron mësuesve informacione për atë që nxënësit dinë dhe mund të bëjnë. Për të planifikuar udhëzime efektive, mësuesit gjithashtu duhet të dinë se çfarë keqkupton nxënësi dhe ku qëndrojnë idetë e gabuara. Përveç që ndihmon mësuesit të formulojnë hapat e ardhshëm të mësimdhënies, një plan i mirë për vlerësim ofron një hartë rrugore për nxënësit. Nxënësit duhet, në çdo kohë, të kenë qasje në vlerësim, në mënyrë që ta përdorin atë për të informuar dhe drejtuar të mësuarit e tyre.

- ***ndihmojmë nxënësit të përcaktojnë qëllimet e të nxënësit***

Nxënësit kanë nevojë për mundësi të shpeshta për të reflektuar se ku ka arritur rezultati i tyre dhe çfarë duhet të bëjnë për të arritur qëllimet e tyre të të mësuarit. Kur nxënësit përfshihen në mënyrë aktive në vlerësimin e hapave të tyre të ardhshëm të të nxënësit dhe krijimin e qëllimeve

për t'i realizuar ato, ata bëjnë përparime të mëdha në drejtimin e të mësuarit të tyre dhe asaj që ata e kuptojnë për veten e tyre si nxënës.

- ***informojmë prindërit dhe të përcaktojmë progresin***

Notat u japim prindërve që të informohen me përparimin e fëmijëve të tyre, shkollës dhe të tjerëve si informacion përmbledhës në lidhje me të nxënit e nxënësve për të përcaktuar gatishmërinë e nxënësve për të kaluar në klasën e ardhshme dhe se i kanë rezultatet e domosdoshme të të nxënit me nivelin e arritur.

- ***motivojmë nxënësit***

Kërkimet kanë treguar se nxënësit do të jenë nxënës të motivuar dhe të sigurtë kur ata përjetojnë progres dhe arritje, sesa dështimi dhe humbja që lidhen me krahasimin me shokët më të suksesshëm.

Çelësi është të kuptohet marrëdhënia midis vlerësimit dhe motivimit të nxënësit. Në të kaluarën, ne kemi ndërtuar sisteme vlerësimi për të na ndihmuar të shpërblejmë dhe ndëshkojmë. Dhe ndërsa kjo mund të funksionojë ndonjëherë, kjo bën që shumë nxënës ta shohin veten si dështim. Nëse kjo vazhdon mjaftueshëm, ata humbin besimin dhe pushojnë së provuari. Kur nxënësit përfshihen në procesin e vlerësimit, ata mund ta shohin veten si nxënës kompetentë (Sparks, 1999).

Në sistemin e arsimit parauniversitar tek ne, qëllimi i vlerësimit është mbështetja e të nxënit të nxënësve, këtë qëllim e synon edhe vlerësimi në arsimin fillor. Vlerësimi si proces realizohet në funksion të mësimdhënies dhe të nxënies dhe mbështetet në sistemin e vlerësimit që nënkupton përmbajtjen, kohën, procedurën dhe bartësit e vlerësimit. Përmes sistemit të vlerësimit, sigurohen informacione të vazhdueshme për cilësinë e të nxënit të nxënësve, mësimdhënien dhe përshtatshmërinë e kurrikulës. Mbi bazën e këtyre informacioneve merren vendime dhe planifikohen veprime në përkrahje të nxënësve për zotërim të kompetencave dhe përmirësim e avancim të procesit të mësimdhënies dhe të vlerësimit.

Pikë referimi i vlerësimit të nxënësve në arsimin fillor janë kurrikula bërthamë 1 dhe planet dhe programet mësimore.

*Vlerësimi i nxënësve bazohet në rezultatet e të nxënit për kompetenca, fushë kurrikulare dhe lëndë mësimore të përcaktuara për shkallën e parë dhe të dytë të kurrikulës, si më poshtë:*

<b>Dokumentet kurrikulare</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<b>KURRIKULAT BËRTHAMË 1</b>	Rezultatet e të nxënit për kompetenca dhe fusha kurrikulare për shkallën e parë dhe të dytë.
<b>PLANET E PROGRAMET LËNDORE</b>	Rezultatet e të nxënit sipas fushave /lëndëve (për secilën klasë, duke filluar nga klasa përgatitore deri në klasën e 5-të)

### 2.3. Rëndësia e vlerësimit të nxënësve

Kërkimi i nxënësve për të demonstruar të kuptuarit e tyre të lëndës është kritike për procesin e të mësuarit. Është thelbësore të vlerësohet nëse qëllimet arsimore dhe standardet e mësimave janë përmbushur.

Vlerësimi është një pjesë integrale e udhëzimit, pasi përcakton nëse përmbushen apo jo qëllimet e arsimit. Vlerësimi ndikon në vendimet për notat, avancimin, nevojat mësimore, kurrikulën dhe, në disa raste, financimin. Vlerësimi na frymëzon për të bërë këto pyetje të vështira: "A po mësojmë atë që mendojmë se po mësojmë?" "A po mësojnë nxënësit atë që supozohet të mësojnë?" "A ka ndonjë mënyrë për të dhënë mësim më mirë, duke nxitur kështu një mësim më të mirë?"

Nxënësit e sotëm duhet të dinë jo vetëm aftësitë themelore të leximit dhe aritmetikës, por edhe aftësitë që do t'i lejojnë ata të përballen me një botë që ndryshon vazhdimisht. Ata duhet të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike, të analizojnë dhe të bëjnë konkluzione. Ndryshimet në bazën e aftësive dhe njohurive që u duhen nxënësve tanë kërkojnë qëllime të reja mësimore; këto qëllime të reja të të mësuarit ndryshojnë marrëdhëniet midis vlerësimit dhe udhëzimit. Mësuesit duhet të marrin një rol aktiv në marrjen e vendimeve për qëllimin e vlerësimit dhe përmbajtjen që vlerësohet.

Grant Wiggins, një ekspert i njohur vlerësimi, ndau mendimet e tij për rolin dhe rëndësinë e vlerësimit të performancës së nxënësve, dhe më shumë. Përgjigjet e tij në pyetjen ***Kur vlerësimi funksionon më mirë, ai...ishin:***

- ***ofron reagime diagnostike*** duke na dhënë përgjigje për pyetjet: Cila është baza e njohurive të nxënësit, cila është baza e performancës së nxënësit dhe cilat janë nevojat e nxënësit, çfarë duhet të mësohet?
- ***ndihmon arsimtarët të vendosin standarde*** duke na dhënë përgjigje për pyetjet: Cila performancë demonstroi mirëkuptim, cila performancë demonstroi njohuri dhe cila performancë demonstroi mjeshhtëri?
- ***vlerëson progresin*** duke na dhënë përgjigje për pyetjet: Si po ia kalon nxënësi, cilat metoda ose qasje mësimore janë më efektive dhe çfarë ndryshimesh ose modifikimesh në një orë mësimore janë të nevojshme për të ndihmuar nxënësin?

- **lidhet me përparimin e një nxënësi** duke na dhënë përgjigje për pyetjet: Çfarë ka mësuar nxënësi, a mund të flasë nxënësi për njohuritë e reja dhe a mundet që nxënësi të demonstrojë dhe përdorë aftësitë e reja në projekte të tjera?
- **motivon performancën** për vetëvlerësimin e nxënësve duke na dhënë përgjigje për pyetjet: Tani që jam përgjegjës për mësimin tim, si po ia kaloj, tani që e di se si po shkoj, si mund të bëj më mirë dhe çfarë tjetër do të doja të mësoja?
- **për vetëvlerësimin e mësuesve** duke na dhënë përgjigje për pyetjet: Çfarë po punon për nxënësit, çfarë mund të bëj për të ndihmuar më shumë nxënësit dhe në cilin drejtim duhet të shkojmë më tej?

**Grafiku 1. Rëndësia e vlerësimit të nxënësve**



## 2.4. Parimet themelore të vlerësimit

Rritja dhe të mësuarit e fëmijëve është përgjegjësia kryesore e atyre që japin mësim në shkollat tona. Rritja dhe të mësuarit e nxënësve mund të vërehet dhe matet. Mësimdhënësit, në partneritet me nxënësit, prindërit dhe komunitetin, janë përgjegjës për sigurimin e përmirësimit të arritjeve të nxënësve. Sistemet efektive të vlerësimit nga ana e mësimdhënësve promovojnë përmirësimin e praktikës profesionale që rezultojnë në përmirësimin e performancës së nxënësit. Gjatë planifikimit të vlerësimit është me rëndësi që kërkesat e vlerësimit të plotësojnë parimet e vlerësimit. Një sistem i efektshëm vlerësimi përfshin parimet thelbësore të cilat janë përcaktime dhe kritere që duhet përfillur mësimdhënësit me rastin e përgatitjes së menaxhimit dhe kontrollimit të vlerësimit. Parimet ngrisin vlerën objektive të vlerësimit sidomos kur dihet fakti se si mësimdhënësi ashtu edhe nxënësi për qasje serioze të vlerësimit.

MASH ka zhvilluar Standardet e Vlerësimit dhe Kodin e Etikës së Vlerësimit të Nxënësve. Vlerësimi duhet të jetë gjithmonë në pajtim me normat e këtyre dy dokumenteve. Kur dijmë që

vlerësimi synon mbi të gjitha të përmirësojë nxënien dhe arritjet e nxënësve dhe duhet të sigurojë informata të vazhdueshme dhe të plota mbi arritjet e nxënësve, atëherë vlerësimi duhet të jetë pjesë përbërëse e procesit të mësimdhënies dhe nxënies dhe duhet të bazohet në metoda të ndryshme dhe të shumta. Vlerësimi duhet të jetë i drejtë, transparent, i vlefshëm dhe i sigurt (MASHT, 2011).


***Vlerësimi është i drejtë.*** – Vlerësimi i drejtë i referohet paanshmërisë gjatë zbatimit të vlerësimit, gjatë vlerësimit të të arriturave dhe gjatë interpretimit dhe përdorimit të rezultateve, nuk favorizon (as sipas mënyrës, as sipas përmbajtjes) nxënës në bazë të prejardhjes së tyre, gjinisë së tyre, dhe as në bazë të përvojave të tyre të mëparshme me arsimtarë dhe/ose me metodën e vlerësimit.

***Vlerësimi është transparent.*** – Nxënësit e dinë se çka janë qëllimet e të nxëniet, cilat janë standardet që pritet prej tyre t'i arrijnë dhe si do të vlerësohet arritja e nxënësve (ajo që duhet ta mësojnë, si dhe kur do të vlerësohen). Nxënësit dhe prindërit kanë qasje në vlerësim (në metodat që do të përdoren dhe në rezultatet e përdorimit të tyre).

***Vlerësimi është i vlefshëm dhe i sigurt.*** – Me vlerësim merren informacione që janë relevante për qëllimet dhe përmbajtjet e vlerësimit. Në interpretimin e rezultateve të vlerësimit nuk bëjnë pjesë gjykimet për sjelljen, aftësitë dhe shkathtësitë e nxënësve, që nuk janë objekt i vlerësimit konkret. Vlerësimi është i njëjtë për të gjithë nxënësit si dhe nga të gjithë mësimdhënësit.

Parimet e vlerësimit janë të përcaktuara edhe me KK.

***Grafiku 2. Parimet themelore të vlerësimit***



## 2.5. Ndryshimet në vlerësimin e nxënësve

Për një kohë të gjatë tashmë metodat e vlerësimit në Kosovë kanë qenë paksa tradicionale dhe kanë shërbyer për qëllim shumë të ngushtë. Në të kaluarën në Kosovë, vlerësimin e kemi përdorur për të përcaktuar se cili nga nxënësit do të kalojë dhe cili do të përsëritë vitin. Domethënë e kemi përdorur vetëm për qëllime të përzgjedhjes e të nxjerrjes së gjykimeve. Shpesh e kemi planifikuar vlerësimin vetëm pasi që ka përfunduar faza e mësimdhënies dhe jemi mbështetur kryesisht në format me gojë e me shkrim të vlerësimit, dhe sidomos me teste. Por, duhet të pranojmë se shpesh, vlerësimi duke u bazuar në teste me shkrim e ka vlerësuar kryesisht në mënyrë sipërfaqësore aftësinë e nxënësit për të mbajtur mend faktet e të dhënat dhe nuk e ka vlerësuar tërësinë e shkathtësive të nxënësve tanë. Në këtë mënyrë, ne i kemi detyruar nxënësit të mësojnë vetëm një aspekt të informatave duke i kufizuar ata nëpërmjet të fushëveprimit të provimeve.

Për dallim nga kjo qasje, Vlerësimi i Bazuar në Kompetenca ose rezultate të të nxënësve është më kompleks dhe më shumëdimensional. Mësimdhënësit mund të përdorin një spektër më të gjerë të instrumenteve për të vlerësuar kompetencat e nxënësve – shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e tyre dhe jo vetëm dijen e njohuritë e tyre për fakte. Vlerësimi i bazuar në kompetenca është po ashtu edhe më gjithëpërfshirës dhe shkon përtej një procesi njëkahor. Mësimdhënësit ende i vlerësojnë nxënësit, por ata mundësojnë edhe vetëvlerësimin dhe vlerësimin e ndërsjellë, duke i bazuar në kompetenca është më mirë i integruar në procesin e mësimdhënies e të të nxënësve dhe është në funksion të përmirësimit të praktikave të mësimdhënies. Përmes përdorimit të kësaj qasjeje mësimdhënësit në vazhdimsi e vlerësojnë shkallën dhe vlerën e të nxënësve të demonstruar nga nxënësit dhe, në bazë të informacioneve të këtyre, mund të sjellin gjykime për gjërat që duhet bërë për të përmirësuar rezultatet mësimore të nxënësve.

Mësimi bazuar në kompetenca është më divers dhe më i pasur. Si rregull, aktivitetet mësimore që janë më divers dhe më të pasura rezultojnë me përvoja mësimore më diverse dhe më atraktive dhe të nxënësve më të qëndrueshëm, jo vetëm të fakteve dhe të dhënave, por edhe të shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të reja. Dhe kjo si pasojë kërkon metoda më diverse të vlerësimit. Është e vështirë të vlerësohen dhe identifikohen shkathtësi, shprehje, vlera dhe fakte të reja vetëm me një test të printuar në letër ose vetëm përmes provimit me gojë.

Duke konsideruar vlerësimin, në shumicën e rasteve duhet të bashkohen standardet e caktuara të

kompetencave, në mënyrë që ato të mbulojnë të gjitha njohuritë dhe shkathtësitë relevante të kërkuara për ofrimin e vlerësimit të besueshëm. Këto grupe të kompetencave pastaj shpesh mund të vlerësohen së bashku. Për të menaxhuar këtë duhet mbledhur dëshmi të cilat kur krahasohen me kriteret e performancës, ofrojnë dëshmi të kompetencës. Dëshmitë mund të jetë të ndryshme dhe mund të mblidhet nga një numër i burimeve.

Në vazhdim përmes tabelës do të paraqitet krahasimi i vlerësimit tradicional dhe atij bashkëkohor duke u nisur nga një sërë kriteresh të ndryshme.

**Tabela 5. Vlerësimi tradicional dhe vlerësimi i bazuar në rezultate**

	<b>Vlerësimi tradicional</b>	<b>Vlerësimi i bazuar në rezultate</b>
<b>Fokusi i vlerësimit</b>	Vlerësimi bazohet në dije	Vlerësimi përqëndrohet në matjen dhe testimin e një spektri më të gjerë të shkathtësive, aftësive, vlerave e të tjera.
<b>Niveli i përqëndrimit në qëllimet e të nxënit</b>	Vlerësimi kryesisht bazohet në mbamendjen individuale dhe në të kujtuarit e informatave, fakteve e të tjera.	Vlerësimi bazohet më shumë në vlerat e përbashkëta, në bashkëpunim të ndërsjellë, në vlerësim të ndërsjellë, vetëvlerësim e të tjera.
<b>Koha – kur kryhet vlerësimi?</b>	Vlerësimi kryhet në fund të një periudhe mësimore dhe është i ndarë nga mësimi dhe të nxënit.	Vlerësimi i vazhdueshëm është i ndërthurur me procesin e mësimdhënies e të të nxënit.
<b>Metoda kryesore e vlerësimit</b>	Vlerësimi shpesh bazohet në pyetje me alternativa	Përdoren forma më të llojllojshme, më të hapura dhe jorutinore
<b>Spektri i teknikave të përdorura të vlerësimit</b>	Përdorimi i një numri të kufizuar të teknikave të definuara mirë	Përdorimi i një spektri më të gjerë të teknikave të vlerësimit
<b>Komunikimi i rezultateve</b>	Vlerësimi përfundon me një notë numerike	Vlerësimi ngërthen informata më të hollësishme kthyesë dhe kritikë më përmbajtësore konstruktive për të ndihmuar nxënësit në arritjen e rezultateve të të nxënit

Mësimdhënësi kosovar tashmë përballlet me sfida të shumta në procesin e zbatimit të strategjive dhe teknologjive të reja arsimore. Risitë e reja, si qasja e bazuar në kompetenca, parimi i inkluzionit, mësimi me nxënësin në qendër, mësimi i integruar dhe të nxënit e bazuar në TIK, e shumë qasje të tjera të reja, kërkojnë një ikje nga qasjet e tanishme dhe nga ato tradicionale. Dhe, përderisa qasjet me nxënësin në qendër dhe ato të bazuara në kompetenca mund të jenë më efektive, ato tradicionale janë më të njohura dhe mësimdhënësi mund të ndihet me to më



rehatshëm dhe më pak i sfiduar. Mësimdhënësit kanë nevojë për zhvillim profesional, përkrahje dhe aftësi për t'i ndihmuar ata që të zbatojnë e të përshtaten me strategjitë e reja. Pa zhvillim dhe aftësi dhe aftësi të duhur, mësimdhënësit do të ndihen të stresuar dhe të papërgatitur për të zbatuar strategjitë e reja dhe për të kryer detyrat që dalin para tyre.

Ekzistojnë mënyra të ndryshme të përkufizimit e të kuptuarit të vlerësimit. Mirëpo, qasja bashkëkohore dallon në mënyra të ndryshme dhe thelbësisht nga vlerësimi tradicional. Vlerësimi bashkëkohorë i bazuar në kompetenca:

- teston shkathhtësitë, vlerat dhe qëndrimet, dhe jo vetëm dijen mbi faktet;
- kërkon një llojllojshmëri të metodave të ndryshme, të cilat shpesh mund të jenë jokonvencionale;
- është një aktivitet i vazhdueshëm që ndodh njëkohësisht me procesin e të nxënës;
- i mobilizon nxënësit në mënyrë aktive në vlerësimin e vetvetes;
- duhet të përdoret për të diagnostifikuar vështirësitë në të nxënë dhe në bazë të rezultateve të kësaj, të bëhen përshtatjet, kalibrimet dhe përmirësimet e strategjive të të nxënës.

Kjo qasje sjellë përfitime të shumta. S'do mend se përshtatja me idetë e qasjet e reja asnjëherë nuk është e lehtë. Për këtë arsye, është me rëndësi që të krijohen rrjete të përkrahjes profesionale në shkollë në mënyrë që të mund të diskutohen përvojat, shqetësimet e sukseset dhe të arriturat me mësimdhënësit e tjerë.

### III. VLERËSIMI FORMATIV DHE TEKNIKAT E VpN NË LËNDËN E GJUHËS SHQIPE

Vlerësimi formativ në të gjitha lëndët, gjithashtu edhe në lëndën e gjuhës shqipe shërben për të mbledhur informata kthyese si dhe për të korigjuar më pas punën në secilën fazë të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Çdo vlerësim i cili ka për qëllim t'i shërbejë nxitjes së nxënësve për të nxënë, është zakonisht vlerësim joformal, i ngulitur në të gjitha aspektet e mësimnxënies dhe mësimdhënies, dhe i realizuar nga mësimdhënës të ndryshëm si pjesë e stilit të mësimdhënies së tyre individuale. Biseda e nxënësve në grupe, përgjigjet e tyre në pyetje, parashtrimi i pyetjeve, puna në grupe, dorëzimi i detyrave të shtëpisë madje edhe mënyra se si janë ulur nxënësit, të qetë apo konfuz janë burim potencial i informatës se çfarë kanë kuptuar apo nuk kanë kuptuar. Mësimdhënësi i cili në mënyrë të vetëdijshme përdor vlerësimin për të përkrahur mësimnxënien, e pranon këtë informatë, e analizon dhe merr vendime të cilat i adresohen kuptimeve dhe keqkuptimeve që janë zbuluar. Vlerësimi është formativ kur mësimdhënësit mbledhin të dhëna dhe i interpretojnë provat e të menduarit të nxënësve apo kryerjes së detyrës, dhe pastaj i përdorin ato prova për të marrë vendime të mëtejme për mësimdhënien dhe nxënien. Vlerësimi formativ ka të bëjë me të gjitha aktivitetet e mësimdhënësit dhe/ose të nxënësve që sigurojnë informatë se çka do të shfrytëzohet për t'u përmirësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien (Black, Paul & Wiliam, Dylan, 1998).

Për të realizuar vlerësimin formativ duhet përdorur teknika të ndryshme. Teknikat të cilat konsiderohen si të përshtatshme dhe të suksesshme për vlerësimin e të nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe janë:


- **Informata kthyese** – mundëson identifikimin e vështirësive me të cilat ballafaqohen nxënësit gjatë procesit të nxënies, por njëkohësisht kjo informatë siguron zbulimin e shkaqeve të cilat i sjellin ato vështirësi. Informata kthyese është mekanizëm që i lejon nxënësit të dijë nëse është në rrugën e duhur, është reagim për rezultatet e një procesi apo aktiviteti. Informata kthyese është efektive kur jepet në kohën e duhur – atëherë kur është e domosdoshme për nxënie.

**Grafiku 3. Çfarë duhet të jetë informata kthyesë?**



Hulumtimet tregojnë se të jesh i motivuar dhe të kesh vetëbesim janë çelësi i suksesit të nxënësit. Megjithatë, informata kthyesë përveç “pozitivizmit” duhet t’i tregojë edhe gabimet në mënyrë që ato të përmirësohen.

**Grafiku 4. Qëllimet e përdorimit të informatës kthyesë**




**Vlerësimi i ndërsjellë** – hulumtimet tregojnë se vlerësimi i ndërsjellë është mjaft efektiv. Derisa nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit, ata mund t’i qartësojnë idetë e tyre për qëllimet e të nxënësit dhe kriteret e suksesit. Gjatë vlerësimit të ndërsjellë nxënësit duhet respektuar disa rregulla. Vlerësimi i ndërsjellë ndihmon në krijimin e një komuniteti të të nxënësit brenda klasës




rregulla. Vetëvlerësimi u ndihmon nxënësve që të reflektojnë në mënyrë kritike për arritjet dhe sjelljet e veta, duke identifikuar aspektet në të cilat duhet të punojnë më shumë dhe aspektet ku kanë përparuar më shumë (Watson, 1994).

**Grafiku 6. Rregullat që duhet ndjekur gjatë vetëvlerësimit**



- **Ngjyrat e semaforit** – është një teknikë shumë efikase që ia mundëson nxënësit të reflektojë për veten e tij nëse ka kuptuar ose jo një çështje apo detyra të caktuar. Në të njëjtën kohë i komunikohet mesimdhënësit të kuptuarit ose jo për secilin nxënës në mënyrë individuale.
- **Di/dua të di/mësova** – është një teknikë që mundëson një vetëkontroll të të nxënësit dhe të kuptuarit.
- **Dosja (portfolio)** – është një “koleksion” i qëllimshëm i punimeve të nxënësit që tregon për përprekjet, përparimin dhe të arriturat e tij në një fushë mësimore të caktuar. Dosja duhet të përfshijë pjesëmarrjen e nxënësit në përzgjedhjen e përmbajtjes së saj, udhëzimet për përzgjedhje dhe kriterin e vlerësimit për të dëshmuar meritat dhe dëshmitë e vetë-reflektimit të nxënësit. Dosja përbëhet prej pjesëve të provave, sa më shumë prova të përshtatshme, nxjerrja e përfundimeve për nivelin e arritshmërisë së nxënësit në një fushë mësimore është më e vlefshme.

**Grafiku 7. Rëndësia e shfrytëzimit të dosjes**



- **Parashtrimi i pyetjeve** – i shërbejnë jo vetëm VpN, por ato janë shumë të rëndësishme edhe në kontekst të ViN – notimit. Edhe hulumtimet e ndryshme tregojnë se: Mësimdhënësit mund të parashtrorjnë mesatarisht nga një pyetje, madje nga dy pyetje në minut, që do të thotë se rreth njëqind në ditë ose mijëra pyetje gjatë një viti shkollor (Wragg, 1997); Nxënësit mësojnë më shumë kur mësimdhënësit parashtrorjnë pyetje më shpesh gjatë përcjelljes së përparimit dhe kontrollimit të të kuptuarit (Harris, 1998); Parashtrimi i pyetjeve paraqet faktorin më të rëndësishëm individual që nxënësit të arrijnë standarde të larta, kur pyetjet përdoren që të vlerësohen njohuritë e nxënësve dhe të sfidohet të menduarit e tyre (Ofsted, 1996). Parashtrimi i pyetjeve që kërkojnë të menduarit e niveleve të ndryshme përdoren si instrumente për VpN. Në këtë rast mësimdhënësit shfrytëzojnë pyetjet dhe analizojnë

përgjigjet për të kuptuar se çka dinë nxënësit, çka kuptojnë dhe çfarë mund të bëjnë ata, çarë ide të gabuara kanë nxënësit me qëllim të orientimit të drejtë të të nxënësve të tyre efektiv, si dhe që ta përmirësojnë si mësimdhënien ashtu edhe të nxënësve.

Pyetjet dhe teknikat e të pyeturit kanë vlera të shumëfishta. Për të nxitur të menduarit e nxënësve është e rëndësishme të konsiderojmë nivelin e pyetjeve që bënë mësimdhënësi. Në qoftë se pyetjet janë të gjitha të nivelit të njohjes, atëherë të menduarit ndodhë pak ose aspak. Të përsëriturit mekanik, riprodhues, është i nevojshëm për termat e reja që mësohen për rregullat apo për të dhënë shpjegime të ndryshme, por jo edhe për të nxitur të menduarit e nivelit të lartë. Parashtrimi i pyetjeve duhet të bëhet sipas niveleve të të menduarit – Taksonomia e Blum-it (njohja, të kuptuarit, zbatimi, analiza, sinteza dhe vlerësimi).

**Grafiku 8. Llojet e pyetjeve sipas funksionit**

të mbyllura	të hapura	nxitëse	për shkëmbime të zgjeruara	për përgjigje të menjëhershme e specifike
<ul style="list-style-type: none"> <li>•për të vlerësuar njohuritë apo të kuptuarit e nxënësve për materialet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose për të paraqitur tema për diskutime.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•që u kërkojnë nxënësve të përdorin, lidhin apo zbatojnë ide, japin arsye, përmbledhin apo vlerësojnë dhe shpesh përfshijnë përgjigje të zgjeruara, që u mundësojnë atyre të paraqesin të kuptuarit më të thellë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•për t'i inkurajuar ose drejtuar përgjigjet e nxënësve tek aspektet specifike të të nxënësve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•përfshijnë pyetje të shumta që rrjedhin ndaj përgjigjeve fillestare të nxënësve me qëllim të nxitjes së të menduarit të nivelit të lartë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•përdoren për të nxitur të nxënësve e mëtejshëm.</li> </ul>

### 3.1. Karakteristikat e VpN dhe strategjitë për arritjen e kompetencave

VpN përfshin përdorimin e strategjive dhe metodave të ndryshme me qëllim të ngritjes së rezultateve të nxënësve në mësim. Kjo arrihet më së miri nëse nxënësit kuptojnë qëllimin e të nxënësve, ku gjenden ato qëllime dhe në çfarë mënyre mund të arrijnë t'i përmbushin ato. Duke u bazuar në Parimet e Vlerësimit për nxënie dhe Standardet e Vlerësimit, vlerësimi si komponente e mësimdhënies dhe mësimnxënies përfshin:

- Shkëmbimin e qëllimeve të të nxënësve me nxënësit;
- Orientimin dhe ndihmën e nxënësve drejt përmbushjes së standardeve të caktuara;
- Besimin që secili nxënës mund të përmirësohet në raport me të arriturat paraprake;
- Përdorimin e vlerësimit të ndërsjellë dhe vetëvlerësimit për të zbuluar aspektet në të cilat nxënësi duhet të përmirësohet;
- Përfshirja e mësimdhënësve dhe nxënësve në rishikimin dhe reflektimin e informatave për vlerësim.

Shkollat dhe mësimdhënësit duhet të praktikojnë një sistem të drejtë, të besueshëm dhe transparent të vlerësimit. Nxënësit dhe prindërit duhet të njoftohen me kohë dhe në mënyrë adekuate me rezultatet e pritura, mjetet, procedurat dhe kriteret e vlerësimit.

Dy dokumente të rëndësishme që i ndihmojnë shkollat në përmbushjen e detyrave të tyre me përgjegjësi, në lidhje me vlerësimin, janë Kodi i Etikës për Vlerësim si dhe Standardet e Vlerësimit.

VpN mundëson:

- *Vlerësim të saktë* – duke i njohur standardet, duke e gjykuar drejtë punën e nxënësve dhe duke vlerësuar saktë në bazë të KKK;
- *Vlerësim të drejtë* – duke e ditur se metodat e shfrytëzuara janë të vlefshme;
- *Vlerësim të besueshëm* – duke u siguruar se gjykimet janë të qëndrueshme dhe të bazuara në një gamë të dhënash;
- *Vlerësim të dobishëm* – duke i identifikuar pengesat e përparimit të nxënësve dhe duke i shfrytëzuar ato të dhëna për të planifikuar dhe për t'i shqyrtuar hapat tjerë të të nxënësve;
- *Vlerësim të fokusuar* – duke i identifikuar fushat ku nxënësit kanë pengesa për të përparuar, përqëndrim në fusha të caktuara dhe punë hap pas hapi;



**Tabela 6. Karakteristikat e VpN dhe përshtatja me strategjitë e mësimdhënies**

<b>Karakteristikat themelore të VpN</b>	<b>Strategjitë e mësimdhënies</b>
<b>Ndarja e qëllimeve të të nxënës bashkë me nxënësit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndani qëllimet e mësimin në fillim të orës mësimore dhe kur është e përshtatshme, në gjuhën që është e kuptueshme për nxënësit;</li> <li>• Përdorni këto qëllime si bazë për të bërë pyetje dhe për të shkëmbyer informacione;</li> <li>• Vlerësoni këto informacione në raport me arritshmërinë e qëllimeve mësimore për njoftimin me hapat e ardhshëm të planifikimit.</li> </ul>
<b>Ndihma e nxënësve për të njohur standardet që ata synojnë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Jepni kritere të qarta të suksesit dhe lidhni ato me objektivat e të nxënës;</li> <li>• Shkruani shembuj të mirë në tabelë;</li> <li>• Tregoni nxënësve punët që i kanë plotësuar kriteret me shpjegime;</li> <li>• Siguroni se janë paraqitur qartë pritshmëritë e lidhura me prezantimin e punës;</li> <li>• Paraqitni punën e nxënësve që tregojnë një përparim.</li> </ul>
<b>Përfshirja e nxënësve në vlerësimin e bashkëmoshatarëve dhe vetëvlerësim</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mundësoni që nxënësit të marrin përgjegjësinë për të biseduar për ato që kanë mësuar dhe edhe çfarë ishte e vështirë për ata për t'i përmbushur qëllimet e të nxënës;</li> <li>• Inkurajoni nxënësit për të punuar/ diskutuar bashkë, duke u përqëndruar në atë se si t'i përmirësojnë të arriturat e tyre;</li> <li>• Kërkoni nga nxënësit t'i shprehin mendimet e tyre;</li> <li>• Jepni kohë nxënësve të reflektojnë për të nxënës e tyre;</li> <li>• Identifikoni bashkë me nxënësit hapat e ardhshëm të të nxënës.</li> </ul>
<b>Sigurimi me informata kthyesë të cilat u mundësojnë nxënësve të njihen me hapat e ardhshëm, dhe mënyrën e realizimit të tyre</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Jepni informata kthyesë me gojë dhe me shkrim;</li> <li>• Sigurohuni se informatat janë dobiprurëse dhe pozitive të cilat identifikojnë se nxënësi e ka bërë mirë detyrën, çfarë duhet të bëjë ai/ajo për të përmirësuar atë punë dhe si duhet ta bëjë;</li> <li>• Identifikoni që hapat e ardhshëm të jenë të përshtatshëm për grupet e nxënësve apo për nxënësit në veçanti.</li> </ul>
<b>Garantimi i besueshmërisë që çdo nxënësi ka mundësi ta përmirësojë punën e tij/saj</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikoni hapa të vegjël që u mundësojnë nxënësve të shohin përparimin e tyre me besueshmëri dhe vetë-besim.</li> <li>• Inkurajoni nxënësit ta shpjegojnë të menduarit dhe të arsyetojnë në klasë, të sigurtë, ku mbizotëron një etikë e lartë.</li> </ul>
<b>Përfshirja e mësimdhënësve dhe nxënësve në</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Reflektoni bashkë me nxënësit për punën e tyre, p.sh. nëpërmjet hapave që janë zhvilluar gjatë hetimit të një ngjarjeje;</li> <li>• Zgjedhni detyra të përshtatshme për të dhënë informata cilësore, (me theks të veçantë në proces e jo sa për t'i korigjuar përgjigjet);</li> </ul>

**rishikimin dhe reflektimin e informatave për vlerësim**

- Siguroni kohë të mjaftueshme që nxënësit të mund të reflektojnë për ato që i kanë mësuar dhe kuptuar në mënyrë që të identifikohen çështjet për të cilat ata ende kanë vështirësi;
- Rishikoni planifikimin, vlerësoni efikasitetin e detyrave, burimeve, etj., si rezultat i vlerësimit tuaj dhe të nxënësve.

Hulumtimet kanë dëshmuar se kur nxënësit marrin pjesë në procesin e të nxënit dhe vlerësimin e tij, rriten standardet e arritshmërisë dhe nxënësit inkurajohen të ndërmarin veprime për përmirësimin e të nxënit të tyre. Për këtë arsye është e nevojshme që mësimit të përdorin strategji efektive që mundësojnë përmbushjen e karakteristikave të VpN.

*Grafiku 9. Strategjitë kryesore të VpN*



### **3.2. Roli i mësimit të nxënësve gjatë vlerësimit formativ**

Një nga proceset bazë që qëndron në themel të të mësuarit është vlerësimi i njohurive të nxënësve. Ky proces shënon përgjegjësi të rëndësishme dhe sigurisht kërkon angazhim, përkushtim dhe saktësi.

Si në çdo lëndë tjetër edhe në lëndën e gjuhës shqipe vlerësimi bëhet me qëllim të mbledhjes, sistemimit, evidentimit dhe raportimit të të dhënave për arritjet e nxënësve gjatë gjithë procesit të mësimit. Vlerësimi formativ për këtë lëndë nxënësve u siguron informacione për nivelin e

përvetësimin dhe të arritjes së kompetencave.

Përderisa ne e shohim të qenit "Mësues" si një pozicion i dobishëm për mësimdhënien e kurrikulës, ne gjithashtu e dimë se mësimdhënësit kanë edhe një rol, si vlerësues në klasë. Mësimdhënësi për ta përmbushur rolin e tij në vlerësimin e nxënësve, në raport me kërkesat e standardit për mësimdhënës në fushën e vlerësimit të nxënësve dhe të treguesve të këtij standardi, duhet të përqëndrohet në:

- planifikimin e vlerësimit të nxënësve;
- vlerësimin e vazhdueshëm të përparimit të nxënësve, bazuar në parime, standarde dhe strategji të avancuara të vlerësimit;
- ofrimin e informatave kthyesë për nxënës;
- mbështetjen e të nxënësve të nxënësve;
- interpretimin e të dhënave për të përmirësuar nxënien;
- shfrytëzimin e të dhënave për përmirësimin e procesit të mësimdhënies;
- dokumentimin e dëshmive që mbështesin procesin e vlerësimit të nxënësve;
- raportimin për prindër dhe institucionet që kanë përgjegjësi sa i përket arritjeve të nxënësve;

Roli i mësimdhënësve gjatë vlerësimit formativ është jashtëzakonisht i rëndësishëm sidomos në lëndën e gjuhës shqipe sepse vlerësimin duhet ta përqëndrojë në përvetësimin themelor të leximshkrimit si dhe në të dëgjuarit aktiv, në përdorimin e të kuptuarit të asaj që dëgjon – lexon për të shfaqur mendimin e tij, duke përdorur fjalë të reja, si dhe angazhimin në tekste të shkruara për të zhvilluar njohuritë e fituara.

Gjithashtu mësimdhënësi gjatë vlerësimit në këtë lëndë duhet të vë theksin në mbledhjen e informacioneve nga të mësuarit, të kuptuarit e tekstit (dallimin e elementeve bazë të teksteve letrare dhe jo letrare), përdorimin e thjeshtë të fjalëve me kuptim figurativ, paraqitjen e qartë të mendimeve, lidhjen dhe përmbledhjen e tyre. Vlerësimi, po ashtu, duhet të përqëndrohet te të shprehurit e qartë, të saktë, (drejtshqiptimi dhe drejtshkrimi) në formë të pavarur dhe kreative.

Mësimdhënësi gjatë VpN duhet të synojë sigurimin e informacionit të nevojshëm dhe shumë të rëndësishëm mbi nivelin e njohurive, motivimin e nxënësve drejt të mësuarit duke përcaktuar mundësitë e tyre reale për nxënie, realizimin e objektivave të përcaktuara në programin mësimor si dhe nxitjen e interesit të nxënësit për ngritjen e nivelit të arritjeve të tyre. Këtë mund ta bëjnë duke përdorur strategji dhe teknika të ndryshme të vlerësimit formativ.

## **IV. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT**

Për ta hulumtuar në mënyrë shumë dimensionale përdorimin dhe ndikimin e teknikave të vlerësimit formativ për arritjen e rezultateve të të nxënimit në lëndën e gjuhës shqipe, janë përdorur metoda sasiore dhe cilësore të hulumtimit.

Përmes metodës së analizës teorike është bërë zbërthimi teorik i literaturës së shfytëzuar nga autorë të ndryshëm. Pas studimit dhe analizimit të dukurisë është bërë përshkrimi i të dhënave të nxjerra nga hulumtimi me metodën përshkuese (deskriptive). Me ndihmën e metodës krahasuese është mundësuar të bëhet krahasimi i përgjigjeve të mësimitdhënësve me ato të nxënësve duke përdorur pyetësorët, ku iu është mundësuar të anketuarve që t'u përgjigjen pyetjeve sipas mënyrës së tyre, duke i zgjedhur alternativat për çdo përgjigje. Pjesëmarrësit janë zgjedhur me anë të proceseve të kampionimit të rastësishëm. Pyetësorët janë realizuar, me anë të programit aplikativ Microsoft Excel dhe më pas është bërë lidhja e tyre me programin SPSS (Pakoja Statistike për Shkencat Sociale). Me përdorimin e metodës statistikore janë përpunuar të dhënat dhe janë nxjerrë rezultatet e hulumtimit, të cilat janë paraqitur në mënyrë grafike. Ndërsa, analiza e të dhënave cilësore është bërë me anë të analizës tematike. Gjithashtu nëpërmjet intervistimit, me intervista gjysmë të strukturuar, për të kuptuar më thellësisht qëndrimet e ekspertëve të fushës së vlerësimit lidhur me efektet që kanë teknikat e vlerësimit formativ, duke marrë mendime të ndryshme nga përvojat e tyre.

### **4.1.Pjesëmarrësit dhe mostra**

Në mënyrë që mostra të jetë sa më gjithëpërfshirëse, në hulumtim janë përfshirë 90 nxënës të klasave II-V-ta, 40 mësimitdhënës të arsimit fillor të shkollave publike në komunën e Prishtinës, përkatësisht shfmu “Faik Konica”, shfmu “Xhemajl Mustafa” dhe shfmu “Naim Frashëri”, shkolla të cilat janë ndër të parat që kanë filluar zbatimin e Kurrikulës së Re të Kosovës. Përzgjedhja e mostrës është bërë përmes mostrës së rastësishme (të thjeshtë). Gjithashtu në hulumtim janë përfshirë edhe 5 trajnerë (ekspertë), të zbatimit të vlerësimit formativ. Pra, gjithësej pjesë e hulumtimit janë 135 respondentë.

## **4.2. Instrumentet për mbledhjen e të dhënave**

Në procesin e hulumtimit lidhur me teknikat e vlerësimit formativ janë përdorur:

- teknika e anketimit për mësimdhënës dhe nxënës ku përgjigjet në fletëpyetësorë janë strukturuar paraprakisht, si dhe
- teknika e intervistimit për ekspertët e fushës së vlerësimit, të tipit të hapur që janë realizuar në mënyrë individuale duke iu referuar një udhëzuesi, si program i pikave që mbështetet hulumtimi.

Ndërsa, si instrumente të hulumtimit janë përdorur:

- fletëpyetësori për mësimdhënës
- fletëpyetësori për nxënës dhe
- protokoli i intervistës për ekspertët e fushës së VpN

## **4.3. Procedurat e hulumtimit**

Për realizimin e hulumtimit fillimisht është kërkuar miratimi nga udhëheqësit e shkollave dhe pajtimi nga palët pjesëmarrëse. Pas miratimit për plotësimin e pyetësorëve, pjesëmarrësve u është shpjeguar në detaje për ecurinë e hulumtimit. Të gjithëve u është bërë e ditur se të dhënat do të analizohen dhe do të mbeten krejtësisht konfidenciale dhe se këto të dhëna do të përdoren vetëm për qëllime studimi.

Procedura e mbledhjes së të dhënave të pyetësorit, është planifikuar të zhvillohet në mënyrë fizike.

Shpërndarja e pyetësorëve të mësimdhënësve është bërë përmes grupeve të mësimdhënësve duke iu nënshtruar të gjitha kritereve etike dhe profesionale. Kohëzgjatja e nevojshme për plotësimin e pyetësorëve ka zgjatur rreth 15-20 minuta. Gjatë prodhimit të të dhënave, kam bërë të mundur që të sigurohen udhëzime të nevojshme dhe të hollësishme për plotësimin e pyetësorit, në mënyrë që të anketuarit ta kenë të lehtë për ta kuptuar dhe plotësuar pyetësorin. Të dhënat janë bartur në programin SPSS (Pakoja Statistikore për Shkencat Sociale) ku edhe janë analizuar duke përdorur analizën e të dhënave sasiore.

#### **4.4. Analiza e të dhënave**

Duke u munduar që të njohim qëndrimet e mësimitdhënësve dhe nxënësve lidhur me vlerësimin formativ, teknikat e VpN-ës dhe ndikimit të tyre në arritjen e rezultateve të të nxënësve, janë realizuar disa analiza dhe janë bërë disa interpretime të rezultateve në këtë hulumtim. Përpunimi i të dhënave sasiore apo kuantitative është realizuar përmes programit SPSS (Statistical Package for the Social Sciences), ndërsa analiza e të dhënave cilësore është bërë përmes analizës tematike. Rezultatet e fituara janë paraqitur si numra dhe përqindje, për të pasur një pasqyrë sa më të qartë dhe kuptimplotë të statistikave të paraqitura. Karakteristikat e tilla si përqindja (Percentage), mesatarja aritmetike (Mean), mediani, moda, dhe devijimi standard (Standard Deviation), janë pjesë dominuese e shumicës së pohimeve në fletëpyetësor.

Në kuadër të të dhënave sasiore janë realizuar edhe analizat inferenciale si: analiza deskriptive apo përshkruese, analiza e variablave të grupuara, analiza e korrelacionit (Speaman-Correlation dhe Pearson-Correlation), analiza ANOVA (One-Way), ndërmjet pyetjeve të ndryshme nga fletëpyetësorët.

## V. REZULTATET E HULUMTIMIT

Bazuar në rrjedhën e hulumtimit gjatë mbledhjes së të dhënave dhe analizës së tyre, mund të them që i gjithë ky proces është zhvilluar në mënyrë të rregullt. Fillimisht janë hartuar instrumentet përkatëse, me anë të të cilëve janë mbledhur të dhënat e fituara. Më pas është bërë shpërndarja e instrumentit të pyetësorit, për të vazhduar më tej me mbledhjen e të dhënave tjera shtesë si dhe realizimi i intervistimit bazuar në protokolin e përcaktuar. Hulumtimi është realizuar në komunën e Prishtinës. Gjysmëvjetori i dytë, më konkretisht muaji maj dhe qershor ishte koha gjatë së cilës është bërë mbledhja e të dhënave.

Hulumtimi në përgjithësi dhe të dhënat në veçanti janë realizuar duke iu përmbajtur të gjitha parimeve të përcaktuara profesionale. Gjatë realizimit të hulumtimit si sfida më madhore ishte përhapja e pandemisë COVID-19, mirëpo mund të them që nuk ka ndikuar në cilësinë e rezultateve të përgjithshme.

Në vazhdim do të prezantohen të dhënat demografike, në bazë të shpërndarjes së mostrës si dhe rezultatet e analizës sasiore dhe cilësore të hulumtimit, të realizuara në nivel të shkollave fillore të Prishtinës.

### 5.1. Të dhënat demografike

Në dy tabelat e mëposhtme janë paraqitur të dhënat demografike të dy mostrave, msotrës së nxënësve dhe mostrës së mësimitdhënëve. Në tabelën 7. janë paraqitur të dhënat demografike të mostrës sipas gjinisë dhe vitit të shkollimit të cilin e vijnë nxënësit në kohën e mbledhjes së të dhënave. Ndërsa, në tabelën 8. janë paraqitur të dhënat demografike të mësimitdhënëve sipas gjinisë, grupmoshës, nivelit të kualifikimit dhe ndjekjes së trajnimeve për vlerësim të nxënësve.

***Tabela 7. Shpërndarja e mostrës së nxënësve sipas të dhënave demografike***

Gjinia		Klasa				Gjithsej
		E dytë	E tretë	E katërt	E pestë	
Femërore	N	5	11	12	15	43
	%					47.8
Mashkullore	N	7	9	17	14	47
	%					52.2
Gjithsej	N	12	20	29	29	90
	%	13.3	22.2	32.2	32.2	100

Në mostrën e nxënësve të këtij hulumtimi janë përfshirë 90 nxënës të të dy gjinive, të cilët vijojnë mësimin fillor nga klasa e II-të deri në klasën e V-të. Në këtë mostër morën pjesë 43 vajza apo 47.8% të mostrës së përgjithshme dhe 47 djem apo 52.2 % të mostrës së përgjithshme. 12 nxënës (5 femra dhe 7 meshkuj) apo 13.3% vijonin mësimin në klasën e II-të, 20 nxënës (11 femra dhe 9 meshkuj) apo 22.2% vijonin mësimin në klasën e III-të, 29 nxënës (12 femra dhe 17 meshkuj) apo 32.2% vijonin mësimin në klasën e IV-të dhe 29 nxënës (15 femra dhe 14 meshkuj) apo 32.2% vijonin mësimin në klasën e V-të.

Ndërsa, në mostrën e mësimdhënësve janë përfshirë gjithsej 40 mësimdhënës të ciklit fillor të shkollave publike të komunës së Prishtinës, 8 prej tyre i përkisnin gjinisë mashkullore përkatësisht 20% dhe 32 të tjerë i përkisnin gjinisë femërore përkatësisht 80%. Sa i përket moshës së pjesëmarrësve në hulumtim, nga tabela vërejmë se 2 mësimdhënës apo 5% i përkasin grupmoshës 25-30 vjeç, e cila ishte edhe grupmosha me përqindjen më të vogël në krahasim me grupmoshat tjera, 9 mësimdhënës apo 22.5% e tyre grupmoshës 31-40 vjeç, 11 mësimdhënës apo 27.5% e tyre 41-50 vjeç dhe 18 mësimdhënës ose 45% grupmoshës mbi 50 vjeç. Pra, nga pjesëmarrësit në hulumtim shohim se numri më i madh i tyre i takon grupmoshës 41-50 dhe mbi 50 vjeç ndërsa, nën moshën 25 vjeç nuk është deklaruar asnjëri nga pjesëmarrësit. Përvoja e punës varioonte prej 0 deri mbi 15 vjet. Me 0-2 vite përvojë pune në mësimdhënie u deklarua vetëm 1 mësimdhënës apo 2.5%, njëkohësisht ishte përqindja më e vogël në krahasim me alternativat e tjera. Përvojë pune me 3-5 vite nuk u deklarua asnjë mësimdhënës dmth 0%. Me 6-10 vite përvojë pune ishin 6 mësimdhënës pjesëmarrës apo 15.0%, me 11-15 vite përvojë pune ishin 9 apo 22.5% mësimdhënës dhe me mbi 15 vite u deklaruan 24 mësimdhënës apo 60%. Nga të dhënat shihet se mësimdhënësit pjesëmarrës në hulumtim me një përqindje më të madhe ishin ata që kishin mbi 15 vite përvojë pune në mësimdhënie. Të anketuarit u përkisnin dy niveleve të kualifikimit. Me kualifikim të nivelit bachelor u deklaruan 30 mësimdhënës apo 75%, ku njëherit ishte edhe përqindja më e madhe në krahasim me kualifikimet e tjera. Me kualifikimin master u deklaruan 10 mësimdhënës ose 25%, ndërsa me nivelin e fundit të kualifikimit doktoratë nuk pati asnjë të deklaruar. Mësimdhënësit për ndjekjen e trajnimeve për vlerësimin e nxënësve u përgjigjën më shumë pozitivisht, 36 prej tyre apo 90%, kurse vetëm 4 mësimdhënës apo 10% deklaruan se nuk kishin ndjekur trajnime të tilla.



**Tabela 8. Shpërndarja e mostrës së mësimdhënësve sipas të dhënave demografike**

Gjinia		Mashkull	Femër	Gjithsej		
	N	8	32	40		
%	20	80	100			
Grupmosha		<b>25-30</b>	<b>31-40</b>	<b>41-50</b>	<b>mbi 50</b>	
	N	2	9	11	18	40
%	5	22.5	27.5	45	100	
Përvojë në mësimdhënie (vite)		<b>0-2</b>	<b>3-5</b>	<b>6-10</b>	<b>11-15</b>	<b>mbi 15</b>
	N	1	0	6	9	24
%	2.5	0	15	22.5	60	
Shkalla e fundit e kualifikimit		<b>Bachelor</b>	<b>Master</b>			
	N	30	10	40		
%	75	25	100			
Ndjekja e trajnimeve për vlerësimin e nxënësve		<b>Po</b>	<b>Jo</b>			
	N	36	4	40		
%	90	10	100			

## 5.2. Të dhënat sasiore

Të dhënat sasiore të hulumtimit janë mbledhur duke shfrytëzuar pyetësozin për mësimdhënës dhe pyetësozin për nxënës. Të dy pyetësozët janë të ndarë në dy pjesë, ku pjesa e parë kishte për qëllim marrjen e të dhënave demografike kurse pjesa e dytë në formë deklaratash kishte për qëllim për të marrë të dhënat lidhur me planifikimin, zbatimin dhe ndikimin e teknikave të vlerësimit formativ në arritjen e rezultateve të të nxënësve. Të dhënat e mbledhura në këtë hulumtim janë analizuar duke përdorur teknikat për analizë statistikore përshuese, teknikën e Spearman-it dhe teknikën e Pearsonit për korrelacionin dhe teknikën e ANOVA-s.

### 5.2.1. Analiza përshkruese

Analiza përshkruese e të dhënave të këtij hulumtimi është bërë ndaras për të dy mostrat, mostrën e nxënësve dhe mostrën e mësimdhënësve. Në këtë analizë është përfshirë frekuenca, përqindja, mesatarja aritmetike, moda dhe devijimi standard. Bazuar në të dhënat e fituara nga analiza përshkruese për kohën e vlerësimit, mënyrat apo teknikat dhe ndikimin e tyre në arritjen e rezultateve, mund të shohim se nxënësit në përgjithësi në shumicën prej përgjigjeve të dhëna

pohojnë se vlerësohen në vazhdimësi në forma të ndryshme dhe se kjo mënyrë e vlerësimit ka ndikim pozitiv tek ta. Kjo dëshmohet nga zgjedhja më e shpeshtë e alternativës “gjithmonë” dhe “shpesh” në pothuajse të gjitha pyetjet e pyetësorit.

Në pohimin e parë të pyetësorit të administruar te nxënësit *“Përveç vlerësimit në fund të periudhave, unë vlerësohem në vazhdimësi nga mësuesja/mësuesi edhe gjatë orës mësimore.”* shumica dërmuese e nxënësve (71.1% ose 64 nxënës) janë deklaruar që gjithmonë i nënshtrohen këtij vlerësimi. Ndërsa 23 nxënës ose 25.6% e nxënësve janë deklaruar që shpesh i nënshtrohen këtij vlerësimi. Mesatarja aritmetike e reagimit të nxënësve në këtë pohim është  $M=4.7$  dhe devijimi standard  $DS=0.6$ . Këto rezultate të nxjerra nga analiza tregojnë se një përqindje relativisht e madhe e nxënësve vlerësohen në vazhdimësi gjatë procesit mësimor. Në pohimin e dytë të pyetësorit *“Mësuesja ime/mësuesi im më vlerëson në mënyra të ndryshme.”* 75 nxënës apo 83.3% e tyre u deklaruan se gjithmonë vlerësohen në mënyra të ndryshme nga mësuesja, 11 nxënës apo 12.2% u deklaruan që shpesh vlerësohen në mënyra të ndryshme. Ndërsa, për alternativën nganjëherë u deklaruan 3 nxënës apo 3.3%, për alternativën rrallë nuk pati asnjë të deklaruar e për alternativën asnjëherë u deklarua vetëm një nxënës apo 1.1% e nxënësve të përfshirë në anketim. Mesatarja aritmetike e reagimit të nxënësve në këtë pohim është  $M=4.8$  dhe devijimi standard  $DS=0.6$ . Rezultatet e nxjerra në këtë pohim vërtetojnë se një përqindje shumë e madhe e mësimitdhënësve aplikojnë mënyra të ndryshme të vlerësimit për nxënësit e tyre. Në pohimin e tretë *“Mësuesja ime/ mësuesi im më korrigjon gabimet, më sqaron, më vlerëson e më lavdëron...me gojë, me shkrim e edhe me gestikulacione. (Informata kthyesë).”* 63 nxënës apo 70% u deklaruan për alternativën gjithmonë, 15 nxënës apo 16.7% u deklaruan për alternativën shpesh dhe 9 nxënës apo 10% për alternativën nganjëherë. Kurse, për alternativën rrallë u deklaruan 2 nxënës apo 2.2% dhe 1 nxënës apo 1.1% për alternativën asnjëherë. Mesatarja aritmetike e reagimit të nxënësve në këtë pohim është  $M=4.5$  dhe devijimi standard  $DS=0.9$ . Ndërsa në pohimin e katërt *“Informata kthyesë më bën të kuptoj nëse jam në rrugën e duhur gjatë dhënies së një përgjigjeje, kryerjes së një detyre...”* 56 nxënës apo 62.2% e nxënësve të anketuar u deklaruan për alternativën gjithmonë, 23 nxënës apo 25.5% u deklaruan për alternativën shpesh dhe 5 nxënës apo 5.6% e tyre u deklaruan për alternativën nganjëherë, për alternativën rrallë u deklaruan 4 nxënës apo 4.4% dhe për alternativën asnjëherë vetëm 2 nxënës apo 2.2% e nxënësve të përfshirë në anketim. Mesatarja aritmetike e reagimit të nxënësve në këtë pohim është  $M=4.4$  dhe devijimi standard  $DS=0.9$ . Në dy pohimet e lartëshënuara nga

rezultatet e marra vërejmë se mësimdhënësit e nxënësve të anketuar në përqindje mjaft të madhe përdorin informatën kthyesë si teknikë të vlerësimit dhe se kjo teknikë ka një ndikim mjaft pozitiv tek nxënësit. Në pohimin e pestë *“Mënyrat e ndryshme të vlerësimit ma lehtësojnë të nxënët.”* 67 nxënës apo 74.4% janë deklaruar për alternativën gjithmonë, 15 nxënës apo 16.7% për alternativën shpesh dhe 7 nxënës apo 7.8% u deklaruan për alternativën nganjëherë. Në këtë pohim nuk pati asnjë të deklaruar për alternativën rrallë, mirëpo pati vetëm 1 nxënës apo 1.1% që u deklarua për alternativën asnjëherë. Mesatarja aritmetike e reagimit të nxënësve në këtë pohim është  $M=4.6$  dhe devijimi standard  $DS=0.7$ . Rezultatet e fituara për këtë pohim na bëjnë të kuptojmë apo na vërtetojnë se mënyrat e ndryshme të vlerësimit janë domosdoshmëri dhe lehtësim për arritjen e rezultateve të të nxënët. Për pohimin e gjashtë *“Qartësoj idetë e mia për qëllimet e të nxënët dhe kriteret e suksesit kur vlerësojmë shoku – shokun. (Vlerësimi i ndërsjellë)”* 34 nxënës apo 37.8% e nxënësve të anketuar u deklaruan për alternativën gjithmonë, 21 nxënës apo 23.3% u deklaruan për alternativën shpesh dhe 30 nxënës apo 33.3% e tyre u deklaruan për alternativën nganjëherë, për alternativën rrallë u deklaruan 3 nxënës apo 3.3% dhe për alternativën asnjëherë u deklaruan 2 nxënës apo 2.2% e nxënësve të përfshirë në anketim. Mesatarja aritmetike e reagimit të nxënësve në këtë pohim është  $M=3.9$  dhe devijimi standard  $DS=1.0$ . Nga këto rezultate të fituar mund të vërtetojmë se bashkëpunimi i nxënësve në procesin e vlerësimit është pjesë shumë e rëndësishme në arritjen e rezultateve të të nxënët, ku nxënësit bashkëdyzojnë idetë e tyre duke vlerësuar njëri-tjetrin. Për pohimin e shtatë të pyetësorit të nxënësve *“Vlerësimi i ndërsjellë më ndihmon të përmirësohem sepse më jep mundësi të shoh detyra, përgjigje apo ese të punuara në mënyra të ndryshme.”* kemi fituar këto rezultate: 54 prej tyre apo 60% e të anketuarve u deklaruan për alternativën gjithmonë, 20 nxënës apo 22.2% për alternativën shpesh dhe 10 nxënës apo 11.1% për alternativën nganjëherë, ndërsa për alternativën rrallë u deklaruan 5 nxënës apo 5.6% e tyre dhe vetëm 1 nxënës apo 1.1% u deklarua për alternativën asnjëherë. Mesatarja aritmetike e reagimit të nxënësve në këtë pohim është  $M=4.3$  dhe devijimi standard  $DS=1.0$ . Rezultatet e fituara bëjnë që të kuptojmë se element i rëndësishëm i vlerësimit të ndërsjellë është zgjidhja e problemeve e bashkë me të edhe krijimi i ideve të reja nga njëri-tjetri. Vlerësimi i ndërsjellë do të siguronte që nxënësit t’i zgjidhin edhe problemet e jetës reale përmes bashkëveprimit shoqëror dhe krahasimit mes ideve të njëri-tjetrit. Ky proces është i mundur falë inkurajimit që mësimdhënësit u bëjnë nxënësve. Në pohimin e tetë *“Kur vlerësoj vetëveten fitoj ide se si t’i ndihmoj vetes për t’u përmirësuar. (Vetëvlerësimi)”* 46 nxënës

apo 51.1% e nxënësve të anketuar u deklaruan për alternativën gjithmonë, 26 nxënës apo 28.9% u deklaruan për alternativën shpesh, 9 nxënës apo 10% u deklaruan për alternativën nganjëherë, 8 nxënës apo 8.9% u deklaruan për alternativën rrallë dhe vetëm 1 nxënës apo 1.1% u deklarua për alternativën asnjëherë. Mesatarja aritmetike e reagimit të nxënësve në këtë pohim është  $M=4.2$  dhe devijimi standard  $DS=1.0$ . Ndërsa për pohimin e nëntë *“Vetëvlerësimi më ndihmon të korigjoj njohuritë e mia momentale, lëshimet dhe gabimet gjatë të nxënësve.”* 48 nxënës apo 53.35 e të anketuarve u deklaruan për alternativën gjithmonë, 23 nxënës apo 25.6% u deklaruan për alternativën shpesh, 14 nxënës apo 15.6% u deklaruan për alternativën nganjëherë, 3 nxënës apo 3.3% për alternativën rrallë dhe 2 nxënës apo 2.2% u deklaruan për alternativën asnjëherë. Mesatarja aritmetike e reagimit të nxënësve në këtë pohim është  $M=4.2$  dhe devijimi standard  $DS=1.0$ . Nga rezultatet e fituara të këtyre dy pohimeve vërejmë se ka vend për përmirësim, që do të thotë se mësimdhënësit duhet të nxisin më tepër besimin e nxënësve për vetëvlerësim duke ua theksuar më shpesh gjërat pozitive e duke ua shmangur kritikën. Vetëvlerësimi është një komponent i rëndësishëm të çdo fëmijë. Jo vetëm që do ta ndihmojë nxënësin me performancën akademike por do të jetë edhe mbështetje në aftësitë sociale. Vetëvlerësimi duhet gjatë gjithë jetës dhe mësuesit duhet ta kuptojnë rolin e rëndësishëm që luajnë në theksimin ose dëmtimin e vetëvlerësimit të nxënësve. Në pohimin e dhjetë *“Mësoj më shumë kur mësuesja/mësuesi bënë pyetje më shpesh gjatë orës mësimore. (Parashtrimi i pyetjeve)”* 72 nxënës apo 72% e nxënësve të anketuar u deklaruan për alternativën gjithmonë, 14 nxënës apo 15.6% u deklaruan për alternativën shpesh dhe 4 nxënës apo 4.4% u deklaruan për alternativën nganjëherë, ndërsa për alternativën rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë nxënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të nxënësve në këtë pohim është  $M=4.8$  dhe devijimi standard  $DS=0.5$ . Kurse, në pohimin njëmbëdhjetë *“Parashtrimi i pyetjeve nga mësuesja/mësuesi më nxisin të mendoj më thellë, të imagjinoj dhe të jem kreativ/e.”* 69 nxënës apo 76.7% e nxënësve të anketuar u deklaruan për alternativën gjithmonë, 17 nxënës apo 18.9% u deklaruan për alternativën shpesh, 2 nxënës apo 2.2% u deklaruan për alternativën nganjëherë dhe po aq edhe për alternativën asnjëherë, ndërsa për alternativën rrallë nuk pati asnjë të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të nxënësve në këtë pohim është  $M=4.7$  dhe devijimi standard  $DS=0.7$ . Rezultatet e fituara në këto dy pohime tregojnë se teknika “Parashtrimi i pyetjeve” ka ndikim shumë pozitiv në arritjen e rezultateve të të nxënësve. Mendoj se kjo ndodh për arsye se pyetjet tërheqin vëmendjen dhe nxisin interes, nxisin procesin e të menduarit të nivelit të lartë, strukturojnë dhe

orientojnë diskutimin, por edhe mundësojnë shprehjen e emocioneve. Në pohimin e dymbëdhjetë dhe të fundit në pyetësonin e nxënësve “Mënyrat e ndryshme të vlerësimit më nxisin dëshirën dhe përkushtimin si dhe më orientojnë për arritjen e rezultateve të të nxënësve.” 59 nxënës apo 65.6% e nxënësve të anketuar u deklaruan për alternativën gjithmonë, 23 nxënës apo 25.6% e nxënësve u deklaruan për alternativën shpesh, 6 nxënës apo 6.7% e nxënësve u deklaruan për alternativën nganjëherë, ndërsa për alternativën rrallë dhe asnjëherë u deklaruan vetëm nga 1 nxënës apo nga 1.1% e nxënësve të anketuar. Mesatarja aritmetike e reagimit të nxënësve në këtë pohim është  $M=4.5$  dhe devijimi standard  $DS=0.8$ . Nga këto rezultate vërtetohet se mënyrat e ndryshme të vlerësimit kanë ndikim mjaftë të madh dhe se nxënësit e kuptojnë vlerën e llojllojshmërisë së vlerësimit. Llojllojshmëria e vlerësimit mundëson mbikëqyrjen, ecurinë, procesin, përparimin e nxënësve, dhe siguron një informatë kthyesë për të sjellë përmirësime. Komponentët e vlerësimit formativ janë përfshirja e nxënësve në të nxënë, vetëvlerësimi, vlerësimi i ndërsjellë, informata kthyesë dhe ndikimi i vlerësimit formativ në vetpërmirësim e në reflektim. Ndarja e qëllimeve të mësimin, pyetjet efektive, vlerësimi i njëri-tjetrit dhe reagimet efektive janë katër elemente bazë të vlerësimeve formuese.

**Tabela 9.** Analiza përshkruese (frekuenca, përqindja, mesatarja aritmetike, moda dhe devijimi standard) e të dhënave për vlerësimin e nxënësve të mbledhura nga nxënësit

Nr.	Pohimet	Asnjëherë	Rrallë	Nganjëherë	Shpesh	Gjithmonë	Mesatarja aritmetike	Moda	Devijimi standard	
1.	Përveç vlerësimit në fund të periudhave, unë vlerësohem në vazhdimësi nga mësuesja/mësuesi edhe gjatë orës mësimore.	N	0	1	2	23	64	4.7	5.0	0.6
		%	0	1.1	2.2	25.6	71.1			
2.	Mësuesja ime/mësuesi im më vlerëson në mënyra të ndryshme.	N	1	0	3	11	75	4.8	5.0	0.6
		%	1.1	0	3.3	12.2	83.3			

3.	Mësuesja ime/ mësuesi im më korrigjon gabimet, më sqaron, më vlerëson e më lavdëron...me gojë, me shkrim e edhe me gjestikulacione. (Informata kthyese)	N	1	2	9	15	63	4.5	5.0	0.9
		%	1.1	2.2	10	16.7	70			
4.	Informata kthyese më bën të kuptoj nëse jam në rrugën e duhur gjatë dhënies së një përgjigjeje, kryerjes së një detyre...	N	2	4	5	23	56	4.4	5.0	0.9
		%	2.2	4.4	5.6	25.6	62.2			
5.	Mënyrat e ndryshme të vlerësimit ma lehtësojnë të nxënit.	N	1	0	7	15	67	4.6	5.0	0.7
		%	1.1	0	7.8	16.7	74.4			
6.	Qartësoj idetë e mia për qëllimet e të nxënit dhe kriteret e suksesit kur vlerësojmë shoku – shokun. (Vlerësimi i ndërsjellë)	N	2	3	30	21	34	3.9	5.0	1.0
		%	2.2	3.3	33.3	23.3	37.8			
7.	Vlerësimi i ndërsjellë më ndihmon të përmirësohem sepse më jep mundësi të shoh detyra, përgjigje apo ese të punuara në mënyra të ndryshme.	N	1	5	10	20	54	4.3	5.0	1.0
		%	1.1	5.6	11.1	22.2	60			
8.	Kur vlerësoj vetëveten fitoj ide se si t'i ndihmoj vetes për t'u përmirësuar. (Vetëvlerësimi)	N	1	8	9	26	46	4.2	5.0	1.0
		%	1.1	8.9	10	28.9	51.1			
9.	Vetëvlerësimi më ndihmon të korigjoj njohuritë e mia momentale, lëshimet dhe gabimet gjatë të nxënit.	N	2	3	14	23	48	4.2	5.0	1.0
		%	2.2	3.3	15.6	25.6	53.3			
10.	Mësoj më shumë kur mësuesja/mësuesi bënë pyetje më shpesh gjatë orës mësimore. (Parashtrimi i pyetjeve)	N	0	0	4	14	72	4.8	5.0	0.5
		%	0	0	4.4	15.6	80			
11.	Parashtrimi i pyetjeve nga mësuesja/mësuesi më nxisin të mendoj më thellë, të imagjinoj dhe të jem kreativ/e.	N	2	0	2	17	69	4.7	5.0	0.7
		%	2.2	0	2.2	18.9	76.7			
12.	Mënyrat e ndryshme të vlerësimit më nxisin dëshirën dhe përkushtimin si dhe më orientojnë për arritjen e rezultateve të të nxënit.	N	1	1	6	23	59	4.5	5.0	0.8
		%	1.1	1.1	6.7	25.6	65.6			

Në vazhdim do të bëjmë analizën përshkruese të mostrës së mësimdhënësve. Bazuar në të dhënat e fituara nga analiza përshkruese për planifikimin e vlerësimit, për përdorimin e teknikave, ndikimin e tyre në mësimdhënie dhe mësimnxënie si dhe për shfrytëzimin e rezultateve të vlerësimit, mund të shohim se mësimdhënësit në përgjithësi në shumicën prej përgjigjeve të dhëna pohojnë se planifikojnë vlerësimin, përdorin teknika të ndryshme të vlerësimit e përdorimi i tyre ka ndikim pozitiv tek nxënësit, por edhe se rezultatet e fituara gjatë vlerësimit i shfrytëzojnë për të përmirësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien. Kjo dëshmohet nga zgjedhja më e shpeshtë e alternativës “gjithmonë” dhe “shpesh” në pothuajse të gjitha përgjigjet.

Në pohimin e parë të pyetësorit të administruar te mësimdhënësit *“Gjatë planifikimit të orës mësimore përfshij edhe vlerësimin si pjesë përbërëse të saj.”* 21 mësimdhënës të anketuar apo 52.5% u deklaruan për alternativën gjithmonë dhe 19 mësimdhënës apo 47% e tyre u deklaruan për alternativën shpesh, ndërsa për alternativat nganjëherë, rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është  $M=4.5$  dhe devijimi standard  $DS=0.5$ . Të dhënat e fituara të këtij pohimi vërtetojnë se pjesa dërmuese e mësimdhënësve përfshijnë vlerësimin si pjesë përbërëse të planifikimit mësimor.

Planifikimi i vlerësimit mundëson zbërthimin e çështjes që vlerësohet, caktimin e detyrave të vlerësuesve, përzgjedhjen e instrumenteve matës dhe për vrojtim, përcaktimin e kritereve që do të përdoren për vlerësim, përcaktimin e kampionit, përzgjedhjen e procedurave të analizës së të dhënave dhe caktimin e një orari veprimesh. Në pohimin e dytë *“Zbatoj standardet e vlerësimit dhe kodin etik për të përcaktuar parimet themelore për vlerësimin e nxënësve dhe të sjelljes etike të tyre.”* 24 mësimdhënës apo 60% e mësimdhënësve u deklaruan për alternativën gjithmonë dhe 16 mësimdhënës apo 40% u deklaruan për alternativën shpesh, e për alternativat nganjëherë, rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është  $M=4.6$  dhe devijimi standard  $DS=0.5$ . Këto të dhëna të këtij pohimi tregojnë se në shkollat tona mësimdhënësit vlerësojnë për t’u shërbyer nevojave praktike (standardi i dobisë), bëjnë vlerësim real dhe të matur (standardi i mundësisë), vlerësimi i tyre është i karakterit të ligjshëm dhe teknik (standardi i korrektesisë) dhe shfaqin e pasurojnë informacion teknikisht të mjaftueshëm (standardi i saktësisë). E sa i përket pohimit të tretë *“Përfshij teknika të ndryshme të vlerësimit formativ në procesin mësimor për arritjen e rezultateve të të nxënësve.”* morëm këto rezultate, 19 mësimdhënës të anketuar apo

47.5% u deklaruan për alternativën gjithmonë, 20 mësimdhënës apo 50% u deklaruan për alternativën shpesh dhe vetëm 1 mësimdhënës apo 2.5% u deklarua për alternativën nganjëherë, kurse për alternativat rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është  $M=4.5$  dhe devijimi standard  $DS=0.6$ . Nga këto rezultate mund të themi me bindje të thellë se mësimdhënësit duhet të zgjedhin teknika të përshtatshme të vlerësimit në përputhje me karakteristikat që duhet të maten. Teknikat duhet të jenë objektive, të sakta dhe të përshtatshme. Në pohimin e katërt *“Krahasoj arritjet e nxënësve të mi për të parë ndikimin e strategjive dhe teknikave të vlerësimit.”* 15 mësimdhënës të anketuar apo 47.5% u deklaruan për alternativën gjithmonë, 21 mësimdhënës apo 52.5% u deklaruan për alternativën shpesh dhe 4 mësimdhënës apo 10% e të anketuarve u deklaruan për alternativën nganjëherë e për alternativat rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është  $M=4.3$  dhe devijimi standard  $DS=0.6$ . Nga këto të dhëna përfundojmë se mësimdhënësit vlerësojnë procesin e vlerësimit, me qëllim që të kuptojnë se si nxënësit mësojnë, çfarë ata dinë dhe janë në gjendje të bëjnë, e jo vetëm për të matur sasinë dhe cilësinë e arritjeve të nxënësve. Për ta plotësuar këtë proces ata analizojnë dhe krahasojnë rezultatet e vlerësimit të një njësie mësimore, të një teme, të një lënde apo të një fushe përgjatë një ore, një periudhe, viti apo shkalle për të arriturat që kanë treguar nxënësit. Natyrisht një analizë e tillë do të shërbejë për të parë nëse jemi duke përdorur strategjitë dhe teknikat e duhura të vlerësimit. Në pohimin e pestë *“Shfrytëzoj rezultatet e vlerësimit për të përmirësuar mësimdhënien dhe nxënien e nxënësve.”* 25 mësimdhënës të anketuar apo 62.5% u deklaruan për alternativën gjithmonë, 12 mësimdhënës apo 30% e të anketuarve u deklaruan për alternativën shpesh dhe 3 mësimdhënës apo 7.5% u deklaruan për alternativën nganjëherë, kurse për alternativat rrallë dhe asnjëherë as në këtë pohim nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është  $M=4.6$  dhe devijimi standard  $DS=0.6$ . Këto rezultate tregojnë se mësimdhënësit e shkollave tona synojmë të identifikojmë gabimet, të metat dhe veshtërsitë në punën me nxënës, me qëllim që t’u ofrojnë ndihmë. Në këtë mënyrë ata mbikëqyrin ecurinë, procesin, përparimin e nxënësve, si dhe sigurojnë informatë kthyesë për të sjellë përmirësime. Kontrollonjë përparimin e nxënies së nxënësve gjatë procesit mësimor dhe shkallën e zotërimit të kompetencave. Në pohimin e gjashtë *“Teknikat e VpN-ës e lehtësojnë mësimdhënien dhe nxënien.”* 17 mësimdhënës të anketuar apo 42.5% u deklaruan për



alternativën gjithmonë, gjithashtu edhe për alternativën shpesh u deklaruan 17 mësimdhënës apo 42.5%, ndërsa 4 mësimdhënës apo 10% u deklaruan për alternativën nganjëherë dhe 2 mësimdhënës apo 5% e të anketuarve u deklaruan për alternativën rrallë, kurse për alternativën asnjëherë nuk pati asnjë të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është  $M=4.2$ . dhe devijimi standard  $DS=0.8$ . Përqindjet e dhëna nga rezultatet janë më të vogla në krahasim me pritshmëritë që kemi pasur lidhur me këtë pohim sepse teknikat e VpN-ës mundësojnë të vlerësojmë përparimin e nxënësve gjatë një periudhe kohore, ndihmojnë në përcaktimin e efikasitetit të mësimdhënies, ndihmojnë në krijimin e marrëdhënieve më të mira mes mësimdhënësit dhe nxënësit, u ndihmojnë nxënësve për vetëvlerësim, na ndihmon t'i identifikojmë pikat e forta dhe të dobëta të nxënësve gjatë procesit të të nxënësve të shumë ndikime të tjera. Në pohimin e shtatë *“Jap të gjithë nxënësve informata kthyesë për të nxënësve të tyre gjatë orës mësimore.”* 15 mësimdhënës apo 37.5% e të anketuarve u deklaruan për alternativën gjithmonë, 21 mësimdhënës apo 52.5% u deklaruan për alternativën shpesh, 3 mësimdhënës apo 7.5% u deklaruan për alternativën nganjëherë, vetëm 1 mësimdhënës apo 2.5% u deklarua për alternativën rrallë, ndërsa për alternativën asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është  $M=4.3$  dhe devijimi standard  $DS=0.7$ . Në pohimin e tetë, i cili poashtu ka të bëjë me informatën kthyesë *“Identifikoj vështirësitë me të cilat ballafaqohen nxënësit gjatë procesit të nxënies përmes informatës kthyesë.”* 16 mësimdhënës të anketuar apo 40% u deklaruan për alternativën gjithmonë, 18 mësimdhënës apo 45% e të anketuarve u deklaruan për alternativën shpesh, 6 mësimdhënës apo 15% u deklaruan për alternativën nganjëherë, ndërsa për alternativat rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është  $M=4.3$  dhe devijimi standard  $DS=0.7$ . Në bazë të kësaj ne mund të përfundojmë se mësimdhënësit në një nivel të lartë vlerësojnë procesin e të nxënësve, me qëllim që të kuptojnë se si nxënësit mësojnë, çfarë ata dinë dhe janë në gjendje të bëjnë, e jo vetëm për të matur sasinë dhe cilësinë e arritjeve të nxënësve Për ta plotësuar këtë proces ata u komentojnë dhe i njoftojnë nxënësit për të arriturat që kanë treguar gjatë orës mësimore. Natyrisht një vlerësim i tillë do të shërbejë si nxitje për të nxënësve të vazhdueshëm. Në pohimin e nëntë *“Nxënësit qartësojnë idetë e tyre për qëllimet e të nxënësve dhe kriteret e suksesit përmes vlerësimit të ndërsjellë.”* 13 mësimdhënës të anketuar apo 32.5% u deklaruan për alternativën gjithmonë, 19 mësimdhënës apo 47.5% u deklaruan për alternativën shpesh dhe 8 mësimdhënës apo 20% u deklaruan për

alternativën nganjëherë, kurse për alternativat rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është  $M=4.1$  dhe devijimi standard  $DS=0.7$ . Në pohimin e dhjetë *“Vlerësimi i ndërsjellë ndihmon nxënësit më të dobët sepse i jep mundësi të shohin punë (përgjigje, ese, detyrë, ...) më të avancuar.”* 18 mësimdhënës të anketuar apo 45% u deklaruan për alternativën gjithmonë, 17 mësimdhënës apo 42.5% u deklaruan për alternativën shpesh, 4 mësimdhënës apo 10% u deklaruan për alternativën nganjëherë dhe vetëm 1 mësimdhënës apo 2.5 % u deklarua për alternativën rrallë, kurse për alternativën asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është  $M=4.3$  dhe devijimi standard  $DS=0.8$ . Rezultatet e këtyre dy pohimeve tregojnë se mësimdhënësit mendojnë se teknika e vlerësimit të ndërsjellë është mjaft efektive. Ky vlerësim duhet të zbatohet me kujdes dhe të arriturat e nxënësve duhet të krahasohen me të arriturat e tyre të mëparshme e jo me të arriturat e të tjerëve. Në pohimin e njëmbëdhjetë *“Nxënësit fitojnë ide më të qarta se si t’i ndihmojnë vetes për t’u përmirësuar përmes vetëvlerësimit.”* 12 mësimdhënës të anketuar apo 30% u deklaruan për alternativën gjithmonë, 24 mësimdhënës apo 60% u deklaruan për alternativën shpesh dhe 4 mësimdhënës apo 10% u deklaruan për alternativën nganjëherë, ndërsa për alternativat rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është  $M=4.2$  dhe devijimi standard  $DS=0.6$ . Në pohimin e dymbëdhjetë *“Vetëvlerësimi ndihmon nxënësit të korigjojnë njohuritë e tyre momentale, lëshimet dhe gabimet gjatë të nxënies.”* 18 mësimdhënës të anketuar apo 45% u deklaruan për alternativën gjithmonë, 18 mësimdhënës apo 45% u deklaruan për alternativën shpesh dhe 4 mësimdhënës apo 10% u deklaruan për alternativën nganjëherë, ndërsa për alternativat rrallë dhe asnjëherë as në këtë pohim nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është  $M=4.4$  dhe devijimi standard  $DS=0.7$ . Bazuar në rezultatet e fituara vërejmë se vetëvlerësimi ndikon shumë tek nxënësit sepse si proces që është, mundëson që nxënësit të mbledhin informacione për veten e tyre dhe bëjnë gjykimin për vlerat e veta. Këtë vlerësim nxënësi e realizon duke krahasuar rezultatet e veta me rezultatet e nxënësve të tjerë. Nëpërmjet vetëvlerësimit nxënësit kanë mundësi që në lidhje me qëllimet e caktuara të mësimin të vlerësojnë veten, arritshmërinë e tyre. Vetëvlerësimi i bazuar në kritere të drejta, krijon bazë për të motivuar, përmirësuar dhe çmuar më tej arritjet në të nxënies e nxënësve. Në pohimin e trembëdhjetë *“Nxënësit mësojnë më shumë kur parashtroj pyetje më shpesh gjatë përcjelljes së*

*përparimit dhe kontrollimit të të kuptuarit.*” 24 mësimdhënës të anketuar apo 60% u deklaruan për alternativën gjithmonë dhe 16 mësimdhënës apo 40% u deklaruan për alternativën shpesh, kurse për alternativat nganjëherë, rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është  $M=4.6$  dhe devijimi standard  $DS=0.5$ . Në pohimin e katërbëdhjetë *“Parashtrimi i pyetjeve nxit tek nxënësit të menduarit e nivelit të lartë.”* 29 mësimdhënës të anketuar apo 72.5% u deklaruan për alternativën gjithmonë dhe 11 mësimdhënës apo 27.5% u deklaruan për alternativën shpesh, kurse për edhe në këtë pohim nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar për alternativat nganjëherë, rrallë dhe asnjëherë. Mesatarja aritmetike e reagimit të mësimdhënësve në këtë pohim është  $M=4.6$  dhe devijimi standard  $DS=0.6$ . Rezultatet e fituara nga këto dy pohime tregojnë rëndësinë e parashtrimit të pyetjeve e sidomos rolin shumë të rëndësishëm të mësimdhënësit sepse *“Të dish të bësh pyetje si duhet, do të thotë të dish të japësh mësim. Më shumë se çdo gjë tjetër, arti i bukur i mësimdhënies varet nga mjeshhtëria e përdorimit të pyetjeve...”*. Pyetjet bëjnë pjesë në metodat e planifikimit të orës mësimore, pa të cilat procesi mësimor do të ishte shumë monoton dhe jo zbatimës për nxënësit. Përtej qëllimit kryesor që kanë, pyetjet mund të shërbejnë si një mënyrë për të rritur vetbesimin dhe aftësinë e nxënësve për të krijuar ata vetë pyetje mësuesit, duke mundësuar kështu një përfshirje aktive gjatë orës mësimore. Në pohimin e pesëmbëdhjetë *“Teknikat e VpN-ës nxisin dëshirën dhe përkushtimin e nxënësve si dhe orientojnë ata për arritjen e rezultateve të të nxënësve.”* 23 mësimdhënës të anketuar apo 57.5% u deklaruan për alternativën gjithmonë dhe 16 mësimdhënës apo 40% u deklaruan për alternativën shpesh, vetëm 1 mësimdhënës apo 2.5% u deklarua për alternativën nganjëherë, ndërsa për alternativat rrallë dhe asnjëherë nuk pati asnjë mësimdhënës të deklaruar. Rezultatet e këtij pohimi të fundit në këtë pyetësor tregojnë se mësimdhënësit gjatë shtjellimit të njësisë mësimore, përdorin format, metodat dhe mjetet e punës mësimore, duke nxitur maksimalisht aktivitetin e nxënësve dhe përvetësimin e diturive të reja përmes teknikave të VpN-ës. Prandaj me të drejtë mund të konstatohet se faza e organizimit të punës mësimore ka karakter të *“fitimit”* të pavarur të diturive të reja mbi baza të shumëllojshmërisë së metodave, teknikave të reja të mësimin dhe formave të punës mësimore.

**Tabela 10. Analiza përshkruese (frekuenca, përqindja, mesatarja aritmetike, moda dhe devijimi standard) e të dhënave për vlerësimin e nxënësve të mbledhura nga mësimitdhënësit**

Nr.	Pohimet	Asnjëherë	Rrallë	Nganjëherë	Shpesh	Gjithmonë	Mesatarja aritmetike	Moda	Devijimi standard
1.	Gjatë planifikimit të orës mësimore përfshij edhe vlerësimin si pjesë përbërëse të saj.	N			19	21	4.5	5.0	0.5
		%			47.5	52.5			
2.	Zbatoj standardet e vlerësimit dhe kodin etik për të përcaktuar parimet themelore për vlerësimin e nxënësve dhe të sjelljes etike të tyre.	N			16	24	4.6	5.0	0.5
		%			40.0	60.0			
3.	Përfshij teknika të ndryshme të vlerësimit formativ në procesin mësimor për arritjen e rezultateve të të nxënësve.	N		1	20	19	4.5	4.0	0.6
		%		2.5	50.0	47.5			
4.	Krahasoj arritjet e nxënësve të mi për të parë ndikimin e strategjive dhe teknikave të vlerësimit.	N		4	21	15	4.3	4.0	0.6
		%		10.0	52.5	37.5			
5.	Shfrytëzoj rezultatet e vlerësimit për të përmirësuar mësimitdhënien dhe nxënien e nxënësve.	N		3	12	25	4.6	5.0	0.6
		%		7.5	30.0	62.5			
6.	Teknikat e VpN-ës e lehtësojnë mësimitdhënien dhe nxënien.	N	2	4	17	17	4.2	4.00 <sup>a</sup>	0.8
		%	5.0	10.0	42.5	42.5			
7.	Jap të gjithë nxënësve informata kthyesë për të nxënësve të tyre gjatë orës mësimore.	N	1	3	21	15	4.3	4.0	0.7
		%	2.5	7.5	52.5	37.5			
8.	Identifikoj vështirësitë me të cilat ballafaqohen nxënësit gjatë procesit të nxënies përmes informatës kthyesë.	N		6	18	16	4.3	4.0	0.7
		%		15.0	45.0	40.0			
9.	Nxënësit qartësojnë idetë e tyre për qëllimet e të nxënësve dhe kriteret e suksesit përmes vlerësimit të ndërsjellë.	N		8	19	13	4.1	4.0	0.7
		%		20.0	47.5	32.5			

10.	Vlerësimi i ndërsjellë ndihmon nxënësit më të dobët sepse i jep mundësi të shohin punë (përgjigje, ese, detyrë, ...) më të avancuar.	N	1	4	17	18	4.3	5.0	0.8
		%	2.5	10.0	42.5	45.0			
11.	Nxënësit fitojnë ide më të qarta se si t'i ndihmojnë vetes për t'u përmirësuar përmes vetëvlerësimit.	N		4	24	12	4.2	4.0	0.6
		%		10.0	60.0	30.0			
12.	Vetëvlerësimi ndihmon nxënësit të korigjojnë njohuritë e tyre momentale, lëshimet dhe gabimet gjatë të nxënësve.	N		4	18	18	4.4	4.00 <sup>a</sup>	0.7
		%		10.0	45.0	45.0			
13.	Nxënësit mësojnë më shumë kur parashtrij pyetje më shpesh gjatë përcjelljes së përparimit dhe kontorllimit të të kuptuarit.	N			16	24	4.6	5.0	0.5
		%			40.0	60.0			
14.	Parashtrimi i pyetjeve nxit tek nxënësit të menduarit e nivelit të lartë.	N			11	29	4.6	5.0	0.6
		%			27.5	72.5			
15.	Teknikat e VpN-ës nxisin dëshirën dhe përkushtimin e nxënësve si dhe orientojnë ata për arritjen e rezultateve të të nxënësve.	N		1	16	23			
		%		2.5	40.0	57.5			

a. Ekzistojnë moda të shumëfishta. Vlera më e ulët është e shfaqur në këtë tabelë.

### 5.2.2. Variablat e grupuara

Pohimet e pyetësorit të administruar në mesin e nxënësve (shih tab. 11) dhe mësimdhënësve (shih tab.12) janë grupuar në variabla. Te pyetësori i administruar te nxënësit, pohimet “Përveç vlerësimit në fund të periudhave, unë vlerësohem në vazhdimësi nga mësuesja/mësuesi edhe gjatë orës mësimore.” dhe “Mësuesja ime/mësuesi im më vlerëson në mënyra të ndryshme.” janë grupuar në variablën “**Sa përdoren teknikat e vlerësimit formativ**” me mesatare  $M=9.4$  dhe devijim standard  $DS=1$ ; pohimet “Mësuesja ime/ mësuesi im më korrigjon gabimet, më sqaron, më vlerëson e më lavdëron...me gojë, me shkrim e edhe me gjestikulacione. (Informata kthyese)” dhe “Informata kthyese më bën të kuptoj nëse jam në rrugën e duhur gjatë dhënies së një përgjigjeje, kryerjes së një detyre...” janë grupuar në variablën “**Informata kthyese**” me mesatare  $M=8.9$  dhe  $DS =1.4$ ; pohimet “Qartësoj idetë e mia për qëllimet e të nxënësve dhe kriteret e suksesit kur vlerësojmë shokun – shokun. (Vlerësimi i ndërsjellë)” dhe “Vlerësimi i ndërsjellë

më ndihmon të përmirësohem sepse më jep mundësi të shoh detyra, përgjigje apo ese të punuara në mënyra të ndryshme.” janë grupuar në variablën “**vlerësimi i ndërsjellë**” me mesatare  $M=8.3$  dhe  $DS = 1.5$ ; pohimet “Kur vlerësoj vetëveten fitoj ide se si t’i ndihmoj vetes për t’u përmirësuar. (Vetëvlerësimi)” dhe “Vetëvlerësimi më ndihmon të korigjoj njohuritë e mia momentale, lëshimet dhe gabimet gjatë të nxënës.” janë grupuar në variablën “**vetëvlerësimi**” me mesatare  $M=8.4$  dhe  $DS = 1.7$ ; pohimet “Mësoj më shumë kur mësuesja/mësuesi bënë pyetje më shpesh gjatë orës mësimore. (Parashtrimi i pyetjeve)” dhe “Parashtrimi i pyetjeve nga mësuesja/mësuesi më nxisin të mendoj më thellë, të imagjinoj dhe të jem kreativ/e.” janë grupuar në variablën “**parashtrimi i pyetjeve**” me mesatare  $M=9.4$  dhe  $DS = 0.9$ ; dhe pohimet “Mënyrat e ndryshme të vlerësimit ma lehtësojnë të nxënës.” dhe “Mënyrat e ndryshme të vlerësimit më nxisin dëshirën dhe përkushtimin si dhe më orientojnë për arritjen e rezultateve të të nxënës.” janë grupuar në variablën “**Përparësitë e përdorimit të teknikave të vlerësimit**” me mesatare  $M=9.2$  dhe devijim standard  $DS=1.3$ .

**Tabela 11.** Analiza përshkruese (mesatarja aritmetike, mediani, moda dhe devijimi standard) e grup variablave për vlerësimin e nxënësve të mbledhura nga nxënës.

Variablat	Mesatarja aritmetike	Mediani	Moda	Devijimi standard
Sa përdoren teknikat e vlerësimit formativ	9.4	10.0	10.0	1.0
Informata kthyesë	8.9	9.0	10.0	1.4
Vlerësimi i ndërsjellë	8.3	8.0	8.0	1.5
Vetëvlerësimi	8.4	9.0	10.0	1.7
Parashtrimi i pyetjeve	9.4	10.0	10.0	0.9
Përparësitë e përdorimit të teknikave të vlerësimit	9.2	10.0	10.0	1.3

Te pyetësi i administruar te mësimdhënësit, pohimet “Gjatë planifikimit të orës mësimore përfshij edhe vlerësimin si pjesë përbërëse të saj.” dhe “Zbatoj standardet e vlerësimit dhe kodin etik për të përcaktuar parimet themelore për vlerësimin e nxënësve dhe të sjelljes etike të tyre.”

janë grupuar në variablën **“Planifikimi i vlerësimit”** me mesatare  $M=9.1$  dhe devijim standard  $DS=0.9$ ; pohimet *“Jap të gjithë nxënësve informata kthyesë për të nxënit e tyre gjatë orës mësimore.”* dhe *“Identifikoj vështirësitë me të cilat ballafaqohen nxënësit gjatë procesit të nxënies përmes informatës kthyesë.”* janë grupuar në variablën **“Informata kthyesë”** me mesatare  $M=8.5$  dhe  $DS =1.2$ ; pohimet *“Nxënësit qartësojnë idetë e tyre për qëllimet e të nxënit dhe kriteret e suksesit përmes vlerësimit të ndërsjellë.”* dhe *“Vlerësimi i ndërsjellë ndihmon nxënësit më të dobët sepse i jep mundësi të shohin punë (përgjigje, ese, detyrë, ...) më të avancuar.”* janë grupuar në variablën **“vlerësimi i ndërsjellë”** me mesatare  $M=8.4$  dhe  $DS =1.2$ ; pohimet *“Nxënësit fitojnë ide më të qarta se si t’i ndihmojnë vetes për t’u përmirësuar përmes vetëvlerësimit.”* dhe *“Vetëvlerësimi ndihmon nxënësit të korigjojnë njohuritë e tyre momentale, lëshimet dhe gabimet gjatë të nxënit.”* janë grupuar në variablën **“vetëvlerësimi”** me mesatare  $M=8.6$  dhe  $DS =1.0$ ; pohimet *“Nxënësit mësojnë më shumë kur parashtroj pyetje më shpesh gjatë përcjelljes së përparimit dhe kontorllimit të të kuptuarit.”* dhe *“Parashtrimi i pyetjeve nxit tek nxënësit të menduarit e nivelit të lartë.”* janë grupuar në variablën **“parashtrimi i pyetjeve”** me mesatare  $M=9.3$  dhe  $DS =0.7$ ; dhe pohimet *“Teknikat e VpN-ës e lehtësojnë mësimdhënien dhe nxënien.”* dhe *“Teknikat e VpN-ës nxisin dëshirën dhe përkushtimin e nxënësve si dhe orientojnë ata për arritjen e rezultateve të të nxënit.”* janë grupuar në variablën **“Lehtësimi/Përparësia e përdorimit të teknikave të vlerësimit”** me mesatare  $M=8.8$  dhe devijim standard  $DS=1.2$ .

**Tabela 12.** Analiza përshkruese (mesatarja aritmetike, mediani, moda dhe devijimi standard) e grup variablave për vlerësimin e nxënësve të mbledhura nga mësimdhënësit.

Variablat	Mesatarja aritmetike	Mediani	Moda	Devijimi standard
Planifikimi i vlerësimit	9.1	9.0	10.0	0.9
Informata kthyesë	8.5	9.0	9.0	1.2
Vlerësimi i ndërsjellë	8.4	8.5	8.00 <sup>a</sup>	1.2
Vetëvlerësimi	8.6	8.5	8.0	1.0
Parashtrimi i pyetjeve	9.3	9.0	10.0	0.7
Lehtësimi/Përparësia e përdorimit të teknikave të vlerësimit	8.8	9.0	10.0	1.2

a. Ekzistojnë moda të shumëfishta. Vlera më e ulët është e shfaqur në këtë tabelë.

## 5.3. Testimi i marëdhënieve në mes variablave

### 5.3.1. Analiza e korelacionit

Teknika e Pearson-it është zbatuar për të testuar ndërlidhjen në mes të variablave të grupuara të këtij studimi. Siç shihet edhe në Tabelën 13., në mostrën e nxënësve, ndërlidhje signifikante është gjetur në mes të nivelit të përdorimit të teknikave të vlerësimit formativ me përparësitë e përdorimit të teknikave të vlerësimit,  $r=0.27$ ,  $p=0.01$ . Informata kthyese ka ndërlidhje me të gjitha variablat e grupuara të këtij studimi, me nivelin e përdorimit të teknikave të vlerësimit formativ,  $r=0.30$ ,  $p<0.001$ , me vlerësimin e ndërsjellë,  $r=0.39$ ,  $p<0.001$ , me vetëvlerësimin,  $r=0.44$ ,  $p<0.001$ , me parashtrimin e pyetjeve,  $r=0.43$ ,  $p<0.001$ , dhe me përparësitë e përdorimit të teknikave të vlerësimit,  $r=0.35$ ,  $p<0.001$ . Gjithashtu është gjetur ndërlidhje në mes të vlerësimit të ndërsjellë dhe vetëvlerësimit,  $r=0.52$ ,  $p<0.001$ , si dhe në mes të parashtrimit të pyetjeve dhe përparësive të përdorimit të teknikave të vetëvlerësimit,  $r=0.39$ ,  $p<0.001$ .

**Tabela 13.** Korrelacioni në mes të grup variablave nga të dhënat e mbledhura nga nxënësit për vlerësimin e nxënësve

		Sa përdoren teknikat e vlerësimit formativ	Informata kthyese	Vlerësimi i ndërsjellë	Vetëvlerësimi	Parashtrimi i pyetjeve	Përparësitë e përdorimit të teknikave të vlerësimit
Sa përdoren teknikat e vlerësimit formativ	Korrelacioni i Pearson-it	1	.30**	.16	.19	.15	.27*
	Signifikanca dyanësore		.00	.12	.07	.15	.01
	N	90	90	90	90	90	90
Informata kthyese	Korrelacioni i Pearson-it	.30**	1	.39**	.44**	.43**	.35**
	Signifikanca dyanësore	.00		.00	.00	.00	.00
	N	90	90	90	90	90	90
Vlerësimi i ndërsjellë	Korrelacioni i Pearson-it	.16	.39**	1	.52**	-.03	.05
	Signifikanca dyanësore	.12	.00		.00	.76	.62
	N	90	90	90	90	90	90
Vetëvlerësimi	Korrelacioni i Pearson-it	.19	.44**	.52**	1	.03	.19



	Signifikanca dyanësore	.07	.00	.00		.74	.08
	N	90	90	90	90	90	90
Parashtrimi i pyetjeve	Korrelacioni i Pearson-it	.15	.43**	-.03	.03	1	.39**
	Signifikanca dyanësore	.15	.00	.76	.74		.00
	N	90	90	90	90	90	90
Përparësitë e përdorimit të teknikave të vlerësimit	Korrelacioni i Pearson-it	.27*	.35**	.05	.19	.39**	1
	Signifikanca dyanësore	.01	.00	.62	.08	.00	
	N	90	90	90	90	90	90
** . Korrelacioni është signifkant në nivelin 0.01 (dyanësor).							
* . Korrelacioni është signifkant në nivelin 0.05 (dyanësor).							

Për të vlerësuar ndërlidhjen në mes të planifikimit të vlerësimit me variablat e grupuara të këtij studimi është zbatuar teknika e Spearman-it edhe për mostrën e mësimdhënësve. Sipas të gjeturave të këtij studimi është gjetur ndërlidhje në mes të planifikimit të vlerësimit me informatën kthyesë,  $r=0.47$ ,  $p<0.001$ , me vlerësimin e ndërsjellë,  $r=0.51$ ,  $p<0.001$ , me vetëvlerësimin,  $r=0.33$ ,  $p=0.04$ .

Për ndërlidhjen në mesin e variablave të grupuara të këtij studimi është zbatuar teknika e Pearsonit. Ndërlidhje signifikante është gjetur në mes të informatës kthyesë me vlerësimin e ndërsjellë,  $r=0.62$ ,  $p<0.01$ , dhe me vetëvlerësimin,  $r=0.54$ ,  $p<0.01$ . Ndërlidhje signifikante është gjetur, gjithashtu, edhe në mes të vlerësimit të ndërsjellë dhe vetëvlerësimit,  $r=0.60$ ,  $p<0.01$ . Përparësitë e përdorimit të teknikave të vlerësimit kanë ndërlidhje me informatën kthyesë,  $r=0.47$ ,  $p<0.01$ , vlerësimin e ndërsjellë,  $r=0.46$ ,  $p<0.01$ , dhe vetëvlerësimin,  $r=0.55$ ,  $p<0.01$ .

**Tabela 14. Korrelacioni në mes të grup variablave nga të dhënat e mbledhura nga mësimdhënësit për vlerësimin e nxënësve**

		Informata kthyese	Vlerësimi i ndërsjellë	Vetëvlerësimi	Parashtrimi i pyetjeve
Planifikimi i vlerësimit	Korrelacioni i Spearman-it	.47**	.51**	.33*	.02
	Signifikanca dyanësore	.00	.00	.04	.89
	N	40	40	40	40
Informata kthyese	Korrelacioni i Pearson-it	1	.62**	.54**	.22
	Signifikanca dyanësore		.00	.00	.16
	N	40	40	40	40
Vlerësimi i ndërsjellë	Korrelacioni i Pearson-it	.62**	1.00	.60**	.19
	Signifikanca dyanësore	.00		.00	.23
	N	40	40	40	40
Vetëvlerësimi	Korrelacioni i Pearson-it	.54**	.60**	1.00	.13
	Signifikanca dyanësore	.00	.00		.41
	N	40	40	40	40
Parashtrimi i pyetjeve	Korrelacioni i Pearson-it	.22	.19	.13	1.00
	Signifikanca dyanësore	.16	.23	.41	
	N	40	40	40	40
Përparësitë e përdorimit të teknikave të vlerësimit	Korrelacioni i Pearson-it	.47**	.46**	.55**	.06
	Signifikanca dyanësore	.00	.00	.00	.73
	N	40	40	40	40
<b>** . Korrelacioni është signifikant në nivelin 0.01 (dyanësor).</b>					
<b>* . Korrelacioni është signifikant në nivelin 0.05 (dyanësor).</b>					

### 5.3.2. ANOVA

Për të testuar dallimet në mes të grupeve është zbatuara ANOVA njëkahëshe. Në mostrën e nxënësve nuk janë gjetur dallime në variablat e grupuara në bazë të gjinisë. Por, janë gjetur dallime në bazë të vijueshmërisë së klasës në nivelin e vlerësimit të ndërsjellë [ $F(3, 86) = 7.29$ ,  $p < 0.01$ ] dhe në nivelin e vetëvlerësimit [ $(3, 86) = 4.39$ ,  $p < 0.01$ ].

**Tabela 15.** Dallimet në mesataret aritmetike sipas gjinisë në mesin e nxënësve

		N	Mesatarja aritmetike	Devijimi standard
Sa përdoren teknikat e vlerësimit formativ	Femër	43	9.3	1.0
	Mashkull	47	9.5	1.0
	Gjithsej	90	9.4	1.0
Informata kthyese	Femër	43	8.9	1.3
	Mashkull	47	9.0	1.5
	Gjithsej	90	8.9	1.4
Vlerësimi i ndërsjellë	Femër	43	8.3	1.3
	Mashkull	47	8.2	1.8
	Gjithsej	90	8.3	1.5
Vetëvlerësimi	Femër	43	8.5	1.6
	Mashkull	47	8.4	1.9
	Gjithsej	90	8.4	1.7
Parashtrimi i pyetjeve	Femër	43	9.5	.7
	Mashkull	47	9.3	1.0
	Gjithsej	90	9.4	.9
Përparësitë e përdorimit të teknikave të vlerësimit	Femër	43	9.2	1.1
	Mashkull	47	9.2	1.4
	Gjithsej	90	9.2	1.3

**Tabela 16.** Dallimet në mesataret aritmetike sipas vijueshmërisë së klasës në mesin e nxënësve

		N	Mesatarja aritmetike	Devijimi standard
Sa përdoren teknikat e vlerësimit formativ	2	12	9.5	.5
	3	20	9.7	.8
	4	29	9.3	1.4
	5	29	9.3	.8

	Gjithsej	90	9.4	1.0
<b>Informata kthyesë</b>	2	12	8.9	1.4
	3	20	9.2	1.8
	4	29	8.8	1.2
	5	29	8.9	1.4
	Gjithsej	90	8.9	1.4
	<b>Vlerësimi i ndërsjellë</b>	2	12	9.6
3		20	8.4	1.5
4		29	7.4	1.7
5		29	8.4	1.2
Gjithsej		90	8.3	1.5
<b>Vetëvlerësimi</b>		2	12	8.7
	3	20	9.2	1.6
	4	29	7.6	1.9
	5	29	8.7	1.5
	Gjithsej	90	8.4	1.7
	<b>Parashtrimi i pyetjeve</b>	2	12	9.2
3		20	9.7	.6
4		29	9.4	.8
5		29	9.3	.9
Gjithsej		90	9.4	.9
<b>Përparësitë e përdorimit të teknikave të vlerësimit</b>		2	12	8.8
	3	20	9.5	1.2
	4	29	8.9	1.0
	5	29	9.4	1.5
	Gjithsej	90	9.2	1.3

Për mostrën e mësimdhënësve, variablat e grupuara të këtij studimi janë testuar për dallimet e mundshme në bazë të gjinisë, grupmoshës, përvojës së punës, nivelit të kualifikimit dhe trajnimit. Nuk janë gjetur dallime signifikante të këtyre variablave bazuar në gjini dhe në nivel të kualifikimit. Janë gjetur dallime signifikante në grupmosha sa i përket vlerësimit të ndërsjellë [ $F(3, 36) = 3.54, p=0.02$ ]. Bazuar në përvojë, janë gjetur dallime signifikante në nivelin e vetëvlerësimit [ $(3, 36) = 5.12, p<0.01$ ] dhe në planifikimin e vlerësimit [ $F(3, 36) = 2.78, p=0.05$ ]. Bazuar në trajnime, janë gjetur dallime signifikante në informata kthyesë [ $F(1, 38) = 8.64, p<0.01$ ], në vlerësimin e ndërsjellë [ $F(1, 38) = 6.45, p=0.01$ ], në vetëvlerësim [ $F(1, 38) = 7.26, p=0.01$ ] dhe në përparësitë e përdorimit të teknikave të vlerësimit [ $F(9, 38) = 5.25, p=0.02$ ].

**Tabela 17.** Dallimet në mesataret aritmetike sipas gjinisë në mesin e mësimeve

		N	Mesatarja aritmetike	Devijimi standard
Informata Kthyesë	Femër	32	8.7	1.2
	Mashkull	8	7.9	1.0
	Gjithsej	40	8.5	1.2
Vlerësimi i ndërsjellë	Femër	32	8.5	1.3
	Mashkull	8	8.3	0.7
	Gjithsej	40	8.4	1.2
Vetëvlerësimi	Femër	32	8.5	1.1
	Mashkull	8	8.9	0.6
	Gjithsej	40	8.6	1.0
Parashtrimi i pyetjeve	Femër	32	9.3	0.7
	Mashkull	8	9.4	0.7
	Gjithsej	40	9.3	0.7
Përparësitë e përdorimit të teknikave të vlerësimit	Femër	32	8.8	1.3
	Mashkull	8	8.6	0.9
	Gjithsej	40	8.8	1.2
Planifikimi i vlerësimit	Femër	32	9.2	0.8
	Mashkull	8	8.8	0.9
	Gjithsej	40	9.1	0.9

**Tabela 18.** Dallimet në mesataret aritmetike sipas grupmoshës në mesin e mësimeve

		N	Mesatarja aritmetike	Devijimi standard
Informata Kthyesë	25-30	2	9.5	0.7
	31-40	9	8.9	1.3
	41-50	11	8.5	0.7
	Mbi 50	18	8.2	1.3
	Gjithsej	40	8.5	1.2
Vlerësimi i ndërsjellë	25-30	2	10.0	0.0
	31-40	9	8.8	1.3
	41-50	11	8.7	0.9
	Mbi 50	18	7.9	1.1
	Gjithsej	40	8.4	1.2
Vetëvlerësimi	25-30	2	9.0	1.4
	31-40	9	9.0	0.9

	41-50	11	8.7	1.0
	Mbi 50	18	8.2	1.0
	Gjithsej	40	8.6	1.0
Parashtrimi i pyetjeve	25-30	2	10.0	0.0
	31-40	9	9.1	0.8
	41-50	11	9.5	0.7
	Mbi 50	18	9.2	0.7
	Gjithsej	40	9.3	0.7
Përparësitë e përdorimit të teknikave të vlerësimit	25-30	2	10.0	0.0
	31-40	9	9.0	1.0
	41-50	11	8.9	1.0
	Mbi 50	18	8.4	1.3
	Gjithsej	40	8.8	1.2
Planifikimi i vlerësimit	25-30	2	9.0	1.4
	31-40	9	9.8	0.4
	41-50	11	9.0	1.0
	Mbi 50	18	8.9	0.8
	Gjithsej	40	9.1	0.9

**Tabela 19.** Dallimet në mesataret aritmetike sipas nivelit të përvojës së punës në mesin e mësimdhënësve

	N	Mesatarja aritmetike	Devijimi standard	
Informata Kthyesë	0-2	1	10.0	.
	6-10	6	8.7	1.5
	11-15	9	9.1	0.8
	Mbi 15	24	8.2	1.1
	Gjithsej	40	8.5	1.2
Vlerësimi i ndërsjellë	0-2	1	10.0	.
	6-10	6	9.2	1.0
	11-15	9	8.4	1.1
	Mbi 15	24	8.2	1.2
	Gjithsej	40	8.4	1.2
Vetëvlerësimi	0-2	1	10.0	.
	6-10	6	9.3	0.8
	11-15	9	9.0	0.9
	Mbi 15	24	8.1	0.9
	Gjithsej	40	8.6	1.0
Parashtrimi i pyetjeve	0-2	1	10.0	.
	6-10	6	9.2	0.8

	11-15	9	9.2	0.7
	Mbi 15	24	9.4	0.8
	Gjithsej	40	9.3	0.7
Përparësitë e përdorimit të teknikave të vlerësimit	0-2	1	10.0	.
	6-10	6	9.3	0.5
	11-15	9	9.1	1.1
	Mbi 15	24	8.5	1.3
	Gjithsej	40	8.8	1.2
Planifikimi i vlerësimit	0-2	1	10.0	.
	6-10	6	9.8	0.4
	11-15	9	9.2	0.8
	Mbi 15	24	8.9	0.9
	Gjithsej	40	9.1	0.9

**Tabela 20.** Dallimet në mesataret aritmetike sipas nivelit të shkollimit në mesin e mësimeve të mesimit

		N	Mesatarja aritmetike	Devijimi standard
Informata Kthyesë	Bachelor	30	8.6	1.2
	Master	10	8.3	1.3
	Gjithsej	40	8.5	1.2
Vlerësimi i ndërsjellë	Bachelor	30	8.5	1.1
	Master	10	8.2	1.5
	Gjithsej	40	8.4	1.2
Vetëvlerësimi	Bachelor	30	8.6	1.0
	Master	10	8.3	1.1
	Gjithsej	40	8.6	1.0
Parashtrimi i pyetjeve	Bachelor	30	9.4	0.7
	Master	10	9.1	0.9
	Gjithsej	40	9.3	0.7
Përparësitë e përdorimit të teknikave të vlerësimit	Bachelor	30	8.7	1.3
	Master	10	9.0	0.9
	Gjithsej	40	8.8	1.2
Planifikimi i vlerësimit	Bachelor	30	9.1	0.9
	Master	10	9.2	0.8
	Gjithsej	40	9.1	0.9

**Tabela 21.** Dallimet në mesataret aritmetike sipas ndjekjes së trajnimeve në mesin e mësimdhënësve

		N	Mesatarja aritmetike	Devijimi standard
Informata Kthyese	Po	36	8.3	1.1
	Jo	4	10.0	0.0
	Gjithsej	40	8.5	1.2
Vlerësimi i ndërsjellë	Po	36	8.3	1.1
	Jo	4	9.8	0.5
	Gjithsej	40	8.4	1.2
Vetëvlerësimi	Po	36	8.4	1.0
	Jo	4	9.8	0.5
	Gjithsej	40	8.6	1.0
Parashtrimi i pyetjeve	Po	36	9.3	0.8
	Jo	4	9.3	0.5
	Gjithsej	40	9.3	0.7
Përparësitë e përdorimit të teknikave të vlerësimit	Po	36	8.6	1.2
	Jo	4	10.0	0.0
	Gjithsej	40	8.8	1.2
Planifikimi i vlerësimit	Po	36	9.1	0.8
	Jo	4	9.5	1.0
	Gjithsej	40	9.1	0.9

Po ashtu, me teknikën e ANOVA-s njëkahëshe janë testuar dallimet në mes nxënësve dhe mësimdhënësve sa i përket informatës kthyese, vlerësimit të ndërsjellë, vetëvlerësimit, parashtrimin të pyetjeve dhe përparësive të përdorimit të teknikave të vlerësimit. Të gjeturat e këtij studimi tregojnë që nuk ka dallime signifikante në mes nxënësve dhe mësimdhënësve në raport me këto variabla.

## 5.4. Analiza e të dhënave cilësore

Të dhënat cilësore për hulumtim u realizuan duke intervistuar 3 ekspertë të fushës së vlerësimit (trajnerë/fasilitues) të cilët njëkohësishtë ishin edhe mësimdhënës. Trajnerët i takonin tri shkollave të ndryshme të përfshira në mostër. 4 trajnerë i takonin gjinisë femërore dhe 1 trajner i takonte gjinisë mashkullore. Trajnerët pjesëmarrës në intervistë ishin të moshave të ndryshme, 1 prej tyre i takonte grupmoshës 31-40 vjeç, 3 trajnerë i takonin grupmoshës 41-50 vjeç, dhe 1



trajner ishte mbi moshën 50 vjeçare. Nga numri i përgjithshëm i trajnerëve të intervistuar, 3 prej tyre ishin me nivelin e shkollimit baçelor, ndërsa 2 të tjerët me master. 1 trajner i intervistuar i takonte grupit me 11-15 vite përvojë në mësimdhënie dhe 4 trajnerët e tjerë ishin me mbi 15 vjet përvojë pune në mësimdhënie. Ndërsa, sa i përket përvojës së punës së tyre si fasilitues, 1 trajner i takonte grupit me 3-5 vite e 4 të intervistuarit e tjerë i takonin grupit 6-10 vite.

**Tabela 22. Karakteristikat përshkruese të pjesëmarrësve në intervistë**

Gjinia		Femër	Mashkull				N
	N	4	1				5
%	80	20				100	
Mosha (vjeç)		Nën 25 vjeç	25-30	31-40	41-50	Mbi 50 vjeç	N
	N	0	0	1	3	1	5
%	0	0	20	60	20	100	
Shkalla e fundit e kualifikimit		Bachelor	Master	Doktoratë			N
	N	3	2	0			5
%	60	40	0			100	
Përvojë në mësimdhënie (vite)		0-2 vite	3-5 vite	6-10 vite	11-15 vite	Mbi 15 vite	N
	N	0	0	0	1	4	5
%	0	0	0	20	80	100	
Përvojë pune si fasilitues /trajner		0-2 vite	3-5 vite	6-10 vite	11-15 vite	Mbi 15 vite	N
	N	0	1	4	0	0	5
%	0	20	80	0	0	100	

Intervistimi është realizuar në objektet shkollore përkatësisht në shkollat ku punojnë trajnerët/mësimdhënësit e intervistuar. Duke marrë leje paraprakisht intervistat me mësimdhënëset janë inçizuar, por sigurisht edhe duke ruajtur anonimitetin dhe të gjitha parimet etike dhe profesionale. Pas realizimit të intervistave dhe transkriptimit të tyre është përdorur analiza tematike e të dhënave të mbledhura. Pra, analizimi i të dhënave cilësore është realizuar përmes analizës tematike. Fillimisht është bërë transkriptimi i intervistave dhe pastaj është bërë kodimi i tyre e në vazhdim janë dhënë interpretimet fillestare të vendosura në tabelë. Bazuar në interpretime janë nxjerrë edhe temat në mënyrë të detajuar dhe janë shkruar të përmbledhura të dhënat më të rëndësishme.

## **Tema 1: Ndryshimet përmbajtësore dhe organizative**

Me zbatimin e KKK ndodhi një cikël i ri i reformave në arsim. Kur kemi parasysh faktin që KKK promovon përfshirjen aktive të nxënësve në përzgjedhjen e përvojave të të nxënësve dhe vetëdijësimin e tyre për të vlerësuar dhe për të vetëvlerësuar atëherë është shumë e qartë se ndodhën ndryshime përmbajtësore dhe organizative. Ndryshimet përmbajtësore të cilat u theksuan nga mësimdhënësit e intervistuar (trajnerë të fushës së vlerësimit) ishin qasja në kompetenca dhe rezultate të të nxënësve, riorganizimi i fushave kurrikulare dhe shkallëve kryesore të kurrikulës, metodologjia e mësimdhënies dhe mësimnxënies, vlerësimi i arritjes së nxënësve, riorganizimi i kurrikulës me zgjedhje, si dhe aspektet tjera të organizimit në nivel shkolle... si dhe realizimi i procesit mësimor të integruar, i cili mundëson që marrëdhënia e fëmijëve me mjedisin natyror dhe me mjedisin e krijuar nga njeriu të kuptohet në mënyrë sa më të plotë. Ndërsa, ndryshimet organizative që pohuan të intervistuarit, në procesin e mësimdhënies, nxënies dhe vlerësimit me zbatimin e KKK mësimi është i strukturuar nëpër gjashtë nënivele formale apo gjashtë shkallë kurrikulare që përbëhen prej një, dy ose tre viteve/klasëve dhe riorganizimin e tetë fushave kurrikulare të cilat përmbajnë një, dy ose tre lëndë. Gjithashtu u theksua edhe strukturimi i vitit shkollor në tri periudha kohore.

## **Tema 2: Shkalla e zbatimit të vlerësimit formativ**

Duke marrë parasysh që Korniza Kurrikulare përcakton tri lloje të vlerësimit të brendshëm si, vlerësimin e vazhdueshëm që bëhet gjatë procesit të të nxënësve (vlerësimi formativ) dhe në fund të çdo teme mësimore, njësie tematike apo periudhe të mësimorit (vlerësimi përmbledhës), vlerësimin përfundimtar që bëhet në fund të vitit shkollor si dhe vlerësimin për shkallë që bëhet në fund të çdo shkalle kurrikulare të intervistuarit shprehen se janë të obliguar të zbatojnë edhe vlerësimin formativ. Pati nga të intervistuarit që u shprehën se nëse jo gjithmonë e zbatojnë me të gjithë nxënësit brenda një ore mësimore, këtë lloj vlerësimi e planifikojnë si pjesë përbërëse të orës duke përfshirë nxënësit që duan t'i vlerësojnë për një qëllim të caktuar. Gjithashtu mund të përfundoj se mësimdhënësit e zbatojnë VpN pothuajse rregullisht në së paku njërin nga etapat e orës mësimore. Të intervistuarit vunë në pah se vlerësimi formativ kërkohet edhe nga kurrikula e re dhe se kjo formë vlerësimi është bërë pjesë e pandashme e punës së tyre sepse po ndihmon në cilësinë e procesit mësimor, po ndihmon mësimdhënësit, por edhe vet nxënësit në strukturimin e të nxënësve.

### **Tema 3: Efektet e vlerësimit formativ në arritjen e rezultateve të të nxënët**

Nga vet fakti se vlerësimi formativ është vlerësim që parimisht është i bazuar në punën në klasë dhe realizohet nga vet mësuesin atëherë ata thonë se veç tjerash, efekti kryesor i këtij lloji vlerësimi është përkrahja e nxënësve për përparimin e tyre në mësim. Me shumë përgjegjësi thonë se teknikat e vlerësimit formativ kanë efekt pozitiv në arritjen e rezultateve të të nxënët. Për t'i vlerësuar nxënësit sipas kurrikulës së bazuar në kompetenca, këto teknika u mundësojnë nxënësve t'i demonstrojnë jo vetëm njohuritë, por edhe shkathtësitë dhe qëndrimet e tyre. Teknikat e vlerësimit formativ kanë efekte shumë të mira tek nxënësit sepse përdorimi i instrumenteve të ndryshme të vlerësimit në varësi të llojeve të të nxënët që do të vlerësohen në procesin e të nxënët, u siguron nxënësve përparim dhe arritje të rezultateve pozitive.

### **Tema 4: Ndikimi i teknikave të vlerësimit formativ**

Sipas përgjigjeve të marra nga të intervistuarit në rolin e mësuesin, por edhe të trajnerit mund të themi se të gjitha teknikat e vlerësimit formativ në një formë apo në një tjetër, janë të përshtatshme dhe se kanë ndikim në arritjen e rezultateve. Ato janë vetëvlerësimi, vlerësimi i ndërsjellë, parashtrimi i pyetjeve efektive dhe informata kthyesë, vetëm se duhet ditur përzgjedhur teknikën e duhur për momentin dhe qëllimin e asaj se çfarë duam të vlerësojmë. Ndikimet janë të shumta, por ajo që ja vlen të theksohet thonë se këto teknika u mundësojnë nxënësve të përdorin, të lidhin apo zbatojnë ide, të japin arsye, të përmbledhin apo të vlerësojnë dhe shpesh të përfshijnë përgjigje të zgjeruara që të paraqesin të kuptuarit më të thellë. Gjithashtu theksojnë si ndikim pozitiv identifikimin e vështirësive me të cilat ballafaqohen nxënësit, i ndihmojnë nxënësit duke ju dhënë mundësi që të shohin punë më të avancuar, dhe nxënësit janë në gjendje të analizojnë punën e tyre. Në vazhdimësi shohin se ndikimi më i madh i këtyre teknikave në arritjen e rezultateve të të nxënët është motivimi dhe ngritja e vetëbesimit, të cilat konsiderohen si çelësi i suksesit.

### **Tema 5: Përparësitë dhe kufizimet**

Si anë pozitive apo përparësi të intervistuarit theksuan se këto teknika orientojnë vlerësimin kah përparimi, mundësojnë vlerësimin të varur nga shumë gjëra. Ata thonë se përparësia tjetër e përdorimit të këtyre teknikave është ofrimi i kushteve specifike dhe të matshme për atë që nxënësi do të dijë, ose do të jetë në gjendje ta bëjë si rezultat i angazhimit në aktivitetin mësimor. Nisur nga ajo me të cilat përballen mësuesin çdo ditë gjatë punës me nxënës, thonë se përparësitë janë të shumta. Psh.me anë të përdorimit të këtyre teknikave mund të paraqesin një

portret të saktë dhe të përmbledhur të nxënësit, përfshijnë nxënësit në vendime, u mundësojnë nxënësve t'i shfaqin ndryshimet siç janë inteligjencat e shumëfishta, diversitetin kulturor etj, si dhe ngrisin përgjegjësinë për vetëvlerësim. Sa i përket kufizimeve apo sfidave mësimdhënësit janë të vetëdijshëm se ka në çdo proces të punës si mësimdhënës. Mësimdhënësit pavarësisht përvojës së tyre shumëvjeçare, tërë procesin e vlerësimit e konsiderojnë si pjesën më sfiduese të punës së tyre. Gjatë zbatimit të teknikave të vlerësimit formativ nga të intervistuarit u theksua si pjesë më sfiduese përzgjedhja e duhur dhe e përshtshme e instrumenteve të vlerësimit, tekstet joadekuate shkollore dhe pa kritere sipas kurrikulës së re të bazuar në kompetenca për klasat apo nivelet përkatëse, si dhe numri i madh i nxënësve në klasë.

## **VI. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET**

Nga ky hulumtin i bërë në tri shkolla të mesme të ulta të Prishtinës përkatësisht SHFMU “Faik Konica”, SHFMU “Xhemajl Mustafa” dhe SHFMU “Naim Frashëri” lidhur me ndikimin e teknikave të vlerësimit formativ në arritjen e rezultateve të të nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe, duke u bazuar në shqyrtimin e literaturës, të dhënave sasiore dhe të dhënave cilësore mund të konstatojmë se qëndrimet e mësimdhënësve dhe nxënësve fillimisht tregojnë se vlerësimi formativ përdoret kënaqshëm në këto shkolla. Vij në këtë konkludim bazuar në pohimet e mësimdhënësve të cilët shprehen se përfshijnë edhe vlerësimin si pjesë përbërëse të orës mësimore gjatë planifikimit të saj, përfshijnë teknika të ndryshme të vlerësimit formativ në procesin mësimor për arritjen e rezultateve të të nxënësve, se zbatojnë standardet e vlerësimit dhe kodin etik për të përcaktuar parimet themelore për vlerësimin e nxënësve dhe të sjelljes etike të tyre, krahasojnë arritjet e nxënësve për të parë ndikimin e strategjive dhe teknikave të vlerësimit dhe se shfrytëzojnë rezultatet e vlerësimit për të përmirësuar mësimdhënien dhe nxënien e nxënësve. Kjo u vërtetua edhe nga pohimet e nxënësve, të cilët në një masë të madhe pohuan se vlerësohen në mënyra të ndryshme dhe se përveç vlerësimit në fund të periudhave, vlerësohen në vazhdimësi nga mësuesja/mësuesi edhe gjatë orës mësimore. Pra, ky vlerësim ndikon edhe në ngritjen e cilësisë në mësim.

Nisur nga hipoteza themelore se në procesin e mësimdhënies, përdorimi i teknikave të vlerësimit formativ ndikon ndjeshëm në arritjen e rezultateve të të nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe, mund të themi se kjo hipotezë është vërtetuar. Gjithashtu edhe nga pyetja themelore e hulumtimit se çfarë ndikimi ka përdorimi i teknikave të vlerësimit formativ në arritjen e rezultateve të të nxënësve

në lëndën e gjuhës shqipe, morëm përgjigje se përdorimi i këtyre teknikave gjatë procesit mësimor ka ndikim mjaftë të mirë në mësimdhënie dhe nxënie. Ajo që doli në pah, nga qendrimet e mësimdhënësve dhe nxënësve ishte se në një masë të konsiderueshme përdorimi i teknikave të vlerësimit formativ lehtësojnë mësimdhënien dhe nxënien, nxisin dëshirën dhe përkushtimin e nxënësve si dhe orientojnë ata për arritjen e rezultateve të të nxënit.

Nisur nga fakti që teknikat më të përshtatshme vlerësuese të vlersimit formativ, për aplikim në lëndën e gjuhës shqipe që përdorin mësimdhënësit janë vetëvlerësimi, vlerësimi i ndërsjellë, informata kthyesë si teknika të vlerësimit formativ u vërtetua edhe nënhipoteza e hulumtimit se vetëvlerësimi dhe vlerësimi i ndërsjellë ndihmojnë dhe nxisin pjesëmarrjen aktive të nxënësve në diskutime dhe në aktivitete që realizohen brenda shkollës në lëndën e gjuhës shqipe. Lidhur me vetëvlerësimin pjesa dominuese e mësimdhënësve dhe e nxënësve u shprehën se nxënësit fitojnë ide më të qarta se si t'i ndihmojnë vetes për t'u përmirësuar, por edhe se kjo teknikë ndihmon nxënësit të korigjojnë njohuritë e tyre momentale, lëshimet dhe gabimet gjatë të nxënit. Sa i përket vlerësimit të ndërsjellë nga rezultatet e marra u vërtetua se nxënësit qartësojnë idetë e tyre për qëllimet e të nxënit dhe kriteret e suksesit përmes kësaj teknike. Gjithashtu u theksua se ka ndikim edhe më të madh në arritjen e rezultateve të të nxënit sepse ndihmon nxënësit më të dobët meqenë se i jep mundësi të shohin punë (përgjigje, ese, detyrë, ...) më të avancuar. Gjatë këtij hulumtimi u vërtetua nënhipoteza e radhës se informatat kthyesë bëjnë më të qarta përparimet dhe vështirësitë e nxënësve në procesin mësimor. Lidhur me informatat kthyesë pjesa më e madhe e responentëve nga ana e mësimdhënësve pohojnë se u japin të gjithë nxënësve informata kthyesë për të nxënit e tyre gjatë orës mësimore, por edhe se përmes kësaj teknike identifikojnë vështirësitë me të cilat ballafaqohen nxënësit gjatë procesit të nxënies. Poashtu edhe shumica e responentëve nga ana e nxënësve pohojnë se mësimdhënësit ua korigjojnë gabimet, u japin sqarime, i vlerësojnë e i lavdërojnë...me gojë, me shkrim e edhe me gjestikulacione. Gjithashtu u theksua se kjo i bën të kuptojnë nëse janë në rrugën e duhur gjatë dhënies së një përgjigjeje apo kryerjes së një detyre. Gjatë këtij hulumtimi doli në pah se përpos këtyre teknikave, të cilat ishin preparë në pyetjet hulumtuese dhe nënhipotezat e hulumtimit, një teknikë me ndikim shumë të madh në arritjen e rezultateve të të nxënit në lëndën e gjuhës shqipe ishte edhe teknika parashtrimi i pyetjeve. Më konkretisht, mësimdhënësit shprehen në masë të madhe, se nxënësit mësojnë më shumë kur u parashtrojnë pyetje më shpesh gjatë përcjelljes së përparimit dhe kontorllimit të të kuptuarit, por edhe se kjo teknikë ka ndikim edhe më të madh sepse nxit tek

nxënësit të menduarit e nivelit të lartë. E gjithë kjo vërtetohet edhe nga vet nxënësit, të cilët shprehën se mësojnë më shumë kur mësuesja/mësuesi bënë pyetje më shpesh gjatë orës mësimore dhe se parashtrimi i pyetjeve nga mësuesja/mësuesi i nxit të mendojnë më thellë, të imagjinojnë dhe të jenë më kreativ.

Nga deklaratimet e mësimeve dhe nxënësve të nxjerra nga analiza përshkuese përfundojmë se niveli i zbatimit të vlerësimit formativ është i lartë, mësimeve përdorin teknika të ndryshme të vlerësimit formativ gjatë procesit mësimor dhe se ndikimi i këtyre teknikave është mjaftë pozitiv me çrast rezultatet e të nxënësve janë më lehtë të arritshme.

Nga të dhënat sasiore në mostrën e nxënësve vërejmë se janë gjetur dallime në bazë të vijueshmërisë së klasës në nivelin e vlerësimit të ndërsjellë. Ndërsa, në mostrën e mësimeve janë gjetur dallime të rëndësishme në grupmosha sa i përket vlerësimit të ndërsjellë. Bazuar në përvojë, janë gjetur dallime në nivelin e vetëvlerësimit dhe në planifikimin e vlerësimit si dhe bazuar në trajnime, janë gjetur dallime në informata kthyesë, në vlerësimin e ndërsjellë, në vetëvlerësim dhe në përparësitë e përdorimit të teknikave të vlerësimit.

## **6.1. Rekomandimet**

Duke u bazuar në shqyrtimin e literaturës, të dhënave sasiore dhe të dhënave cilësore gjatë procesit të hulumtimit mund të konstatojmë se qëndrimet e mësimeve lidhur me ndikimin e teknikave të vlerësimit formativ në arritjen e rezultateve të të nxënësve tregojnë se përdorimi i tyre ndikon rrënjësisht në arritjen më të lehtë të rezultateve, por të gjeturat e hulumtimit hedhin në pah dhe problematikat që pamundësojnë zbatimin e qasjes konstruktiviste e për të cilat rekomandohet që:

- Të organizohen trajnime për përdorimin dhe zbatimin e teknikave efektive të vlerësimit formativ në kuadër të zhvillimit profesional të mësimeve nga organet kompetente përgjegjëse;
- Të monitorohen mësimeve nga institucionet përkatëse për të siguruar zbatimin dhe aplikimin e drejtë të këtyre teknikave;
- Të përdoren teknika sa më të llojllojshme për të sjellë rezultate sa më të mira të të nxënësve;
- Të përfshihen teoria dhe teknikat e vlerësimit formativ në kurrikulat lëndore të arsimit parauniversitar, gjegjësisht në atë fillor.

- Të realizohen studime më të gjera dhe të detajuara për rolin dhe ndikimin mësimdhënësve gjatë aplikimit të teknikave të vlerësimit formativ me përfshirje të mostrës nga vende të ndryshme dhe të përdoren teknika të hulumtimit të kombinuara që të ketë të gjetura më gjithëpërfshirëse.

## **6.2. Limitet**

Edhe pse hulumtimi është kryer duke u bazuar në të gjitha rregullat e përcaktuara hulumtuese dhe me një kujdes të konsiderueshëm për të siguruar saktësinë e rezultateve të fituara, të dhënat janë analizuar e mbledhur saktë dhe drejtë, megjithatë si çdo hulumtim tjetër që nuk mund të përfshijë në tërësi problemin si të vetëm, edhe ky hulumtim ka disa kufizime.

Limiti apo kufizimi i parë që ka ndikuar në mënyrën e grumbullimit të të dhënave dhe në rrjedhën e hulumtimit është përhapja e pandemisë COVID-19 duke shkaktuar dhe pengesa të natyrave të ndryshme dhe si rezultat i saj është realizuar mbledhja e të dhënave sasiore përmes pyetësorëve të mësimdhënësve dhe nxënësve duke pamundësuar edhe realizimin e hulumtimit ashtu siç ishte paraparë në projektin hulumtues.

Thënë faktin se problemi i trajtuar në këtë hulumtim është mjaft i gjerë dhe duhet shikuar nga këndvështrime të ndryshme si limit i dytë i hulumtimit është hezitimi i ekspertëve të fushës së vlerësimit për t'u intervistuar, sepse për të studiuar një temë të tillë do të ishte e domosdoshme dhe kombinimi i më shumë metodave të tjera studimore për të dhënë detaje më të hollësishme.

Numri i vogël i mostrës paraqet një tjetër kufizim në këtë studim, janë përfshirë klasët e dyta, të treta, të katërta dhe të pesta të tri shkollave të Prishtinës. Një numër më i madh i mostrës besoj do të jepte rezultate më të thella dhe më të plota lidhur me temën hulumtuese.

Si limit i katërt dhe i fundit në këtë studim mund të potencohet fakti se pyetësi kishte pyetje të shumta, që nënkupton ndikimin në përgjigjet e nxënësve pjesëmarrës në hulumtim.

## **6.3. Implikimet praktike**

Ky hulumtim na bën të mundur që të njihemi më nga afër me perceptimet e mësimdhënësve për ndikimin e teknikave të vlerësimit formativ, të shohim rëndësinë e madhe që ka të kuptuarit e drejtë të ndryshimeve në vlerësimin e nxënësve, poashtu edhe rëndësinë që ka zhvillimi i shkathtësive në planifikimin dhe zbatimin e vlerësimit të nxënësve sipas kërkesave, të kurrikulës

së bazuar në kompetenca. Me përdorimin e teknikave të vlerësimit formativ mësuesit janë në gjendje të gjejnë mbi përparimet e nxënësve për të nxënë, të motivojnë dhe të nxisin nxënësit për të nxënë, të gjejnë, të reflektojnë dhe të përmirësojnë procesin e mësimit dhe nxënies, të masin arritjet e nxënësve, të raportojnë arritjet e të nxënësve si dhe t'u japin sugjerime nxënësve për përpunimin e tyre. Duke u bazuar në këtë prirje që në të ardhmen mësuesit t'i kushtojnë një rëndësi më të madhe teknikave të vlerësimit formativ, në mënyrë që edhe vetë atyre të mos ju shfaqen barrierat për arritjen e rezultateve të të nxënësve. Këto perceptime si dhe përvoja të mësuesve mund të jenë një bazë e mirë për reformimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe trajnimeve profesionale, si dhe shumë faktorëve të tjerë që ndikojnë në profesionin e mësimit.



## VII. REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE

- Assessment Reform Group. (2002). Assessment for learning. In *10 Principles. Research based principles to guide classroom practice*. Berkshire: Open University Press.
- Allan C. Orsten & Francis P. Hunkins (2003). *Kurrikula, bazat, parimet dhe problemet*. Tiranë: Instituti i Studimeve Pedagogjike.
- Basic Education Program, (2011). *Vlerësimi Formativ*. Prishtinë.
- Beci, B. (2007). *Gjuha shqipe 5*. Pejë.
- Battersby, M. (1999). Assessment and Learning. *Learning Quarterly*.
- Black, Paul & Wiliam, Dylan. (1998). Assessment and Classroom Learning. *Assessment in Education: Principles, Policy & Practice*, <http://dx.doi.org/10.1080/0969595980050102>.
- Bhaskara D. Rao. (2010). *Self Evaluation in Student Teaching*. Discovery Publishing House.
- Black P., & D. Wiliam (1998). *Assessment and classroom learning*. *Assessment in Education*. 5(1), fq. 7-74.
- Boud, D. (1995). *Enhancing Learning Through Self-assessment*. London.
- Brookfield, S. (1995). *Becoming a critically reflective teacher*. San Francisco, CA: Jossey-Bass.
- Brown, S. & Knight, P. (1994). *Assessing Learners in Primary Education*. London: Kogan.
- Charles Temple, A. C. (2006). *Strategji të mësimdhënies dhe të të nxënit për klasat mendimtare*. Prishtinë.
- Formative Evaluation of Student Learning*. Marrë më 10 Prill, 2018, nga <https://inside.trinity.edu/collaborative/resources/formative-evaluation-student-learning>
- Fullan, M. (2010). *Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim*. Tiranë: CDE.
- GIZ, (2009). *Vlerësimi në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve*. Prishtinë.
- Harris, J. R. (1998). *The Nurture Assumption: Why Children Turn Out the Way They Do*. New York: The Free Press.
- Hutchings, P. (1992). General education and assessment: Powerful connections. *Assessment Update*, 5-8.
- Janet R. Moyles.(2011). *Self-evaluation: A Primary Teacher's Guide*.
- Kraja, M. (2006). *Pedagogjia*. Tirane.
- Mailaret, G. (1997). *Pedagogjia e Përgjithshme*. Prishtinë.
- Maki, P. (2002). *Developing an Assessment Plan to Learn about Student Learning*. Washington.
- MASHT. (2011). *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*. Prishtinë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
- MASHT. (2011). *Udhëzues. Standardet e Vlerësimit. 490/01 B*. Prishtinë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

- MASHT, (2011). Udhëzues. *Kodi i Etikës për vlerësimin e nxënësve* nr. 491/01 B. Prishtinë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
- MASHT, (2012). *Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë*. Prishtinë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
- MASHT. (2016). *Kurrikula Bërthamë*. Prishtinë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Mickovska, G. & Tasevska A. (2015). Doracak për arsimtarë. *Notimi formativ në mësimin klasor*. Shkup. fq.11-18.
- Miller, B. (2003). *Si të krijohet kontakti i suksesshëm me nxënësit*. Ferizaj.
- Mueller, J. (2012). Wahat is Authentic Assessment? *Journal of Online Learning and teaching*. <http://jfmuellet.faculty.noctrl.edu/toolbox/whatisit.htm>.
- Musai, B. (2003). *Metodologji e mësimdhënies*, Tiranë: Pegi.
- Musai, B. (2006). *Strategji të mësimdhënies dhe të nxënimit për klasat mendimtare*. Tiranë.
- Norman E. Gronlund & Robert L. Linn. (1990). *Measurement and Evaluation in Teaching*. bot. i gjashtë. New York: Macmillan.
- Ofsted. (1996). *Standards and Quality in Education*. UK: Annual Report.
- Pollard, A. (2005). *Reflective Teaching*. Continuum. London.
- Principles of good feedback practice*. Marrë më 3 Prill, 2018, nga <https://srhe.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/03075070600572090#.Ws0amdRuacw>
- Standardet e vlerësimit*. Marrë më 24 Mars, 2018, nga <https://prezi.com/8gajybcahqwe/standardet-e-vleresimit/>
- Stassen, M. L. (2001). *Methods for understanding student learning*. Indio: Robert Langhorst & Company Booksellers.
- Syla, Xh. (2017). *LEXIMI gjuhë shqipe dhe letërsi 5*. Prishtinë.
- The Role of Formative Evaluation in Implementation Research and the Experience*. Marrë më 29 Mars, 2018, nga <https://onlinelibrary.wiley.com/doi/full/10.1111/j.1525-1497.2006.00355.x>
- Watson, A. (1994). Strategies for the Assessment of Competence. *The Vocational Aspect of Education*, pp. 155-165.
- Wiggins, G. & Mctighe, J. (2005). *The Understanding by Design Guide*. ASCD; 1st edition.
- Wragg, T. (1997). *Assessment and Learning: Primary and Secondary*. London : Routledge.
- Woolfolk, A. (2002). *Psikologji edukimi*. Pejë.
- Zeneli, I. (2003). *Bazat e standardizimit dhe vlerësimit*. Prishtinë: Libri shkollor.
- Zylfiu, N. (1997). *Didaktika*. Prishtinë.

## Shtojca A - Pyetësi për mësimdhënës

Të nderuar mësimdhënës,

Ky pyetësor ka për qëllim grumbullimin e të dhënave nga mësimdhënësit e shkollave fillore të Republikës së Kosovës, për nivelin e zbatimit të vlerësimit formativ dhe ndikimin e teknikave të VpN në arritjen e rezultateve të të nxënës në lëndën e gjuhës shqipe.

Përceptimet dhe përvojat tuaja do të jenë një kontribut i mirë dhe do të shërbejnë për çështje hulumtimi. Pyetësi është anonim dhe mbi të gjitha, të dhënat që do të mblidhen me këtë pyetësor, do të përdoren vetëm për qëllime studimi.

*Ju falënderoj paraprakisht dhe u jam mirënjohëse nëse pranoni të jeni pjesë e këtij hulumtimi!*

Informacione të përgjithshme					
<b>1</b>	<b>Gjinia</b>	Mashkull <input type="checkbox"/>	Femër <input type="checkbox"/>		
<b>2</b>	<b>Mosha (vjeç)</b>	Nën 25 <input type="checkbox"/>	25-30 <input type="checkbox"/>	31-40 <input type="checkbox"/>	41-50 <input type="checkbox"/> Mbi 50 <input type="checkbox"/>
<b>3</b>	<b>Komuna ku punoni</b>	_____			
<b>4</b>	<b>Përvojë në mësimdhënie (vite)</b>	0-2 <input type="checkbox"/>	3-5 <input type="checkbox"/>	6-10 <input type="checkbox"/>	11-15 <input type="checkbox"/> Mbi 15 <input type="checkbox"/>
<b>5</b>	<b>Shkalla e fundit e kualifikimit tuaj</b>	Bachelor <input type="checkbox"/>	Master <input type="checkbox"/>	Doktoratë <input type="checkbox"/>	
<b>6</b>	<b>A keni ndjekur trajnime ku është trajtuar tema e vlerësimit?</b>				Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>

**Ju lutem zgjidhni vetëm një të njërën nga alternativat që përputhet me mendimin tuaj, duke vendosur**

Nr.	Pohimet	Niveli				
		1	2	3	4	5
1.	Gjatë planifikimit të orës mësimore përfshij edhe vlerësimin si pjesë përbërëse të saj.					
2.	Zbatoj standardet e vlerësimit dhe kodin etik për të përcaktuar parimet themelore për vlerësimin e nxënësve dhe të sjelljes etike të tyre.					
3.	Përfshij teknika të ndryshme të vlerësimit formativ në procesin mësimor për arritjen e rezultateve të të nxënësve.					
4.	Krahasoj arritjet e nxënësve të mi për të parë ndikimin e strategjive dhe teknikave të vlerësimit.					
5.	Shfrytëzoj rezultatet e vlerësimit për të përmirësuar mësimdhënien dhe nxënien e nxënësve.					
6.	Teknikat e VpN-ës e lehtësojnë mësimdhënien dhe nxënien.					
7.	Jap të gjithë nxënësve informata kthyesë për të nxënësve të tyre gjatë orës mësimore.					
8.	Identifikoj vështirësitë me të cilat ballafaqohen nxënësit gjatë procesit të nxënies përmes informatës kthyesë.					
9.	Nxënësit qartësojnë idetë e tyre për qëllimet e të nxënësve dhe kriteret e suksesit përmes vlerësimit të ndërsjellë.					
10.	Vlerësimi i ndërsjellë ndihmon nxënësit më të dobët sepse i jep mundësi të shohin punë (përgjigje, ese, detyrë, ...) më të avancuar.					
11.	Nxënësit fitojnë ide më të qarta se si t'i ndihmojnë vetes për t'u përmirësuar përmes vetëvlerësimit.					
12.	Vetëvlerësimi ndihmon nxënësit të korigjojnë njohuritë e tyre momentale, lëshimet dhe gabimet gjatë të nxënësve.					
13.	Nxënësit mësojnë më shumë kur parashtrij pyetje më shpesh gjatë përcjelljes së përparimit dhe kontorllimit të të kuptuarit.					
14.	Parashtrimi i pyetjeve nxit tek nxënësit të menduarit e nivelit të lartë.					
15.	Teknikat e VpN-ës nxisin dëshirën dhe përkushtimin e nxënësve si dhe orientojnë ata për arritjen e rezultateve të të nxënësve.					

## Shtojca B – Pyetësi për nxënës

Të dashur nxënës,

Ky pyetësor ka për qëllim grumbullimin e të dhënave nga nxënësit e shkollave fillore të Republikës së Kosovës, për nivelin e zbatimit të vlerësimit formativ dhe ndikimin e teknikave të VpN në arritjen e rezultateve të të nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe.

Përgjigjet tuaja do të jenë një kontribut i mirë dhe do të shërbejnë për çështje hulumtimi. Pyetësi është anonim dhe mbi të gjitha, të dhënat që do të mbledhen me këtë pyetësor, do të përdoren vetëm për qëllime studimi.

*Ju falënderoj paraprakisht dhe u jam mirënjohëse nëse pranoni të jeni pjesë e këtij hulumtimi!*

Informacione të përgjithshme				
<b>1</b>	<b>Gjinia</b>	Mashkull <input type="checkbox"/>	Femër <input type="checkbox"/>	
<b>2</b>	<b>Klasa</b>	II-të <input type="checkbox"/>	III-të <input type="checkbox"/>	IV-të <input type="checkbox"/> V-të <input type="checkbox"/>

**Ju lutem zgjidhni vetëm njërën nga alternativat që përputhet me mendimin tuaj, duke vendosur**

Nr.	Pohimet	Niveli				
		1	2	3	4	5
1.	Përveç vlerësimit në fund të periudhave, unë vlerësohem në vazhdimësi nga mësuesja/mësuesi edhe gjatë orës mësimore.					
2.	Mësuesja ime/mësuesi im më vlerëson në mënyra të ndryshme.					
3.	Mësuesja ime/ mësuesi im më korrigjon gabimet, më sqaron, më vlerëson e më lavdëron...me gojë, me shkrim e edhe me gjestikulacione. (Informata kthyese)					
4.	Informata kthyese më bën të kuptoj nëse jam në rrugën e duhur gjatë dhënies së një përgjigjeje, kryerjes së një detyre...					
5.	Mënyrat e ndryshme të vlerësimit ma lehtësojnë të nxënit.					
6.	Qartësoj idetë e mia për qëllimet e të nxënit dhe kriteret e suksesit kur vlerësojmë shoku – shokun. (Vlerësimi i ndërsjellë)					
7.	Vlerësimi i ndërsjellë më ndihmon të përmirësohem sepse më jep mundësi të shoh detyra, përgjigje apo ese të punuara në mënyra të ndryshme.					
8.	Kur vlerësoj vetëveten fitoj ide se si t'i ndihmoj vetes për t'u përmirësuar. (Vetëvlerësimi)					
9.	Vetëvlerësimi më ndihmon të korigjoj njohuritë e mia momentale, lëshimet dhe gabimet gjatë të nxënit.					
10.	Mësoj më shumë kur mësuesja/mësuesi bënë pyetje më shpesh gjatë orës mësimore. (Parashtrimi i pyetjeve)					
11.	Parashtrimi i pyetjeve nga mësuesja/mësuesi më nxisin të mendoj më thellë, të imagjinoj dhe të jem kreativ/e.					
12.	Mënyrat e ndryshme të vlerësimit më nxisin dëshirën dhe përkushtimin si dhe më orientojnë për arritjen e rezultateve të të nxënit.					

## Shtojca C – Protokoli i intervistës me ekspertë të fushës së vlerësimit – trajnerë/fasilitues

I/E nderuar/a trajner/e,

Kjo intervistë që është paraparë të zhvillohet me ju, ka për qëllim grumbullimin e të dhënave nga ekspertët e fushës së vlerësimit në shkollat fillore të Republikës së Kosovës, për nivelin e zbatimit të vlerësimit formativ dhe ndikimin e teknikave të VpN në arritjen e rezultateve të të nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe.

Përceptimet, qëndrimet dhe përvojat tuaja do të jenë një kontribut i mirë dhe do të shërbejnë për çështje hulumtimi. Intervista do të mbetet anonime dhe mbi të gjitha, të dhënat që do të mblidhen me këtë intervistë, do të përdoren vetëm për qëllime studimi.

*Ju falënderoj paraprakisht dhe u jam mirënjohëse nëse pranoi të jeni pjesë e këtij hulumtimi!*

### Informacione të përgjithshme

**Ginia:**

**Mosha (vjeç)**

**Shkalla e fundit e kualifikimit tuaj**

**Komuna ku punoni**

**Përvojë në mësimdhënie (vite)**

**Përvojë pune si fasilitues/trajner**

*Shkalla e zbatimit të Vlerësimit sipas Kornizës Kurrikulare të Kosovës*

1. Cilat ndryshime përmbajtësore dhe organizative mendoni se ndodhën me zbatimin e KKK?

2. Me që përmendët vlerësimin, sa e zbatoni vlerësimin formativ...?

3. Bazuar në përvojat e juaja, çfarë efekte ka sjellë vlerësimi formativ në arritjen e rezultateve të të nxënësve?

*Ndikimi i teknikave të vlerësimit formativ në arritjen e rezultateve të të nxënësve*

1. Sipas jush, cilat janë teknikat më të përshteshme të vlerësimit formativ dhe që kanë ndikim në arritjen e rezultateve?

2. Cili mendoni se ka qenë ndikimi i këtyre teknikave që është vërejtur te nxënësit tuaj?

*Përparësitë dhe kufizimet e teknikave të vlerësimit formativ*

1. Cilat mendoni se janë disa nga anët më pozitive apo përparësitë e zbatimit të teknikave të vlerësimit formativ?

2. Përshkruani disa nga sfidat e zbatimit të teknikave të vlerësimit formativ me të cilat ballafaqoheni ju si mësimdhënës.

## Shtojca D - Tabela e analizës cilësore

Kategoria	Interpretimi fillestar	Teksti
<i>Shkalla e zbatimit</i>	Ndryshimet përmbajtësore	<p>- Me zbatimin e KKK mendoj se ndodhi një cikël i ri i reformave në arsim. KKK promovon përfshirjen aktive të nxënësve në përzgjedhjen e përvojave të të nxënësve dhe vetëdijësimin e tyre për të vlerësuar dhe për të vetëvlerësuar.</p> <p>- Ndryshimet përmbajtësore që kanë ndodhur me zbatimin e kurrikulës së re janë: qasja në kompetenca dhe rezultate të të nxënësve, riorganizimi i fushave kurrikulare dhe shkallëve kryesore të kurrikulës, metodologjia e mësimdhënies dhe mësimnxënies, vlerësimi i arritjes së nxënësve, riorganizimi i kurrikulës me zgjedhje, si dhe aspektet tjera të organizimit në nivel shkolle...</p> <p>- Në arsimin parauniversitar zbatimi i kurrikulës së re solli mjaftë ndryshime. Si një veçori që mund ta them në këtë moment është realizimi i procesit mësimor, i cili mundëson që marrëdhënia e fëmijëve me mjedisin natyror dhe me mjedisin e krijuar nga njeriu të kuptohet në mënyrë sa më të plotë, bëhet në mënyrë të integruar.</p>
	Ndryshimet organizative	<p>- Ndërsa, sa i përket ndryshimeve organizative në procesin e mësimdhënies, nxënies dhe vlerësimit, tani me zbatimin e KKK mësimi është i organizuar nëpër nën nivele formale apo shkallë kurrikulare dhe fusha që përfshijnë lëndët.</p> <p>- Në përgjigjen paraprake paskam prekur edhe ndryshimet organizative. Siç e cekta edhe më lartë riorganizimin e fushave kurrikulare e që janë gjuhët dhe komunikimi, artet, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria dhe mjedisi, edukata fizike, sportet dhe shëndeti si dhe jeta dhe puna. Gjithashtu edhe riorganizimin e shkallëve kryesore të kurrikulës që përbëhen prej një, dy ose tre viteve/klasave, e që janë gjashtë: SHK 1: Parafillor, klasa e parë dhe e dytë; SHK 2: klasa e tretë deri në klasën e pestë; SHK 3: klasa e gjashtë dhe e shtatë; SHK 4: klasa e tetë dhe e nëntë; SHK 5: klasa e dhjetë dhe e njëmbëdhjetë, dhe SHK 6:</p>



		<p>klasa e dymbëdhjetë.</p> <p>- Tani me zbatimin e Kurrikilës së re të Kosovës në sistemin parauniversitar organizimi i mësimi bëhet i strukturuar në gjashtë nivele apo shkallë, që besoj nuk është e nevojshme t'i veçoj një nga një, pastaj në tetë fusha të cilat përmbajnë një, dy ose tre lëndë. Më duhet të përmend se tani edhe një vit shkollor është i ndarë në tri periudha kohore.</p>
	<p>Zbatoj vlerësimin formativ</p>	<p>-Duke marrë parasysh që Korniza Kurrikulare përcakton tri lloje të vlerësimit të brendshëm si, vlerësimin e vazhdueshëm që bëhet gjatë procesit të të nxënës (vlerësimi formativ) dhe në fund të çdo teme mësimore, njësie tematike apo periudhe të mësimi (vlerësimi përmbledhës), vlerësimin përfundimtar që bëhet në fund të vitit shkollor si dhe vlerësimin për shkallë që bëhet në fund të çdo shkalle kurrikulare atëherë mund të them se jemi të detyruar të zbatojmë edhe vlerësimin formativ. Pra, unë e zbatoj pothuajse gjithmonë vlerësimin formativ.</p> <p>-Nëse nuk mund të them se gjithmonë zbatoj vlerësimin formativ me të gjithë nxënësit brenda një ore mësimore, mund të them se gjithmonë planifikoj vlerësimin formativ si pjesë përbërëse të saj duke përfshirë nxënësit që dua t'i vlerësoj për një qëllim të caktuar. Kjo kërkohet dhe nga kurrikula dhe besoj se po ndihmon në cilësinë e procesit mësimor.</p> <p>- Vlerësimin formativ unë e zbatoj pothuajse rregullisht në së paku njërën nga etapat e orës mësimore. Kjo formë vlerësimi është bërë pjesë e pandashme e punës sonë sepse më ndihmon mua, por edhe nxënësit në strukturimin e të nxënës për vetveten dhe për ta.</p>
	<p>Efektet e vlerësimit formativ në arritjen e rezultateve të të nxënës</p>	<p>- Vlerësimi formativ është vlerësim që parimisht është i bazuar në punën në klasë dhe realizohet nga vet në mësimdhënës atëherë them se veç tjerash, efekti kryesor i këti lloj vlerësimi është përkrahja e nxënësve për përparimin e tyre në mësim.</p>

		<p>- Teknikat e vlerësimit formativ them me shumë përgjegjësi se kanë efekt pozitiv në arritjen e rezultateve të të nxënësve. Për t'i vlerësuar nxënësit sipas kurrikulës së bazuar në kompetenca, këto teknika u mundësojnë nxënësve t'i demonstrojnë jo vetëm njohuritë, por edhe shkathtësitë dhe qëndrimet e tyre.</p> <p>- Teknikat e vlerësimit formativ kanë efekte shumë të mira tek nxënësit sepse përdorimi i instrumenteve të ndryshme të vlerësimit në varësi të llojeve të të nxënësve që do të vlerësohen në procesin e të nxënësve, u siguron nxënësve përparim dhe arritje të rezultateve pozitive.</p>
<p><b><i>Ndikimi i teknikave të vlerësimit formativ</i></b></p>	<p>Teknikat më të përshtatshme</p>	<p>- Unë si trajnere, por edhe si mësuese, nisur nga ajo që arrij të shoh gjatë punës sime në klasë them se teknikat më të përshtatshme të vlerësimit formativ dhe që kanë ndikim në arritjen e rezultateve janë informata kthyesë, parashtrimi i pyetjeve e pastaj edhe vetëvlerësimi dhe vlerësimi i ndërsjellë.</p> <p>- Lirisht mund të them se të gjitha teknikat e vlerësimit formativ në një formë apo në një tjetër janë të përshtatshme, por unë do të theksoj teknikën informata kthyesë dhe teknikën parashtrimi i pyetjeve si teknika më me ndikim në arritjen e rezultateve të të nxënësve.</p> <p>- Për mendimin tim të gjitha teknikat e vlerësimit formativ siç janë vetëvlerësimi, vlerësimi i ndërsjellë, parashtrimi i pyetjeve efektive dhe informata kthyesë janë të përshtatshme, vetëm duhet ditur përzgjedhur teknikën e duhur për momentin dhe qëllimin e asaj se çfarë duam të vlerësojmë.</p>
	<p>Ndikimi i këtyre teknikave</p>	<p>- Unë nuk do t'i veçoja ndikimet për çdo teknikë veç e veç, por do t'i përmendi disa ndikime në përgjithësi si psh. identifikimin e vështirësive me të cilat ballafaqohen nxënësit, i ndihmojnë nxënësit duke ju dhënë mundësi që të shohin punë më të avancuar, nxënësit janë në gjendje të analizojnë punën e tyre etj.</p>

		<p>- Ndikimet janë të shumta, por ajo që ja vlen të theksohet them se këto teknika u mundësojnë nxënësve të përdorin, të lidhin apo zbatojnë ide, të japin arsye, të përmbledhin apo të vlerësojnë dhe shpesh të përfshijnë përgjigje të zgjeruara që të paraqesin të kuptuarit më të thellë.</p> <p>- Në vazhdimësi shoh se ndikimi më i madh i këtyre teknikave në arritjen e rezultateve të të nxënësve është motivimi dhe ngritja e vetëbesimit, të cilat konsiderohen si çelësi i suksesit.</p>
<p><b><i>Përparësitë dhe kufizimet</i></b></p>	<p>Anët pozitive apo përparësitë</p>	<p>- Si anë pozitive apo përparësi do të veçoja se këto teknika orientojnë vlerësimin kah përparimi, mundësojnë vlerësimin të varur nga shumë gjëra.</p> <p>- Përparësia apo ana pozitive e këtyre teknikave mendoj se është ofrimi i kushteve specifike dhe të matshme për atë që nxënësi do të dijë, ose do të jetë në gjendje ta bëjë si rezultat i angazhimit në aktivitetin mësimor.</p> <p>- Nisur nga ajo me të cilat përballemi çdo ditë gjatë punës me nxënës, them se përparësitë janë të shumta. Psh. me anë të përdorimit të këtyre teknikave mund të paraqesim një portret të saktë dhe të përmbledhur të nxënësit, përfshijmë nxënësit në vendime, u mundësojmë nxënësve t'i shfaqin ndryshimet siç janë inteligjencat e shumëfishta, diversitetin kulturor etj, si dhe ngrisin përgjegjësinë për vetëvlerësim.</p>
	<p>Sfidat</p>	<p>- Për mua sfida më e madhe e zbatimit të teknikave të vlerësimit formativ me të cilën ballafaqohem është numri i madh i nxënësve në klasë.</p> <p>- Pavarësisht përvojës sime mbi 20 vjeçare ende e konsideroj tërë procesin e vlerësimit si pjesën më sfiduese të punës sime. Për mua pjesa më sfiduese është përzgjedhja e duhur dhe e përshtatshme e instrumenteve të vlerësimit.</p> <p>- Sfida kuptohet që ka në çdo proces të punës si mësimdhënës, mirëpo mua më kanë sjellë vështirësi shpeshherë tekstet joadekuate shkollore</p>

		dhe pa kritere sipas kurrikulës së re të bazuar në kompetenca për klasat apo nivelet përkatëse.
--	--	---